



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 11 MARS 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
11. MARTA 2010. GODINE**

**MARS – MARTA
2010**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Mirë se keni ardhur në këtë seancën e sotshme!
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatohet në sallë janë 64 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, së bashku me shefat e grupeve parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia paraqet rendin e ditës për seancën e sotshme plenare.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, deputeti Gani Geci e ka kërkuar fjalën.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,
Të nderuar Kabinet qeveritar,
Minatorët e Trepçës, Sindikata e tyre më ka lutur para disa ditësh që çështjen e tyre ta ngrejë në Kuvendin e Kosovës si çështje me urgjencë. Është fjala për një pjesë të minatorëve që i kanë mbushur nga 60 vjet, po nuk i kanë 65 vjet dhe nuk e gëzojnë të drejtën e pensionit dhe janë në varfëri të skajshme.

Këta minatorë që kanë hequr të zitë e ullirit për Kosovën, këta minatorë që u ngujuan në zgafelle për pavarësinë e Kosovës dhe për ta mbrojtur integritetin e Kosovës, janë ata të cilët e ndihmuan çështjen tonë. Prandaj, ata para disa dite kishin qenë edhe te presidenti, nuk i ka pritur. Kërkoj nga institucionet relevante, nga shteti i Kosovës t'i pret minatorët e Trepçës, të bisedojë për hallet e tyre dhe të zgjidhen ato sa më shpejt që është e mundur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,
Zoti Geci,
Faleminderit për vëmendjen e shtuar që e keni bërë edhe ju. Unë po ju njoftoj se tani sa erdha prej takimit me përfaqësuesit e tyre dhe besoj që Qeveria do të dalë me një propozim të mirë edhe për zgjidhjen e problemit të tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Procedojmë me rendin e ditës. Pika e parë:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 25 shkurt 2010

Pyes, nëse keni vërejtje në Procesverbalin e kësaj seance. Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit!
Unë kam veç një korrigjim të vogël në transkripto. Te reshti 5 është hequr një fjalë që ia jep kuptimin asaj që kam thënë. Do me thanë, këtu është: “mendoj se është fundi që

privatizimet e rëndësishme të bëhen me anë të këshillëdhënësve”, a është dashur të jetë: “mendoj se është fundi që privatizimet e rëndësishme të mos bëhen...”. Pra, fjala “të mos” mungon këtu dhe kërkoj nga administrata që të futet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, me shkrim administratës ia përcjell, kurse ne e kemi fjalën për procesverbal. Riza Smaka e ka kërkuar fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryetar,

Janë përvjedhur, ndër të tjera, 4 gabime në tekstin që unë e kam diskutuar. Bie fjala “zoti” duhet të jetë “zotëri”, kurrësi “zoti”, më pastaj jo “amandaman”, po “amendment”, më pastaj jo “prident” po “prudent” dhe jo “kontest” po “kontekst”, se kontesti është garë, është diçka tjetër, do të thotë, të kihet kujdes se edhe herëve tjera, po s’kam dashur ta ngrejë këtë çështje, e kam marrë si gabim teknik. Po, me qenë se bëhet përsëritje, atëherë të kihet kujdes. Faleminderit!

KRYETARI: E njëjta gjë vlen edhe për juve, deputetë. Naim Rustemi e ka kërkuar fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues!

Unë e kisha pasur dëshirë që në procesverbal, në pikën 9 dhe pikën 10 të shtohet nga një resht, se këto pika janë miratuar pa hapje të debatit.

KRYETARI: Korrigjoje edhe fjalën kryesues, unë nuk jam kryesues.

NAIM RRUSTEMI: Kryetar i Kuvendit, më fal!

KRYETARI: A ka dikush vërejtje tjera?

Konstatohet se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 25 shkurt 2010.

Pika e dytë e radhës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Fillojmë. Deputetja Sanije Aliaj, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Deputete, e keni fjalën!

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të respektuar deputetë,

Unë pyetjen e kam shtruar edhe në seancën e kaluar, por do të bëjë përpjekje ta rishtroj edhe një herë, në mënyrë që të marrë përgjigjen nga ministri.

Zoti ministër,

Në Raportin e progresit ekziston konstatimi në kaptinën ku bëhet fjalë për të drejtat e komuniteteve, se komuniteti rom dhe goran procesin mësimor e zhvillon me plan-

programet e Qeverisë serbe për shkak të mungesës së plan-programeve nga Ministria e Arsimit.

Zoti ministër,

Në takimet e përhershme me ndërkombëtarë, ekziston opinioni se ne nuk kemi, nga përfaqësuesit e komunitetit goran nuk kemi mundësi të punojmë me plan-programet e Qeverisë serbe për shkak se mungojnë plan-programet e Qeverisë së Kosovës. Cilët janë hapat konkretë të Ministrisë suaj dhe ...

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAJ: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër, të nderuar kolegë ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Shumë e respektuar zonja deputete,

Republika e Kosovës i ka plan-programet e saja për gjuhën boshnjake dhe për gjuhën turke, të cilat janë të hartuara në të gjitha nivelet e arsimit, prej arsimit parafillor, arsimit të mesëm, arsimit të obliguar, do të thotë prej klasës së I deri IX dhe arsimit të mesëm, duke përfshirë gjimnazet dhe shkollat profesionale. Ka shumë nxënës të cilët ndjekin edhe profile të mësimi në gjuhën boshnjake dhe turke në shkollat profesionale. Ajo çka mungon deri më tash, janë lëndët e historisë, të gjuhës dhe të muzikës. Mirëpo, ne si Ministri jemi duke punuar intenzivisht që edhe për histori dhe për gjuhë e për muzikë t'i kemi plan-programet tona. Dua të them që në një pjesë të madhe të komunës së Dragashit, komuniteti goran e ndjek mësimin me plan-programet e Republikës së Kosovës, mirëpo ka tri fshatra në të cilat edhe më tutje mësimi mbahet me plan-programet e Serbisë dhe arsyeja kryesore janë pagat, të cilat një pjesë e mësimdhënësve i marrin nga shteti i Serbisë. Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashihet themelimi i Komisionit për harmonizimin e kurrikulave. Unë kam biseduar edhe me deputetët nga Kuvendi i Kosovës, të cilët e përfaqësojnë komunitetin goran, me deputetët e të gjitha partive politike dhe besojmë që me 1 shtator edhe në këto tri fshatra të Gorës mësimi do të mbahet me plan-programe të Kosovës pasi këto plan-programe të harmonizohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dua të ju informoj që më 1 shtator të vitit 2010, edhe Kurrikula e re për gjuhën rome, me elementet e historisë dhe të kulturës rome do të fillojë të jetësohet, që ka qenë e përmendur në Raportin e progresit për vitin 2009 dhe unë shpresoj që Raportii progresit për këtë pjesë të tij do të jetë pozitiv në vitin 2010.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, ke pyetje shtesë? Regjia, fjalën deputetes Sanije Aliaj!

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti ministër!

Unë kam pasur informacione si deputete, por pyetja ime është shtruar që t'ju bëhet e njohur opinionit në Kosovë se hapat e Ministrisë janë shumë korrektë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministren Justina Shiroka Pula.

DRITON TALI: Faleminderit!

Zonja ministre,

Më 17 dhjetor Qeveria mori vendimin përfundimtar, më 17 dhjetor 2009, për rikonfigurimin e projektit “Kosova e Re”. Pyetja është: Cilat janë arsyet e vërteta të cilat e shtynë Qeverinë që ta ndërrojë vendimin, sepse sa për freskim të memories, t’ua rikujtoj që deri në nëntor të vitit 2009 Qeveria dhe ekspertët e saj, pra këshilltarët e saj, si ata ndërkombëtarë, po ashtu edhe ata vendorë, me mish e me shpirt e mbronin projektin 2000 megavate? Dhe, pyes po ashtu, se sa për qind Qeveria pretendon të jetë aksionare në këtë projektin e ri? Faleminderit!

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA PULA: I nderuar kryetar,
Deputetë, ministra,
I nderuar deputet Tali,

Pyetja është shumë interesante dhe unë mendoj që përgjigjen në këtë pyetje e kemi dhënë disa herë nëpërmes medieve, po do të përpiqem që edhe këtu ta japë konkretisht.

Ndryshimi i Termocentralit “Kosova e Re”, sa iu përket kapaciteteve të parapara, ka ardhur për shkak të shumë kritereve. Së pari, kriza globale financiare, kriza globale në ambient, kufizimet e bankave për të financuar projektet e mëdha, tregu i kufizuar në regjion për të konsumuar 2000 megavat, si dhe konsumi i Kosovës sa u përket nevojave. Dhe, në bazë të këtyre kërkesave kemi parë që në Kosovë nuk kemi nevojë për 2000 megavat dhe ne jemi të interesuar që t’i plotësojmë së pari nevojat e konsumit vendor, e pastaj të mendojmë për eksport.

Përpos kësaj, këshilltarët e transaksionit të cilët i kemi, në janar të vitit 2008 kanë propozuar që ky projekt prej 2000 megavatësh është projekt i parealizuar dhe mund të vijë deri te mos realizimi dhe finalizimi i këtij projekti për shkak të dy arsyeve.

E para është, për shkak se 2000 megavate nuk mund të financohen prej bankave të ndryshme dhe nuk mund të ekspertohej sasia të cilën është e paraparë dhe, e dyta, për shkak se mund të vijë deri te mos konkurrenca, të cilën edhe e kemi përjetuar, që prej katër konzorciumeve, dy janë larguar, që do të thotë se nuk kemi pasur konkurrencë sa u përket ofertuesve për këtë termocentral. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë zonja ministre!
Deputet, ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Zonja ministre, ata këshilltarë ndërkombëtarë në çfarë gjuhe kanë folur me ju më 2008, që si paskeni kuptuar? Neve na thoshit ju që Projekti 2000 megavate është i qëndrueshëm, madje edhe sa herë që kritikoni, ju kështu ofendoheshit. Po unë, po them, më mirë është që për arsyetim tash e tutje të themi se e keni parë Gjebrailin në ëndërr, në rastin e juaj Shën Gabrielin, ju ka udhëzuar që ta ndërtoni mendimin, se sa këto arsye time që i dhatë. Se kriza globale nuk ka filluar në nëntor të vitit 2009, po fatkeqësisht ka filluar edhe bile të rimëkëmbet ekonomia globale dhe, po them, këto që i thatë është ofendim më së pari ata këshilltarë ndërkombëtarë, mendoj për këta këshilltarë të juaj, si Nayakët, po mendoj ata të Bankës Botërore, tandemi, pastaj ai gjeniu i vogël Ari Raubfegel, ju lutem mos i nënçmoni njerëzit, e ke edhe një, po ashtu një ekspert të famshëm atje, atë Kirk Adams’in, kam kujtuar që ai njeri është pasuruar ...

KRYETARI: Faleminderit, Driton!
Ministre, ke ndonjë fjalë shtesë? Jo. Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputeti Bujar Dugolli, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Unë kam çështjen që tash e disa vite po pengohet njëanshëm zbatimi i Marrëveshjes së tregtisë së lirë Cefta nga Republika e Serbisë dhe nga Republika e Bosnjës e Hercegovinës, duke i shkaktuar humbje të mëdha ekonomike Republikës së Kosovës. Pyetja konkrete është: Çfarë masash keni ndërmarrë ju që të dilet nga kjo gjendje dhe pse ende nuk i keni aplikuar masat e reciprocitetit me këto dy vende që nuk po e zbatojnë marrëveshjen e nënshkruar?

KRYTARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar,

Ministra, zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Dugolli,

Më lejoni së pari të bëj një korrigjim deklaratës suaj, se nuk kemi të bëjmë me disa vite, po me 15 muaj, si dhe të konfirmoj se pa dyshim të gjithë pajtohemi se Kosova përfiton nga Marrëveshja Cefta, duke marrë parasysh shumë aspekte pozitive të këtij procesi, siç është rrjedhja e lirë e mallrave dhe e shërbimeve, krijimi i rregullave dhe i mekanizmave me anë të cilave qeveriset tregtia e jashtme në rajon, formësimi i institucioneve dhe i politikave në përputhje me kërkesat e OBT-së, si dhe krijimi i një tregu tërheqës rajonal për bizneset vendore dhe investitorët e huaj.

Ashtu siç tanimë dihet për më tepër se një vit, për shkak të ndërrimit të vulave të doganave të Kosovës, produktet tona nuk mund të eksportohen në Serbi, kurse Bosnja e Hercegovina i ngarkon me tagra të plota doganore. Por, Marrëveshja Cefta nuk përcakton në mënyrë decitive përdorimin e masave të reciprocitetit në raste të dëmtimit të një pale nga aktet e palës tjetër, por lejon përdorimin e masave kundërbalancuese, që në fakt nuk janë të njëjta si veprime të fundit ku shteren të gjitha mundësitë për zgjidhjen miqësore të problemeve eventuale.

Pavarësisht kësaj, kundërpërgjigja e Kosovës me masa të njëjta ndaj Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës është shqyrtuar si opion dhe ende mbetet opion i mundshëm. Implementimi i këtyre masave është shqyrtuar nga disa aspekte si ai praktik, politik dhe ekonomik. Implementimi praktik i këtyre masave është i vështirë, duke marrë parasysh vështirësitë në pikat doganore 1 dhe 31, përkundër sukseseve evidente të cilat janë arritur në kohë të fundit në kontrollimin e këtyre dy pikave. Por, edhe nën supozimin se implementimi i masave të reciprocitetit do të mund të bëhej plotësisht, prapë se prapë aspekti politik dhe ekonomik nuk është në favor të këtij opsioni. Nga ana politike, ndërmarrja e këtyre masave do të mund të dërgonte sinjale jo të mira te Bashkësia Ndërkombëtare se Republika e Kosovës nuk është e gatshme për bashkëpunim regjional dhe do të rrezikonte përkrahjen për anëtarësim në organizatat tjera regjionale dhe ndërkombëtare, shumë të nevojshme për zhvillimin e vendit, kurse nga ana ekonomike, Kosova do të dërgonte sinjale dekurajuese te investitorët e huaj, si vend në konflikt ekonomik me fqinjët e saj. Të gjitha këto kanë qenë arsye të mjaftueshme që masat e reciprocitetit të mos shihen si zgjidhje e kësaj çështje. Ne besojmë se me përpjekjet e pareshtura të partnerëve ndërkombëtarë kjo do të zgjidhet në përputhshmëri me marrëveshjen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë?

BUJAR DUGOLLI: Faktikisht, edhe nga përgjigja që e dha ministri, do me thanë, nuk janë aspak inkurajues hapat që i ka ndërmarrë ministria për dalje nga kjo gjendje. Dëmet ekonomike të Kosovës janë shumë të mëdha. Ne konsiderojmë që Ministria dhe Qeveria nuk i ka shteruar të gjitha masat dhe nuk ka marr hapa të diskutimit as me UNMIK-un, as me EULEX-in për të zbatuar Marrëveshjen e tregtisë së lirë, të cilën e ka nënshkrua edhe Serbia. Konsideroj që kjo heshtje apo kjo gjendje e krijuar është në dëm të Kosovës dhe në rast se Qeveria e Kosovës nuk kërkon masat e reciprocitetit, atëherë dëmet e mëdha do të vazhdojnë t'i bëhen Kosovës dhe ne do të merremi me njëri tjetrin, ndërsa dëmi është shumë i madh ekonomik. Unë mendoj, ministër, ka metoda të cilat i lejon edhe marrëveshja e tregtisë së lirë për masat e reciprocitetit, por ju duhet t'i shfrytëzoni të gjitha mundësitë në diskutim me UNMIK-un, se ju e dini që UNMIK-u ka qenë pjesë e kësaj marrëveshje dhe për çështje të caktuara kur hasë në vështirësi ...

KRYETARI: Faleminderit!
Vazhdojmë. Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Zenun Pajaziti, ministri s'është këtu. Doni ta bëni pyetjen?

NAIM RRUSTEMI: Natën në mes të 24 e 25 prillit 2009, në Dhomën e dëshmime në ndërtesën e Drejtorisë së Policisë në Prishtinë janë vjedhur materiale të ndryshme, që kanë dëshmuar për krimin e organizuar në Kosovë, për të cilat edhe ju, zoti ministër, po ua sjell ndërmend, keni siguruar në këtë Parlament me datën 23 qershor, me fjalët, po e citoj ministrin: "Zbardhja e rastit dhe sjellja para drejtësisë e të gjithë atyre që kanë qenë të përfshirë në këtë vepër penale, duke mos përjashtuar as zyrtarët policorë, nuk ka alternativë, dhe në bazë të raporteve të dinamikës aktuale të procesit hetimor, ju siguroj se do të ketë rezultate konkrete në këtë drejtim". Por, deri më sot, përafërsisht një vit, nuk kemi asgjë konkrete. Pyetja që i drejtohet ministrit është: - A janë vjedhur dëshmitë për korrupsion nga dikush që është i fuqishëm dhe që pengon zbardhjen e krimit në polici?

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministren Justina Shiroka Pula.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!
Aplikimi i shkyqjes kolektive të rrymës për shkak të mospagesës së rrymës nga një pjesë e qytetarëve, paraqet shkeljen e të drejtave elementare të njeriut, sepse me këtë veprim dënohet në mënyrë të njëjtë edhe konsumatori që paguan rrymën, sikurse konsumatori që nuk e paguan atë.

Zonja ministre,
Kur do të përfundojë një logjikë e këtillë e dënimit kolektiv dhe të aplikohet dënimi individual ndaj atyre që nuk kryejnë obligimet ndaj KEK-ut për energjinë e shpenzuar?
Faleminderit!

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA PULA: E nderuara deputete,
Edhe ne si Ministri jemi mjaftë të brengosur për këtë aktivitet të cilin është duke bërë KEK-u. Kemi qenë në kontakt me menaxherët dhe anëtarët e tjerë të bordit dhe ata e kanë

arsyetuar këtë çështje se në kuadër të veprimeve të tyre i kanë disa dispozita të cilat i lejojnë që të bëjnë shkyçjen kolektive në ato lokacione ku pagesa e energjisë elektrike është nën 30% dhe kjo i plotëson të gjitha udhëzimet dhe direktivat të cilat i kanë ata në kuadër të planeve të punës së tyre. Ndërkohë, kanë kërkuar edhe prej Zyrës së Rregullatorit një përkrahje dhe Zyra e Rregullatorit i ka përkrahur sa i përket shkyçjeve në ato hapësira apo në ato lokacione ku pagesa apo borxhi i tyre është nën 10 apo 20%. Neve na vjen shumë keq dhe unë kërkoj prej të gjithë deputetëve që së bashku të marrim një aksion që t'i vetëdijësojmë apo t'i detyrojmë konsumatorët që të fillojnë të paguajnë energjinë elektrike, nëse jo tërë borxhin të cilin e kanë, por muajin e fundit apo faturën e parafundit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministre!
Deputete, ke pyetje shtesë?

MYRVETE PANTINA: Nuk kam pyetje shtesë, vetëm desha të bëj me dije, me qenë se kam pasur rast të jem në mesin e qytetarëve, të cilët me të vërtetë ndjehen të mashtruar dhe janë tepër të zhgënjyer për masa të tilla për arsye se me vite të tëra e paguajnë rrymën dhe në fund sanksionohen. Prandaj, duhet ndërmarrë masa urgjente në mënyrë që të mos dënohen të gjithë në mënyrë të barabartë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Deputeti Xhevdet Neziraj, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputet, e ke fjalën!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!
I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,
Kolegë deputetë,
Pasi në Kosovë ka mekanizma për mbrojtjen e komuniteteve, siç është Këshilli Konsultativ për Komunitete, Ministria për Komunitete dhe Kthim, mandej është Komisioni për Komunitete dhe Kthim, në gusht të vitit 2008 Qeveria e Kosovës ka themeluar edhe Zyrën për Komunitete dhe qëllimi i kësaj zyre është që të ofrojë përfaqësim dhe punësim të barabartë të komuniteteve në organet publike dhe në ndërmarrjet publike. Pyetja: - Sa ia ka arritur kjo Zyrë të kryej këto detyra dhe pjesëtarët e të cilave komunitete janë të punësuar në këtë zyrë?

KRYETARI: Zoti kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit!
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Ju e dini se ne po punojmë vazhdimisht për ndërtimin e Kosovës demokratike dhe shumë etnike. Ky është zotimi ynë dhe është një përcaktim i cili po avancohet në angazhimet tona që kemi shtetërore. I përmendët institucionet të cilat merren drejtpërdrejt me çështjen e komuniteteve, edhe Këshilli konsultativ, edhe ministritë përkatëse, por në të njëjtën kohë ka ndodhur edhe një njësi në kuadër të marrjes së përgjegjësisë dhe të inkorporimit tim edhe të drejtpërdrejtë për çështjen e komuniteteve, duke formua Zyrën për Komunitete, që udhëhiqet nga një qytetar serb, shtetas i Republikës së Kosovës, por që janë të punësuar dhe janë të përfshira të gjitha komunitetet që jetojnë në Republikën e Kosovës dhe të gjitha institucionet, duke nisur nga Parlamenti, Qeveria, ministritë, autoritetet lokale, Presidenca e kanë përbërjen e tyre shumë etnike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!
Deputet, ke pyetje shtesë?

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit! Jo do ta bëj edhe një pyetje shtesë. Ne si Komision për Komunitete kemi monitoruar Ligjin për promovimin e komuniteteve dhe në terren është kjo gjendje: Në ndërmarrjet publike, siç është KEK-i, PTK-ja, Aeroporti dhe Hekurudha s'është asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptian i punësuar që 10 vite. Gjithashtu, në institucionin shumë me rëndësi, siç është Policia, Dogana dhe shumë institucione tjera, janë shumë pak ose fare të përfshirë. Atëherë, unë nuk do të bëjë pyetje kur, por besoj që ju si kryeministër do t'i merrni hapat që pjesëtarët e të gjitha komuniteteve të jenë në mënyrë të barabartë të punësuar, jo të favorizohet ndonjë komunitet i veçantë. Prandaj, pres që Qeveria e Kosovës dhe ju, si kryeministër, të veproni në këtë drejtim.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!
Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar deputet,
E kuptoj seriozisht edhe shqetësimin tuaj dhe preokupimin tuaj, do të dëshiroj që edhe ju personalisht t'i identifikoni të punësuarit nëpër ndërmarrjet që ju i përmendët. Mendoj se është një përfshirje e shumanshme dhe gjithëpërfshirëse, ndërsa sa i përket identitetit të tyre etnik, mendoj se mund t'i identifikoni, por politika jonë është e gjithëpërfshirjes dhe e shumë etnicitetit.

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!
Deputeti Riza Smaka, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputet, e keni fjalën. Regjia, fjalën deputetit Riza Smaka. Shtypeni butonin, i nderuari deputet!

RIZA SMAKA: Nga një shkresë zyrtare të Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, ndër të tjera tregohet se qiraja mujore për zyrë të tij hiq më pak është se 14.000 euro, pa shpenzimet e harxhimet komunale.

Zotëri kryeministër,
A vlerësoni edhe ju se renta mujore e tillë për qira të lokaleve të Auditorit të Përgjithshëm, në këtë rast, po ka edhe të tjera institucione, është enorme dhe për aq në disfavor të parasë publike. Kjo, aq më parë, kur ju kohë më parë keni pas premtuar, që keni pasur mbështetje edhe keni, natyrisht, se do t'i eliminoni qira marrëdhëniet e Qeverisë si qiramarrëse me qiramarrës e qiradhënësit privat. Ndërkaq, qira marrëdhëniet e tilla jo që nuk janë eliminuar, por nuk janë reduktuar së pakut në shkallën e mundshme më të ulët. Duke e vlerësuar përkushtimin tuaj dhe duke e konsideruar përgjigjen e juaj zotëri kryeministër Thaçi, shfrytëzoj edhe këtë rast t'ju përshëndes, po kërkoj përgjigje, por mundësisht me të vërtetë të realizohet kjo, të reduktohen, nëse s'mund të eliminohen këto qira marrëdhënie kaq të larta. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Përgjigjen do ta merrni nga ministri i Administratës Publike, përgjegjës për këto çështje.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Kolegë ministra,
I nderuar profesor Smaka,

Faleminderit shumë për pyetjen dhe është një rast i mirë që t'iu japim një përgjigje edhe pyetjeve të mëparshme rreth objekteve me qira. Më lejoni që të jap të dhëna konkrete dhe të sakta.

Në fillim të vitit 2007, kur kjo Qeveri është inauguruar, ne kemi trashëguar një gjendje jo të mirë sa u përket objekteve të ministrive për shkak se vetëm 33% të kapaciteteve të Qeverisë kanë qenë objekte publike, ndërsa 67% të institucioneve kanë qenë në objekte private. Me përkushtimin e Qeverisë dhe me planin dinamik, ne kemi arritur përfundimisht që tani gati 100% të gjitha mekanizmat e Qeverisë, të gjitha ministratë t'i akomodojmë në objekte publike me standarde të pranueshme, me standarde të inxhinieringut evropian.

Më lejoni që tani të japë shifra konkrete. Ne për këto dy vjet kemi akomoduar 9 ministri nga objektet private në objekte publike, po i numëroj: Ministria e Energjisë dhe e Minierave, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kthimit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Transportit, Ministria e Forcës së Sigurisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme, të cilat përkohësisht janë në objekte publike. Gjithashtu, kemi akomoduar edhe shumë institucione të pavarura kushtetuese, siç janë: Komisioni Qendrorë Zgjedhor, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, Këshilli Gjyqësor, Agjencioni Antikorrupsion, Komisioni i Konkurrencës, Agjencioni Kosovar i Inteligjencës dhe Akademia e Shkencave. Pra, definitivisht, aktualisht asnjë ministri nuk është në objekte private, kanë ngelë disa zyre, disa zyre të vogla të disa agjencioneve, të cilat shumë shpejtë do të vendosen në objekte publike.

Plani për kalimin e ministrive nga objekte private dhe publike është përfunduar. Ne kemi promovuar disa objekte moderne reprezentative, që janë ndërtuar me konceptin e administratës publike të hapur, siç është objekti i ish pallatit "Rilindja", objekti i Ministrisë së Arsimit, objekti i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Konkret, koncepti ndërtimor i këtyre objekteve i ka përfshirë standardet evropiane për krijimin e një administrate publike të hapur dhe transparente.

Sa i përket pyetjes suaj konkrete, Zyrës së Auditorit Gjeneral, ne jemi në kontakte të përditshme me këtë zyrë dhe jemi në rrugë të mirë për ta akomoduar edhe këtë zyrë të rëndësishme të pavarur kushtetuese. Së shpejti do të arrijmë një marrëveshje që kjo zyrë të kalojë nga objekti privat në një objekt publik. Kemi ofruar objekte të mira dhe unë mendoj se në fillim të javës së ardhshme do të arrijmë një marrëveshje që edhe kjo zyrë të transferohet në objekt publik dhe me këtë, në fakt, edhe institucionet që nuk janë pjesë e ekzekutivit, por janë institucione që i përgjigjen Kuvendit të Kosovës, po arrijmë t'i akomodojmë në kushte moderne.

KRYETARI: Qeveria është përgjegjëse edhe për agjencione që i përgjigjen Kuvendit. Deputet, a ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: E përshëndes ministrin, profesorin e nderuar. Bajramin, për përgjigjen edhe ministrore dhe adekuatë. Unë vlerësoj se përgjigjet e këtilla janë shumë të dobishme edhe për informim, edhe për respektimin e opinionit, edhe të Kuvendit, edhe të funksionit. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, edhe prej teje, deputet!
Deputetja Nurishahe Hulaj, pyetje për ministren Nekibe Kelmendi.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar, deputetë të nderuar,

Çështja: Në rastet e kryerjes së veprave penale nga ana e personave me të meta mentale, të cilat raste pastaj përfundojnë me trajtim të detyrueshëm në burgje. Prandaj, rreth situatave të rasteve të tilla gjithherë duhet të bëhet vlerësimi i rrezikut, e në anën tjetër edhe mbrojtja shëndetësore. Pyetja ime ka të bëjë me sfidën e ngritur në Raportin e progresit Evropian që Instituti i Psikiatrisë Ligjore apo Forenzike të ndërtohet sa më shpejt dhe të plotësohet ky standard ndërkombëtar. Prandaj, parashtroj pyetjen për ministren Nekibe Kelmendi. Pyetja është: - Si funksionojnë procedurat e mbrojtjes shëndetësore të rasteve të tilla brenda burgjeve, që nënkupton aplikimi i psikoterapisë ligjore?

KRYETARI: Zonja ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

E nderuara zonja deputete Hulaj,

Kur një person në kohën e kryerjes së ndonjë vepre penale është me të meta mendore, ai është penalisht i papërgjegjshëm. Prandaj, ndaj tij nuk mund të shqiptohet sanksioni penal, por në vend të sanksionit penal gjykata atij i shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, me ndalim në institucion të kujdesit shëndetësor. Pra, trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim ose trajtim i detyrueshëm psikiatrik në liri, janë dy masa.

Masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, gjykata e shqipton ndaj kryesit, i cili ka kryer vepër penale të dënueshme më së paku tri vite në gjendje të paaftësisë mendore ose të aftësisë së zvogëluar mendore, nëse konstaton se ekziston rrezik serioz që kryesi të kryej vepër penale, ku përfshihet akti i dhunshëm ose shkaktimi i lëndimit trupor ndaj personit tjetër. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim është e nevojshme edhe për shmangien e rrezikut të këtyllë. Masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri gjykata e shqipton ndaj kryesit, i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose të aftësisë së zvogëluar ose nëse konstaton se ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryejë vepër penale, ku përfshihet akti i dhunshëm apo shkaktimi i lëndimit trupor personit tjetër dhe trajtimin e detyrueshëm psikiatrik, i cili është i nevojshëm për shmangien e këtij rreziku.

Ekziston procedura e posaçme penale për zbatimin e ekzaminimit psikiatrik. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ekzekutohet në Institucion të Kujdesit Shëndetësor, përkatësisht në Psikiatrinë Forenzike. Deri më tani Kosova një institucion të këtyllë nuk e ka pasur, por mund t'ju deklaroj publikisht këtu se kam marrë donacione nga Projekti IPA dhe së shpejti do të ndërtohet ky institucion psikiatrik, si për të mitur, ashtu edhe për ata të moshës madhore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministre!

Deputete, ke pyetje shtesë? E ke fjalën!

NURISHAHE HULA: Unë i kam pasur më parë disa informata prej ministres dhe e falënderoj shumë, por për të qenë më qartë ndaj publikut, unë e kam parashtuar sot këtë pyetje këtu. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, edhe prej jush!
Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Çështja është: Janë shumë familje në Kosovë që i kanë të zhdukur të afërmit e tyre deri në gjashtë anëtarë dhe marrin një asistencë sociale prej 135 eurosh.

I nderuari ministër,
Pyetja është: Kur do të ketë rritje për këto familje dhe a do të dallohet kjo rritje për ata që i kanë të zhdukur deri në gjashtë anëtarë të familjes?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsjedniče,
Dame i kolege ministri,
Dame i gospodo narodni poslanici,
Gospodo Šehu,
Kao što znate, te grupe ljudi i porodice su već u našim kompetencijama situirani, odnosno brinemo o njima nakon starta našeg, mi smo i onako od početka godine uz inicijativu premijera smo pokrenuli i stvaranje zakona takozvanog o vrednostima rata ili o ljudima, porodicima koje su imale efekte negativne kao posledice rata. Prema tome, mi smo svoj deo tehnički obavili, sam taj zakon je sad u Ministarstvu za finansije za onu finansijsku deklaraciju koja bi trebala da potvrdi da su sredstva već obezbeđena za taj zakon. To sam ja, ako ste pratili i predlagao na sednici Vlade pre nekoliko nedelja, tako da taj zakon verovatno posle povratka iz Ministarstva finansija, biće usvojen u Vladi i verovatno i u Parlamentu. Tako da taj zakon jeste u izgradnji, jeste u doradi, jeste u finalnoj fazi i u tom zakonu će biti predviđene porodice nestalih, kao što ste i vi rekli. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministër,
Deputete, ke pyetje shtesë? Jo. Faleminderit edhe prej juve!
Deputetja Glynaze Syla, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputeten kryeministri s'është këtu, doni ta bëni pyetjen? Mirë, nëse kthehet, e bëni pyetjen.
Deputeti Bahri Hyseni, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!
Përshëndetje, të nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuari zoti ministër,
Para disa vitesh në Ferizaj është privatizuar Kombinati i drurit “Tefik Çanga” me spinof të rëndomtë dhe mbi 1000 punëtorë kanë mbetur jashtë vendeve të tyre të punës. Çështja është: Ka qenë një vendim që t’ju paguhen pagat për vitin 2003 – 2005 punëtorëve dhe kjo nuk ka ndodhur deri më tani. Dhe, çështja tjetër, a po mendohet apo a është shikuar që të mendohet për statusin e këtyre punëtorëve, sepse ka qenë një spinof i rëndomtë dhe këta janë në moshë të shtyrë 50 – 65 vjet dhe e kanë vështirë të themelojnë marrëdhënie pune. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,
Zoti Hyseni, deputet i nderuar,
Unë kam thënë edhe kohë më parë që të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë për privatizimet, kompetent është Agjencioni Kosovar i Privatizimit, andaj do t'ju kisha lutur që t'i thirrni njerëzit kompetent për t'u përgjigjur për këtë. Me qenë se kjo ka ndodhur në kohën kur unë kam qenë zëvendësudrejtor, unë i kam përgatitur detajet e përgjigjes dhe e falënderoj stafin e AKP-së që ka përgatitur në detaje këtë përgjigje dhe do ta japë me shkrim, por gjithsesi procesi i likuidimit është ai i cili do të zgjidh çështjen e pagesave të vonuara ose të pagesave a të çfarëdo obligimi që ka një ndërmarrje shoqërore deri në procesin e privatizimit. E gjithë ajo që unë insistoje dhe do të doja që juve të lusja që të bëni presion në Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit, institucion që i përgjigjet këtij Kuvendi, që të përshpejtojë procesin e likuidimit, ku do të shlyhen edhe obligimet ndajë punëtorëve, qoftë për pagat e papaguara, qoftë për obligimet e tjera ndaj shtetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, ke pyetje shtesë?

BAHRI HYSENI: Jo, jo, falënderoj ministrin dhe do ta marrë materialin që e ka përgatitur, sepse unë kam biseduar edhe me ata të Agjencionit, por nuk kanë qenë në gjendje të japin sqarime të qarta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe prej teje!
Deputeti Gani Geci, pyetje për ministrin Fatmir Limaj.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryetar!
I nderuar ministër,
Ruga Skenderaj - Vushtrri ka ngecur në fshatin Polac, edhe pse kur ka filluar, ka filluar me protesta dhe tash tre vjet nuk ka përfunduar. Janë tre kilometra rrugë prej fshatit Polac deri në rrugën që lidhet me Skenderajn, nuk janë të punuara dhe ky segment i rrugës është më i banuar se tërë segmenti tjetër që shkon deri në Vushtrri. Ju lutem, a ka mundësi ta dimë ku ka ngecur ky projekt dhe pse nuk është përfunduar deri më tani? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,
Siç e thatë edhe ju, bëhet fjalë për një pjesë të terrenit që është më i dendur, ose më mirë të themi një lagje në tërësi, në fshat, një kilometër deri në tri vendbanime. Mund të them që projekti i rrugës Skenderaj – Vushtrri po ashtu nuk ka përfunduar akoma dhe për arsye se ju e dini që kemi pasur probleme me Ligjin për shpronësim dhe Ligji për shpronësim është bërë para pakë kohësh, por megjithatë dua t'ju them që në bashkëpunim me komunën, ne i kemi zgjidhur disa nga problemet, sepse aty kemi hapësirë ose korridor ku duhet të rrënohen ose të largohen shtëpi. Një nga shtëpitë, besoj, është kryer gjatë kësaj periudhe me marrëveshje me kuvendin komunal, i kemi gjetur truallin familjes dhe besoj që do të kompensohet edhe shtëpia për të filluar punimet. Gjithashtu, duhet të bëhet kompensimi, kompensimi i pronës ose vlerësimi i pronave të njerëzve të cilëve futet nëpërmes fshatit dhe kjo do të ndodhë me Ligjin e ri për shpronësim. Kështu që, ashtu siç

thatë edhe ju, është një kohë e gjatë, është një vend jashtëzakonisht i banuar ajo pjesë, por megjithatë duhet patjetër të shkojmë duke respektuar procedurat e shpronësimit të pronës, sepse bëhet fjalë për një pronë e cila jashtëzakonisht kushton shumë në atë pjesë, sepse është në zemër të fshatit.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë?

GANI GEÇI: Faleminderit, zoti ministër,
Unë e di për cilën pronë bëhet fjala, bëhet fjalë për shtëpinë e Gani Kabashit, është një pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare prej vitit 1991 dhe nuk keni mund të merreni vesh në pazar me të, prandaj do të kishte qenë mirë që kjo punë të rregullohet, sepse është një shtëpi banimi, ka edhe lokale aty dhe mos të bëjmë pazare me një person që ka nevojë për shtëpi. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Unë se kisha thënë kjo që është pazar, është e vërtetë që është biseduar me të gjitha familjet, po edhe konkretisht me këtë familje, e cila dëmtohet më së shumti sepse, siç e thatë edhe ju, shkon komplet shtëpia e tij, edhe trualli i shkon. Është bërë përpjekje në vitin 2008, 2007 që të gjendet një marrëveshje me pronarin, por ne nuk jemi të interesuar të bëjmë të tilla pazare, por duhet të respektohet ligji. Marrëveshja e tillë nuk është përmbyllur, është futur edhe kuvendi komunal duke siguruar troje, kompensimin e truallit në qytet, do me thanë të gjitha këto janë bërë deri sa s'kemi pas ligj, prandaj nuk kemi arritur marrëveshje. Ndërsa tani nuk kemi pse të arrijmë marrëveshje, është Ligji për shpronësim dhe ai do të japë vlerësimin e çmimit të tregut jo vetëm për atë familje, por për të gjitha familjet ose pronat në të cilat do të kalojë rruga deri në lidhjen e magjistrales ose ma mirë të themi rrugës regjionale Drenas – Skenderaj.

KRYETARI: faleminderit, ministër!
Deputetja Qamile Morina, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete, doni ta bëni pyetjen? E keni fjalën!

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!
Pyetja i është adresuar kryeministrit, ngase rekomandimi për furnizim me vaksina ka qenë prej Qeverisë, mirëpo ministri i Shëndetësisë nëse do, unë do ta shtroja pyetjen.

KRYETARI: Ministri është i gatshëm, bëje pyetjen!

QAMILE MORINA: Në seancën parlamentare të datës 25 shkurt nuk na është lejuar fare diskutimi rreth rekomandimit të Qeverisë për lejimin e pagesës - furnizim me vaksina. Sidoqoftë, kërkesa e Qeverisë për shmangien nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, duke lejuar pagesën në avancë për furnizim të këtyre vaksinave, është miratuar në Kuvend, por sigurisht nuk do të duhej të përsëritet si praktikë në të ardhmen.

Lidhja Demokratike e Dardanisë as ndërmend nuk i ka shkuar që mos ta votojë një çështje tejet jetike, siç është programi për imunizim. Mirëpo, të dhënat që janë ofruar, kanë qenë shkak i shumë dilemave dhe shumë paqartësive, e sidomos kur nuk kemi marrë përgjigje bindëse nga institucionet relevante. Vlera e sasisë së vaksinave të pranuar...

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar ministra, deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Ju faleminderit për pyetje! Më lejoni që t'ju garantoj që të gjitha të dhënat lidhur me këtë çështje jua kam përgatitur dhe mund t'ia ofroj edhe njëherë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Planifikimi i vaksinave është bërë nga Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike. Përzgjedhja bëhet sipas protokolleve botërore të programit të imunizimit. Blerja e vaksinave që nga viti 2006, në marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë dhe UNICEF-it bëhet, nën një, për shkak se furnizimi është i sigurt, nën dy, bëhet për shkak se çmimi është më i përshtatshëm.

Diferenca për të cilën ju ngrehni pyetjen parlamentare, qëndron në faktin se është shtuar vaksina Pentavaks, e cila është kundër emofilisë së tipit B, e cila përmban antigjen edhe për difteri, tetanus, kollë të bardhë dhe hepatit B. Vaksina Pentavaks në vlerë të shtuar është prej 411.000 euro e cila është shtua për këtë vit. Me rritje të buxhetit për farmaci, kemi rritur për 400% numrin e vaksinave sezonale, kemi rritur për 15 herë buxhetin për cisostatik dhe jemi të interesuar që ta bëjmë maksimumin për imunizimin e zgjeruar të popullatës së Republikës së Kosovës. Vetëm për vaksinën sezonale ne e kemi gjetur diku numrin 5000, ka qenë më i ulëti në krejt kontinentin, e kemi rritur për 4 herë dhe do të bëjmë përpjekje ta rritim edhe për këtë vit.

Sa i përket pyetjes suaj me shkrim për çështjet e doganave, ne si Ministri të Shëndetësisë e kemi ngritur këtë çështje disa herë, ofrojmë argumente që të mos kemi doganë për listën esenciale, e cila është për institucione shëndetësore publike dhe shpresoj se do të gjejmë mirëkuptim që mos të paguajmë doganë. Tërë dokumentacionin e keni këtu, pagesa për UNICEF për këtë listë është bërë në vlerën, e cila është lejuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Jemi të gatshëm t'ju ofrojmë të dhëna shtesë për këtë çështje.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, ke pyetje shtesë?

QAMILE MORINA: Ajo që vlen të theksohet është se kjo vaksinë Pentavaks nuk përdoret në Evropë dhe nuk është e licencuar nga EME-ja, Agjencioni Evropian për Produkte Medicinale, dhe kryesisht përdoret në vendet në zhvillim. Nëse keni argument që ka qenë çmimi më i ulët, nuk është, zoti ministër, ngase çmimi është shumë më i lartë, përmbi 480.000 euro. Sipas nenit 21 të Ligjit për shëndetësi publike, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës propozon programin e imunizimit, i obliguar për vitin kalendarik. Në këtë program të vitit 2010 nuk është paraparë vaksina e kombinuar Pentavaks. Andaj, kush e ka bërë vlerësimin e përshtatshmërisë të programit kombëtar të imunizimit me Pentavaks?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, zonja deputete!

Siç jeni ju në dijeni, konstatimi i juaj, ju duhet të jeni në dijeni se nuk është i saktë. Kërkesa për këtë vaksinë është bërë më 3.8.2008, me numrin e protokollit 279-04 nga

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik. Divizioni i Shëndetit Publik të Ministrisë së Shëndetësisë e ka proceduar për aprovim dhe ky produkt, kjo vaksinë është aprovuar më 01.04.2008, me numrin 05-1235. Ju zonjë, ju keni të drejtë të keni pakënaqësinë për përmirësime, por ju ftoj që të jeni konstruktive. Tërë dokumentacioni lidhur me këtë çështje është në bazë të ligjeve në fuqi dhe jam shumë i lumtur që kemi pasur mundësi me rritje të buxhetit ta kemi një vaksinë, e cila do të jetë shumë e dobishme për fëmijët nën moshën 5 vjeçare.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputeti Gani Geci, pyetje për ministrin Fatmir Limaj. I dhamë përparësi pyetjes së Gani Gecit.

GANI GECI: Faleminderit, kryetar!

Jo, është fjala për rrugën Skenderaj – Klinë. Zoti ministër, ju e dini që rruga Skenderaj – Klinë ka filluar para 4 vitesh në segmentin Skenderaj – Turiqevc, ndërsa nga Klina për në Jashanicë është përfunduar vitin e kaluar.

Zoti ministër,

Në mes fshatit Borojë dhe Jashanicë është një segment që 10 vite pas lufte e pa ndërtuar, e shkatërruar, disa herë janë dhënë mjete aty dhe prapë s'është ndërtua. A ka mundësi të na njoftoni se kur do të bëhet ky ndërtim i kësaj rruge, që është mjaft e frekuentuar dhe kjo rrugë është në kompetencat e Ministrisë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryetar!

Ashtu siç e thatë edhe ju, i nderuar deputet, për 10 vite ajo pjesë e rrugës ka mbetur ashtu siç ka mbetur, ose më mirë të themi është investuar, por për shkak të gjendjes të rrugës, dhe ju e dini shumë mirë, problemi kryesor i asaj rruge është toka me probleme gjeologjike dhe nuk është e vetmja kjo rrugë në Skenderaj, po mendoj janë nga 10 -15 vende që kemi këso gjendje nëpër Kosovë. Për atë arsye ne nuk kemi vepruar, që veç të vendoset ose të shtrohet, sepse e dimë që ka për të pasur rrëshqitje të tokës, sepse është tokë jostabile. Janë duke u bërë matjet gjeologjike, duhet të kemi rezultate gjeologjike për të marrë veprime se si duhet të bëhet ajo, me qëllimin që të mos na paraqiten përsëri dëmtime, sepse jemi të bindur se çfarëdo ndërhyrje ose përfundimi i saj në atë mënyrë siç është bërë në të kaluarën, për shkak të problemeve të ujërave nëntokësorë, jemi të bindur sipas ekspertëve që ajo rrugë nuk mund të qëndrojë shumë, prandaj ekspertët kanë paraparë matje gjeomekanike, hidrologjike dhe pastaj të gjendet forma se si ai segment i vogël, një pjesë e shkurtër e asaj rruge është që të paktën të minimizohen dhe të mos kemi probleme siç ka pasur në të kaluarën. Ajo rrugë që nga ndërtimi ka pasur probleme të tilla, por siç thashë, janë probleme gjeologjike.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, ke pyetje shtesë?

GANI GECI: Faleminderit, ministër!

Unë do të ngrejë edhe një çështje rreth rrugëve. Do të kthehem prapë te rruga Skenderaj – Vushtrri. A keni dëgjuar diku që mjetet e firmës, mbasi të punohet rruga, e prishin të njëjtën rrugë përpos në rrugën Vushtrri – Skenderaj. Mjetet që kanë punuar, e kanë prishur brenda një jave. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Po, ndodh ajo, ndodh ajo që mjetet që punojnë dhe e rehabilitojnë, mund të ndodh ajo, edhe mbas një jave, mbas dy dite, po jo bash mbas një jave. Po, sido që të jetë, mendoj që rruga Polac, ose më mirë të themi rruga Skenderaj – Vushtrri është bërë sikur kalaja. Asnjëherë nuk është marrë seriozisht të investohet, është investuar një herë 200.000 euro, tjetër herë 200.000 euro, janë ndërruar kompanitë dhe problemet për të cilat folëm, edhe për problemet pronësore, asnjëherë s’ka pasur qasje serioze për ta filluar dhe përfunduar atë projekt. Mendoj që derisa unë e ti sot po flasim për kilometrin e fundit, tregoj që këtu ka qenë një projekt serioz dhe ne, normalisht, bartemi edhe me pasojat. Është fakt që ka pasur edhe probleme në të kaluarën dhe ne tash jemi të obliguar t’i sanojmë pasojat e të kaluarës.

KRYETARI: faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seancat plenare, do të publikohen në Revistën e Kuvendit.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij Projektligji.

Ftoj ministrin e Administratës Publike, zotin Arsim Bajrami, që në emër të qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për procedurën administrative ka qenë i miratuar më 22 korrik të vitit 2005. Pas miratimit të këtij ligji, është bërë studimi i realizimit dhe janë vërejtur disa mangësi. Si pasojë e kësaj, Ministria e Administratës Publike ka propozuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Më lejoni të prezantoj se cilat fusha prek ky ndryshim i këtij projektligji.

Pjesa e parë e ndryshimeve është terminologjike dhe nënkupton që ky ligj harmonizohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet e Kuvendit të Kosovës, sepse ligji në shumë nene i është referuar Kornizës kushtetuese dhe i është referuar legjislacionit të aplikueshëm. Pra, pjesa e parë e ndryshimeve janë krejtësisht terminologjike dhe nënkupton harmonizimin e ligjit me Kushtetutën e Kosovës dhe me ligjet e miratuara në Kuvendin e Kosovës.

Pjesa e dytë e ndryshimeve synojnë të bëjnë azhurnimin dhe efikasitetin e procedurave administrative, duke adoptuar afate shumë më të shpejta të organeve administrative dhe duke i eliminuar disa pengesa që janë vërejtur në procedura administrative.

Pjesa e tretë e ndryshimeve, që ne vlerësojmë pjesa kryesore, është pjesa që qytetarëve të Kosovës ju mundëson fillimin online të procedurave administrative apo fillimin e procedurës përmes internetit. Kjo është risia kryesore sepse organet që e zhvillojnë procedurën administrative duhet të pranojnë fillim online dhe duhet t’ia japin menjëherë

konfirmimin përmes internetit palës që është filluar procedura administrative. Kjo në shembullin praktik do të thotë se ne për një leje ndërtimore do të mund të aplikojmë përmes internetit, duke ia parashtruar kërkesën organit kompetent komunal që zhvillon procedurën, në atë moment e fillon procedurën.

Pjesë e këtij procesi të kibernetizimit të administratës është edhe mbledhja ex officio nga organi i administratës e provave në favor të qytetarëve, çka do të thotë se në qoftë se qytetari e fillon një proces administrativ dhe nuk ka parashtruar prova të mjaftueshme për të realizuar një të drejtë apo një interes, organi që zhvillon procedurën administrative është i obliguar që në emër të palës të mbledh këto prova. Kjo është në pajtim me konceptin që administrata është një shërbim për qytetarë dhe organi i administratës duhet të evokojë për palën që të mbledhë provat, po e zëmë, do të mund online të sigurojë fletën poseduese apo do të mund të ketë qasje në aparatin kadastral, në mënyrë që palët mos të maltretohen dhe të mos kenë shpenzime në procedura administrative në realizimin e të drejtave që ju garanton Kushtetuta. Pra, për herë të parë po mundësohet fillimi përmes internetit online nga çdo pikë e Kosovës procedura administrative dhe realizimi i të drejtave kushtetuese të qytetarëve.

Pjesa e katërt e ndryshimeve lidhet me zhvillimin e procedurave administrative në përfaqësitë tona diplomatike dhe konsullore. Tanimë përfaqësitë tona diplomatike dhe konsullore kanë filluar me procedura administrative, jo vetëm me shërbime për qytetarët, por në një të ardhme edhe me proceset e furnizimit të qytetarëve me dokumente personale, me dhënie të certifikatave, kështu që këto ndryshime mundësojnë që të krijohet baza ligjore për zhvillimin e procedurave administrative në përfaqësitë tona diplomatike dhe konsullore.

Të nderuar deputetë,

Jemi të sigurt që me këto plotësime të këtij ligji, që është ligj bazik për procedurën administrative, do të shtohet efikasiteti, azhuriteti i proceseve administrative, njëkohësisht do të ofrohen lehtësimet e ndjeshme për qytetarët në mënyrë që qytetarët vërtet të marrin shërbime të shpejta, efikase dhe shërbime sa më të lira nga Administrata Publike. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtar i Kryesisë, zoti Etem Arifi

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Pas prezantimit të Projektligjit, hapim debatin për diskutim, në parim. Kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, nëse e kërkon fjalën. Ju faleminderit!

Kryetarët e Komisioneve?

Të grupeve parlamentare?

Grupi Parlamentar i PDK-së, nëse e kërkon fjalën, Hajredin Hyseni. Urdhëro, Hajredin!

HAJRDIN HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh se qëllimi i institucioneve është modernizimi i administratës për të mundësuar efikasitetin e saj, sjellja e këtij Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e procedurave administrative, është për t'u përshëndetur, sepse me këto ndryshime plotësohen zbrazësitë që ekzistojnë deri tani në ligj.

Projektligji për procedurat administrative me plotësimet e bëra Ligjin e bën më të qartë dhe efikas, duke mundësuar dhe lehtësuar komunikimin, siç është komunikimi elektronik, siç parashihet në nenin 11 dhe kjo është konform synimeve të Qeverisë për një E qeverisje, apo qartëson dhe plotëson disa nene, si për shembull, çështjen e ankimit. Mendoj se në disa nene nevojitet një qartësim më i madh, si për shembull, te neni 6, pika 14 të jetë më preciz dhe më i qartë duke saktësuar kompetencat, mirëpo plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për procedurat administrative është i nevojshëm. Andaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah në parim këtë Projektligj, duke dhënë kontributin në komisione funksionale.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar i LDK-së, Melihate Tërmkolli e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni, Melihate!

MELIHATE TËRMKOLLI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative. Mendojmë që është një ligj i punuar mirë, është nga një ato ligjet, në fakt, të punuara mirë dhe mjaft të qarta, ani pse ka disa mangësi të cilat besojmë se do të mund të përmirësohen gjatë punës së komisioneve përkatëse në kohën e amendamentimit të këtij ligji. Është e qartë që janë disa ligje apo, në fakt, janë shumë nga ligjet që kanë nevojë të kenë disa ndryshime për arsye, në radhë parë, të ndryshimit të statusit të Kosovës, që si rrjedhojë kërkon edhe ndryshime në legjislacionin tonë, por janë edhe do ndryshime të cilat janë të domosdoshme për faktin e zbatimit më të mirë të tyre në praktikë, sepse ka pasur edhe zbrazësi të caktuara. Mund të them që ky ligj, thjesht është një nga arsyet e ndryshimeve. Ka të bëjë pikërisht me zbrazësitë të cilat janë vërejtur gjatë zbatimit të tij në praktikë dhe bile, do të thosha, ka qenë e udhës që edhe më herët të sillet në Parlament për faktin që shumë herët janë vërejtur zbrazëtitë në zbatimin e këtij ligji dhe, natyrisht, pjesa tjetër e cila lidhet me ndryshimin e statusit, me Kushtetutën e Kosovës dhe që sidomos do të sjellë edhe ndryshimet e caktuara. Natyrisht, disa çështje që janë cekur më shumë edhe te neni 7 e tjerë, mendoj se ka vend për t'u përmirësuar, por në esencë edhe një herë po them, është një ligj i mirë dhe Grupi Parlamentar i LDK-së, e mbështet, e përkrahë, në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, Melihate!

Nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Donika Kadaj – Bujupi e ka kërkuar fjalën.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji dhe atë që u tha më herët që më në fund do të marrin fund edhe maltretimet e qytetarëve të Kosovës, por me theks të veçantë të njerëzve nga diaspora, të cilët do të kenë qasje më të lehtë, më të lirë, më profesionale në realizimin e të drejtave të tyre për marrjen e dokumentacionit, në parim e përkrahim, ndërkaq të gjitha rekomandimet lidhur me avancimin e këtij ligji do t'i japim pranë komisioneve funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete!

Nga Grupi Parlamentar i AKR-së, zotëri Riza Smaka!

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

I mbështesim plotësisht propozimet për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për procedurën administrative. Ky është një ligj tepër i rëndësishëm për të qenë çfarë duhet të jetë dhe, natyrisht, në procedurë deri në miratim do një sugjerim qëllimshëm. Po e zëmë, konkretisht te neni 4, - parimet, e ka edhe parimet e tjera, përpos atyre që janë propozuar. Ndoshta do të ishte mirë, ndoshta me amendmente, më pastaj te kompetenca territoriale, që është përjashtuar mundësia e negocimit të juridiksionit, ndoshta ka vend për ta rishikuar këtë pozicion. Edhe te neni 17 dhe 84, ku nuk është definuar, ne e kuptojmë, bie fjala, mirëpo duhet të llogarisim për nëpunësin civil, referentin/referenten që nuk mund ndoshta ta kuptojë si duhet në kompleks. Edhe është çështja – ankesa e gjykatës, kështu që e çon, procedurën administrative e orienton në gjykatë, e në parim ishte dashur të shkojë nga procedura administrative vetëm në Gjykatën Supreme, me kërkesëpadi në konfliktin administrativ. Përfundimisht, e përshëndesim propozimin. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Nga Grupi Parlamentar i LDD-së, Synavere Rysha e ka kërkuar fjalën.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet, në parim, Projektligjin për procedurën administrative, përkatësisht ndryshimin dhe plotësimin e tij nga fakti se është edhe e nevojshme dhe e domosdoshme dhe me këto ndryshime do të jetë më i zbatueshëm në praktikë dhe do të jetë më i lehtë edhe për qytetarët dhe do të jetë në shërbim të tyre në mënyrë më efikase dhe efektive.

Duke pasur parasysh se ky projektligj nuk ka kaluar përmes komisioneve funksionale, mirëpo për herë të parë është shtruar të trajtohet në Kuvend, ne do ta mbështesim, në parim, dhe kontributin tonë do ta japim pas fazës së parë, do të thotë pas leximit të parë në komisionet ku do të jetë edhe ky Projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete!

Për Grupin Parlamentar “7+”, Shpresa Murati është lajmëruar. Regjia, fjalën deputetes Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, presedavajuči!

Pozdrav svima,

Parlamentarna grupa „7+“ razmatrala je Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona o upravnom postupku i smatra da će predložene izmene i dopune uticati na bolje i efikasnije sprovođenje ovog zakona u praksi.

Izmene se prvenstveno odnose na podnošenje podnošenje zahteva za razmatranje i žalbe protiv postpanja u upravnom postupku. Organi javne uprave u sprovođenju upravne delatnosti imaju zadatak da strankama omoguće da lakše zaštite i ostvare lične interese, vodeći računa da ostvarivanje njihovih interesa ne bude na štetu interesa drugih lica, niti u suprotnosti sa javnim interesima. S toga, Parlamentarna grupa „7+“ podržava ovaj Nacrt zakona u načelu i dače svoj doprinos tom njegove dalje procedure. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete!

Për Grupin Parlamentar të SLS-së nuk ka të lajmëruar. Për Grupin Parlamentar për Integrim, zoti Numan Baliqi e ka kërkuar fjalën.

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Da poselamim sve koji su prisutni u sali i da se kratko osvrnem na ovaj zakon. Slažem se sa iznetim mišljenjima vezano za dobre namere ovog zakona i sa onim što je takođe gospodin ministar nagovestio, odnosno jasno rekao oko toga da će zakon zaista omogućiti da pruži usluge koje će poboljšati administraciju i ispraviti one nedostatke koji su evidentni i koji su do sada postojali.

Od velike je važnosti ono što smo čuli a koje se tiče da će se ovim zakonom omogućiti najpre kibernetizacija, kako je rečeno, odnosno prostiranje na internetu svih mogućih obaveštenja vezano za administrativne usluge i takođe vezano za usluge koje se tiču za regulisanje pojedine dokumentacije, kao što su posedovni listovi ili druga dokumentacija koje će administracija biti u mogućnosti da osigurava zainteresovanim stranama. Ovo su sve značajni razlozi da zakon onako kako je propisan, zaista jeste obećavajući i da nastojimo da nedostatke koje postoje unutar zakona, da se isprave, da se dopune, da se poprave i da se ono što mislimo da treba još dopuniti, da se uradi do drugog čitanja, a da pozdravimo ovo što u zakonu zaista jeste nagovešteno i što će zakon omogućiti, zatim da naravno insistiramo na tome da kod primjene zakona, da ovo bude jedan od zakona koji će na startu, na početku omogućiti dobru primenu u interesu svih građana, jer očigledno i ovime završavam, da će ovaj zakon dati značajne usluge kako građanima koji žive u zemlji, ali takođe, s obzirom da će biti putem interneta, i onim građanima koji se nalaze van Kosova, dakle svim građanima Kosova će biti značajno olakšano pružanje koje daje javna administracija. Hvala lijepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Deputetët, sipas radhës së paraqitjes. Zonja Nerxhivane Dauti e ka kërkuar fjalën.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për procedurën administrative dhe ai për konfliktin administrativ që pritet të shqyrtohet në këtë Kuvend, paraqesin ligjet më të rëndësishme në sferën e Administratës Publike. Me këtë projektligj synohet të adresohen çështjet thelbësore të cilat kanë të bëjnë me parimet udhëheqëse administrative, si parimi i mbrojtjes së interesave private dhe publike, parimi i dëgjimit të palëve, e drejta e ankesës dhe parimi i formës përfundimtare dhe ai i formës së prerë, paraqitja e kërkesës në formë elektronike dhe konfirmimi i pranimit të kërkesës nga Administrata Publike.

Nevoja për këtë projektligj është paraqitur pasi që në Ligjin për procedurën administrative kanë mbetur paqartësi, sidomos te paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe ankesë kundër veprimit të marrë në procedurën administrative. Projektligji i propozuar nuk është në kundërshtim me parimet themelore të Traktatit të komunitetit evropian, në veçanti të parimit të supremacisë, parimit të bashkëpunimit lojal dhe parimit të subsidiaritetit. Projektligji i propozuar sjell ndryshime dhe plotësime të rëndësishme në lëmin e procedurës administrative, të cilat i konsideroj të rëndësishme, por megjithatë konsideroj se duhet bërë në disa nene edhe riformulime përkatëse me qëllim të

precizimit më të mirë jo vetëm të teknikës juridike, por edhe të çështjeve thelbësore të procedurës administrative që rregullohen me këtë projektligj.

Kështu, në nenin 4 propozoj që titulli i nenit të jetë: - Parimi i mbrojtjes së interesave private dhe publike.

Në nenin 9 b), paragrafi 1, propozoj riformulimin: “Kundër vendimit të marr në shkallë të parë, pala ka të drejtë të paraqesë ankesë”. Vetëm me Ligj mund të përcaktohet, që në çështje të veçanta administrative ankesa të mos lejohet në qoftë se në ndonjë mënyrë tjetër është siguruar mbrojtja e të drejtave dhe e ligjshmërisë.

Në nenin 9 c), propozoj riformulimin në këtë mënyrë: “Vendimi kundër të cilit nuk mund të paraqitet ankesa”, fjala është për vendimin përfundimtar në procedurën administrative “dhe as të iniciohet konflikti administrativ”, vendimi i formës së prerë, me të cilin pala ka fituar të drejtat e caktuara, përkatësisht me të cilin palës i janë caktuar disa detyrime, mund të ankohet, të ndryshohet vetëm në rastet e përcaktuara me ligj, e jo ashtu siç është përcaktuar në Projektligjin e propozuar.

Në nenin 41, propozoj këtë riformulim juridik: “Dorëzimi i kërkesave për fillimin e procedurës administrative në zyrat e përfaqësive diplomatike ose konsullore”.

Në nenin 29, paragrafi 1, propozoj këtë riformulim: “Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim, shtynë të drejtën dhe afatet për ushtrimin e ankesës deri në mënyrën e vendimit sipas kërkesës për rishqyrtim”.

Duke marrë parasysh rëndësinë e ndryshimeve të propozuara me procedurën administrative, si dhe rëndësinë e veçantë që ka Ligji për procedurën administrative e mbështes Projektligjin e propozuar në shqyrtim të parë, ndërsa kontributin tim profesional do ta paraqesë në komisionin funksional. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Sipas radhës, deputetja Rita Hajzeraj e ka kërkuar fjalën.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për procedurën administrative në vazhden e tij ka disa ndryshime dhe në kuadër të këtyre ndryshimeve më ra në sy dhe është fare e paqartë te neni 2, ku thotë: “te neni 1 të ligjit, pas paragrafit 1.3, shtohet paragrafi 1.4, kur për një pjesë ose për tërë aspektet e veprimtarisë administrative, për të cilat me ligj është caktuar procedurë e veçantë, veprohet sipas atij ligji”. Pastaj, thotë: “sipas dispozitave të këtij ligji”, tash cili është ai ligj dhe cili është ky ligj, është shumë i paqartë si paragraf. “Veprohet në të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar me ligj të veçantë”, prapë. Ndoshta kisha dashur një sqarim prej ministrit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Nuk ka problem, nëse Ministri e kërkon fjalën

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Dëshiroj t’i falënderoj të gjitha grupet parlamentare dhe deputetët që i dhanë mbështetje. Natyrisht, ne do të mirëpresim amendamentet dhe kontributet për sqarimin e çështjeve të caktuara. Te rastin konkret i koleges Rita Hajzeraj, dëshiroj të jap përgjigje sepse ky ligj vendos rregullat e përgjithshme të

procedurës administrative, për të gjitha procedurat administrative, por me ligjet e veçanta për disa procese administrative, ka procedura të veçanta. Po e zëmë, në qoftë se aplikoni i për furnizimin me një leje për një armë, që është një proces administrativ, ai proces është pak specifik dhe nuk vlejnë disa rregulla të këtij ligji, aplikohen rregullat e ligjit specifik. Këto përjashtime janë shumë të vogla, parimisht, procedurat administrative e kanë këtë ligj organik si ligj bazik, por për proceset e caktuara që janë specifike dhe që caktohen me ligje të veçanta si specifike, ka disa përjashtime të procedurave administrative.

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër! Lus regjinë që t'i ftoj deputetët për votim, me anë të ziles. Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin, në parim, të Projektligjit. Presim derisa të na vijnë deputetët.

Aktualisht në sallë kemi 51 deputetë. Kërkojmë që të na vinë edhe të tjerët.

Tani në sallë kemi 62 deputetë. Vazhdojmë me procedim të votimit. Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim. Votojmë, tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokatin e Popullit

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e parë të projektligjit.

Ftoj ministren e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin. Ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar kryesues i seancës plenare,

I nderuar ministër,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Në emër të Ministrisë së Drejtësisë, para jush sot prezantoj Projektligjin për Avokatin e Popullit.

Unë do t’ia filloj pak më ndryshe sot nga pjesa teknike.

Ky projektligj ka 6 kapituj, dispozitat e përgjithshme, propozimin për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij, kompetencat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit, procedura e shqyrtimit të ankesave, zyra, objekti, personeli dhe buxheti i institucionit të Avokatit të Popullit dhe dispozitat kalimtare, pra gjithsej ka 38 nene dhe 6 kapituj.

Institucioni i Avokatit të Popullit për herë të parë është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut, 2000/38, datë 30 qershor 2000. Ka pasuar më 16 shkurt 2006, ndryshimi i Rregullores së parë, me miratimin e Rregullores së UNMIKU-të 2006/6. Mirëpo, as kjo rregullore nuk ia ka dalë t'i përfshijë të gjitha normat që do të duhej t'i kishte një akt ligjor, në bazë të të cilit funksionin institucioni i Avokatit të Popullit. Kjo ka kushtëzuar edhe ndryshimin tjetër dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/6, i cili ndryshim është bërë me Rregulloren 2007/15, krejt kjo me qëllim të lehtësimit të procedurave për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij, sepse edhe vetë jemi dëshmitarë se kemi pasur problem gjatë emërimit të Avokatit të Popullit.

Megjithatë, as ky ndryshim nuk ka krijuar lehtësira procedurale për emërimin e Avokatit të Popullit, gjë që është vërtetuar edhe me zvarritjen e emërimit të tij, mu për faktin se Kosova u bë shtet i pavarur dhe miratoi aktin më të lartë të saj juridik – Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe institucionet e saj drafatuese dhe miratuese të ligjeve shtruan para vetit detyrën që të hartojnë legjislacion të vetin të harmonizuar me ligjet evropiane dhe standardet ndërkombëtare, Ministria e Drejtësisë planifikoi që në strategjinë e vet legjislative t'i përfshijë të gjitha ato ligje të identifikuara si sfida, sipas Raportit të progresit për Kosovën për vitin 2009, dhe iu qas draftimit të Ligjit për Avokatin e Popullit, me të cilin shfuqizon rregulloret e UNMIK-ut, me të cilat rregullohej më parë e gjithë materia që lidhej me funksionimin e këtij institucioni.

Dispozitat e Projektligjit për Avokatin e Popullit janë në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së, me standardet ndërkombëtare dhe me ligjet për avokatin e popullit të shteteve që kanë traditë me funksionimin e këtij institucioni.

Ky Projektligj është përgatitur në bashkëpunim me ekspertë të shquar vendorë dhe ndërkombëtarë dhe me pjesëmarrjen e ekspertit nga institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, krejt kjo me qëllim që të hartohet një Projektligj i mirë, i cili ka procedurë të qartë dhe lehtësuese për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij, që të sigurojë pavarësinë dhe paanshmërinë e plotë të Avokatit të Popullit dhe gjatë ushtrimit të punës dhe funksionimit të tij të jetë në nivel të detyrës. Me këtë projektligj krijohet një mekanizëm ligjor, i cili siguron mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë e juridikë nga veprimet joligjore apo mosveprimet e institucioneve publike, të cilat ligjërisht janë të detyruara t'i ndërmarrin ose që janë të detyruara të përmbahen nga ndërmarrja e atyre veprimeve. Pastaj, mundësohet sigurimi i qasjes në drejtësi për të gjithë qytetarët dhe qasja në dokumentet zyrtarë për palët e interesuara. Sipas këtij projektligji, Avokati i Popullit është institucion i pavarur, që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, të konfidencialitetit dhe të profesionalizmit.

Fuqizimi i rolit të Avokatit të Popullit është i një rëndësie të veçantë për qytetarët e Kosovës, sepse këta fitojnë besimin për punën e këtij institucioni për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre nga veprimet, siç u cek, dhe mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.

Pjesa më e rëndësishme e projektligjit është përgjegjësia e Avokatit të Popullit për t'i hetuar shkeljet e të drejtave, të cilat palët i adresojnë në kërkesat e tyre apo parashtrësata e tyre, për të cilat shkelje Avokati angazhohet që t'i zgjidhë sa më shpejt dhe ta njoftojë parashtruesin e ankesës. Për të gjitha shkeljet e adresuara nga palët, Avokati e informon Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet kompetente të Republikës së Kosovës dhe kërkon që shkeljet eventuale të eliminohen.

Fushëveprimi, kompetenca dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit janë shumë të gjëra, sikur që është e gjerë edhe vet lepeza e të drejtave të njeriut, andaj nuk do të ndalem në numërimin e të gjithave. Për të mos e keqpërdorë durimin tuaj, me një raportim më të gjerë, zaten në memorandumin shpjegues është dhënë një shpjegim më i gjerë lidhur me qëllimin, fushëveprimin, procedurat e emërimit, kriteret që duhet t'i plotësoj kandidati për avokat, zëvendësit e tij, procedura për zgjedhjen e tij, të zëvendësve të tij dhe të personelit profesional të institucionit të cilin ai e drejton.

Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij gëzojnë imunitet nga ndjekja penale dhe paditë civile, si dhe nga shkarkimi para skadimit të mandatit lidhur me punën që kryejnë dhe për vendimet që marrin, me kusht që këto të jenë në lidhshmëri me ligjin dhe përgjegjësitë që kanë, përkatësisht që janë cekur saktësisht rastet se kur mund të shkarkohet nga funksionimi, nga funksionet e tyre në rastet tjera, përfshirë edhe përfundimin e mandatit, si formë e shkarkimit të tij.

Avokatin e Popullit dhe zëvendësit e tij i zgjedh Kuvendi i Kosovës apo i emëron Kuvendi i Kosovës, në bazë të procedurave të parapara me këtë projektligj. Pas zgjedhjes, Avokati i Popullit jep betimin në Kuvend. Për ta lehtësuar punën e Avokatit të Popullit, janë përcaktuar edhe kompetencat e tij, është autorizuar që si institucion të nxjerr edhe akte nënligjore të cilave duhet t'u përmbahet gjatë punës së tij.

Me këtë Projektligj është paraparë edhe forma dhe procedura se kur, si dhe në cilat raste qytetarët mund t'i drejtohen me ankesë Avokatit të Popullit apo me parashtrësata të tyre. Sipas këtij projektligji, të gjitha institucionet janë të detyrueshme të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit dhe refuzimi i bashkëpunimit bartë në vete pasojat e përcaktuara me ligj. Për punën e vet, Avokati i Popullit i raporton një herë në vit Kuvendit të Kosovës, por Kuvendi ka mundësi të kërkojë nga ai raporte periodike. Buxhetin për punën e institucionit të Avokatit të Popullit, me kërkesën e tij e miraton Kuvendi i Kosovës dhe ai, përkatësisht institucioni i Avokatit të Popullit e menaxhon buxhetin.

Ministria e Drejtësisë është e bindur se aprovimi i këtij projektligji në Kuvend është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut sipas standardeve të avancuara.

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra të Projektligjit për Avokatin e Popullit, shfuqizohen rregulloret e UNMIK-ut 2006/6, dt. 16 shkurt 2006 dhe 2007/15, dt. 19 mars 2007, kurse Rregullorja 200/38 nuk është paraparë të shfuqizohet, sepse me miratimin e Rregullores së re 2006/6 ajo Ex lege, shfuqizohet dhe në bazë të parimit Lex posterior derogat legi priori.

Ndoshta në projektligjin që u është dorëzuar juve është paraparë që edhe kjo rregullore të shfuqizohet, por unë do të dëshiroja që këtë ta konsideroni si një gabim teknik.

Të nderuar deputetë,

Ju lus që këtë ligj ta miratoni në lexim të parë, sepse vërtetë është një ligj i një rëndësie të veçantë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja ministre Kelmendi!

Vazhdojmë sipas radhës. Kryetari ose raportuesi i komisionit funksional, nëse e kërkon fjalën. Urdhëro, deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka shqyrtuar, në parim, Projektligjin për Avokatin e Popullit dhe konsideron se Projektligji në fjalë është i një rëndësie të veçantë për institucionet e Kosovës, sepse po e mbulon një zbrazësi juridike, e cila nuk ka qenë e rregulluar mirë deri me tani dhe, ju e dini, për këtë fushë kanë qenë dy tri rregullore të cilat ai kemi përdorur për me ardhur deri te zgjedhja e Avokatit të Popullit, si institucion, si kategori kushtetuese shumë e rëndësishme për vendin.

Në Komision, përveç kësaj që jemi pajtuar ta pranojmë, në parim, Projektligjin, kemi ngritur edhe një çështje që ka qenë me interes – a thua duhet që Komisioni për Legjislacion të jetë komision funksional apo të jetë Komisioni për të Drejtat e Njeriut, mirëpo me shumicë votash ka qenë mendimi që, për shkak të rëndësisë që ka, Komisioni për Legjislacion të jetë komision funksional, mirëpo pa pengesë që edhe komisionet e tjera, e sidomos Komisioni për të Drejtat e Njeriut të jetë bashkërisht i involvuar në proces për të bërë një ligj çfarë duhet. Meqë ministrja i tha në detale, pothuaj lexoj ndoshta edhe pjesën më të madhe të projektligjit, unë do të ndalesha vetëm te disa nga dilemat që do të duhej, ndoshta, si deputet t'i kemi parasysh. E para, është që projektligji nuk i ka përkufizimet dhe është mirë që projektligji t'i ketë përkufizimet. Ne sapo kemi kaluar edhe Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale pa përkufizime dhe është shumë ngarkesë për ne si komision t'i bëjmë përkufizimet. Ndoshta është mirë të mendojmë që, ndoshta, Ministria e Drejtësisë, gjatë kohës së leximit të dytë, t'i përgatitë përkufizimet që është e domosdoshme, sepse është për herë të parë, por bëhet ligji dhe është mirë t'i ketë edhe përkufizimet.

Një çështje tjetër, ndoshta është mirë, në deklaratën financiare janë paraparë implikime buxhetore, sepse nuk e di a është shqyrtuar mirë edhe ajo pagesa që do të duhej të bëhej, nëse dikush nga zëvendës avokatët nuk zgjidhet për një vit apo nga Avokati, mirëpo përveç asaj, megjithatë janë 50.000 euro obligime buxhetore, të cilat nuk janë paraparë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe është mirë që Ministria e Drejtësisë, së bashku me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa, të parashohin në buxhetin, së paku të vitit 2011.

Unë do të ndalesha në disa nene të cilat janë pak diskutuese, është neni 4, mendoj është i panevojshëm, i parashihet gjuhët. Gjuhët janë të parapara në Kushtetutën e Kosovës dhe në Ligjin për gjuhët dhe mendoj se ky nen vetëm e bën më të diskutueshëm dhe më të ngarkueshëm. Në projektligj nuk ka nevojë të jetë fare.

Në nenin 7, paragrafi 2, shkruhet, thotë se Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij nuk marrin pjesë në organizmat drejtues, organizatat civile, ekonomike dhe tregtare. Duhet të riformulohet, nuk duhet të marrin pjesë, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë, sepse ne nuk mundemi tani të mendojmë se a marrin apo nuk marrin pjesë, mbetet çështje hipotetike.

Neni 8, paragrafi 3, flet për një komision ad-hoc, i cili do të merret me çështjen e Avokatit të Popullit. Jo, unë mendoj se çështja e komisionit ad-hoc më nuk duhet të vijë në shprehje, kjo është kategori kushtetuese Avokati i Popullit dhe duhet t'i bartet njërit nga komisionet funksionale apo komisionet e përhershme, sepse është çështje mjaft me rëndësi dhe nuk ka mundësi që një komision ad-hoc të mblihet sa herë që duhet, qoftë të zgjidhet procedura për zgjedhje, qoftë procedura për ndonjë raport apo ndonjë çështje që ngrihet në komision. Tash e tutje duhet të mendojmë se cili nga komisionet parlamentare, si komision i përhershëm apo komision funksional, por të jetë i përhershëm dhe të diskutojë për çështjet, qoftë për përzgjedhjen, qoftë për konkursin, qoftë edhe për procedurat tjera. Komisioni ad-hoc nuk do të ketë mundësi që të merret me një kategori kushtetuese e cila duhet dhe merr kohë edhe për raportin, edhe për zgjedhjen, edhe për përzgjedhjen.

Çështje tjetër me interes në nenin 8, paragrafi 4, është paraparë që publikimi, thirrjet bëhen nga komisioni. Nuk është praktikë e mirë, sepse komisionet nuk mund të bëjnë as thirrje publike, për këtë ekziston Sekretaria e Kuvendit të Kosovës dhe duhet t'i bëjë Kuvendi i Kosovës, sepse Avokati i Popullit është institucion të cilin e zgjedh Kuvendi i Kosovës dhe nuk do të ishte e rrugës që komisioni parlamentar tash të bëjë ftesë edhe publike, por edhe për shpallje publike, por ta bëjë Kuvendi i Kosovës.

Një çështje tjetër shumë me interes është paraparë zgjedhja e zëvendësve të avokatit nga Avokati i Popullit. Ndoshta është praktikë e mirë, edhe pse janë 5 zëvendës të Avokatit të Popullit, por propozimi thuhet me ligj se do të bëhet në Projektligj, në të vërtetë do të bëhet nga Avokati i Popullit, kurse Kuvendi i Kosovës duhet t'i zgjedhë përmes votave. Mirëpo, këtu tash lind një dilemë, nuk është rregulluar procedura. Në Ligj thotë se Avokati i Popullit i propozon Kuvendit të Kosovës, nuk ka qenë një praktikë asnjë institucion nuk i propozon direkt Kuvendit të Kosovës pa kaluar, së paku, në njërin nga komisionet funksionale apo komisionin e përhershëm. Nëse duhet veç t'i propozojë Avokati i Popullit, megjithatë unë mendoj se duhet t'i propozojë përmes ndonjë komisioni, pavarësisht cili do të jetë komisioni funksional për këtë çështje, por jo t'u lihet mundësia që të propozohet direkt në Kuvend, sepse mandej do të kemi dilema edhe sa i përket përmbushjes së kushteve, të parimeve, kështu me radhë dhe do të kemi një situatë që do të na sjellë në vështirësi për aprovim.

Një çështje tjetër është me interes është edhe në nenin 9, paragrafi 3, kur flitet edhe për çështjen ndoshta të pagave që janë paraparë.

I nderuar ministër,

Është mirë ndoshta ta kemi parasysh, është një e drejtë, që është mirë t'u jepet mundësi që pas përfundimit të mandatit të paguhet edhe për një vit paga, por nëse bash duhet dhe nëse kalon në ligj, atëherë do të ketë implikime jo 15.000 euro për vit, por implikimet buxhetore do të jenë shumë të mëdha, por mund ta kemi rastin që 5 zëvendësit dhe e Avokati të përfundojnë në të njëjtin mandat dhe të mos zgjidhen më, atëherë implikimet buxhetore duhet të jenë më të mëdha dhe duhet t'i kemi parasysh që, së paku, të kemi në kodin buxhetor rezerva të mjeteve, sepse mandej në praktikë do të jetë e vështirë për t'u zbatuar. Ju faleminderit, këto do të ishin disa nga vërejtjet për të cilat mendoj që do të diskutojnë edhe kolegët në vijim, mirëpo ndoshta përqendrimi duhet të jetë në këto çështje sepse janë shumë të rëndësishme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Atëherë, ftoj grupet parlamentare, Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike. Kush e ka kërkuar fjalën? Deputetja Selviqe Halimi e ka fjalën.

SELVIQE HALIMI: Ju faleminderit!

Të nderuar, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për Avokatin e Popullit dhe mendon se në aspektin përmbajtësor, sa i përket organizmit të funksionimit të këtij institucioni, procedurave, emërimit, shkarkimit të kompetencave dhe mënyrë së punës, është i hartuar mirë, duke pasur parasysh edhe faktin se me këtë projektligj shfuqizohen të gjitha rregulloret e UNMIK-ut, të cilat kanë rregulluar këtë fushë, mirëpo jo në mënyrë të detajuar dhe të kompletuar, siç është paraqitur nga Ministria me rastin e ofrimit të këtij projektligji për këtë institucion. Kurse, disa lëshime eventuale apo sqarime rreth plotësimit dhe bërjes së këtij draftligji sa më të kompletueshëm dhe më lehtë të zbatueshëm, do ta japim kontributin tonë në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete Halimi!

Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Kolë Berisha e ka kërkuar fjalën.

KOLË BERISHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke pasur parasysh domosdonë e pasjes së një ligji që rregullon këtë segment të jetës në Kosovë, Projektligjit për Avokatin e Popullit, e miraton në parim dhe zotohet që në procedurën e mëtutjeshme të japë kontributin e tij në evitimin e të metave që i ka prezent. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Zylfije Hundozi e ka kërkuar fjalën ose Donika Kadaaj – Bujupi.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Institucioni i Avokatit të Popullit është trajtuar si kategori kushtetuese dhe pozicionohet e para ndër mekanizmat e pavarur në Kushtetutë. Në nenin 132, paragrafi 2, thotë: “Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës”, prandaj Qeveria nuk mund të hartojë ligje për institucionet e pavarura. Projektligji i sjellë në këtë formë, me vërejtje të shumta, realisht rrezikon çështjen kyçe, që është pavarësia e këtij mekanizmi. Ky nuk është lajm i mirë për institucionet e vendit, nuk është lajm i mirë për qytetarët, për vet institucionin, për tendencën e Qeverisë që të fusë në kthetrat e veta edhe këtë institucion, ndoshta të fundit të pavarur. Prandaj, me qëllim të ruajtjes së pavarësisë së mbetur në këtë institucion, për dallim prej institucioneve tjera që kemi thënë edhe shumë herë dhe tendencës së Qeverisë për të kontrolluar çdo pore të jetë në Kosovës, të gjitha ndërmarrjet, institucionet, mekanizmat e pavarur të cilët kontrollohen politikisht, unë i ftoj të gjithë kolegët deputetë, pavarësisht a janë pozitë apo opozitë, që sot të kërkojnë që ky projektligj t’i kthehet Qeverisë dhe të hartohet nga vetë Kuvendi, sepse do të japim përgjegjësi për çfarëdo forme të politizimit të tij, e që projektligji i sjellë në këtë formë nuk ka tjetër qëllim dhe po e rrezikon dukshëm pavarësinë e tij. Prandaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Grupi ynë Parlamentar kërkon që ky projektligj të kthehet dhe të

hartohet projektligji konform standardeve të kërkuara, konform Kushtetutës, konform Ligjit nga vet Kuvendi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete Kadaj – Bujupi!

Për Grupin Parlamentar, shefi i Grupit të AKR-së, zoti Ibrahim Makolli e ka kërkuar fjalën. Urdhëro!

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,

Nuk është e tepërt të them edhe një herë që ky ligj është i domosdoshëm për Avokatin e Popullit, sepse deri tash është vepruar në bazë të një rregulloreje, por unë do t'i paraqes disa prej vërejtjeve në emër të Grupit Parlamentar, të cilat besoj se do të duhej të merreshin parasysh në procedurat e mëtutjeshme. Për shembull, neni 1- qëllimi i ligjit, që thotë se ky ligj ka për qëllim krijimin e mekanizmave ligjor, e këtu po flasim vetëm për Avokatin e Popullit, si institucion i paraparë edhe me Kushtetutë, prandaj ky ligj nuk ka për qëllim krijimin e mekanizmave, por ka për qëllim rregullimin e organizimit dhe funksionimin e Avokatit të Popullit.

Po ashtu, te neni 6, paragrafi 1.3, ku thotë: “të ketë karakter, ndershmëri dhe moral të lartë”, unë po pyes se me çfarë kandari matet karakteri, ndershmëria dhe morali i lartë i njerëzve. Mendoj se është e tepër dhe nuk do të duhej që të figurojë këtu, sepse është shumë e padefinuar dhe relative.

Neni 7, thotë: “Avokati i Popullit nuk duhet të ushtrojë veprimtari publike, private e tjera” dhe pastaj thotë: “asnjë partie politike, shtetërore, private, profesionale, e tjera” që do të duhej edhe kjo të hiqej, sepse parashihet, bie në kundërshtim me nenin 6.1.6.

Te neni 8, paragrafi 6, thotë: “të propozuar”, do të duhej të zëvendësohej: “kandidatët e propozuar, të paraqitur”, sepse këta paraqiten fillimisht.

Neni 9, zëvendësit e Avokatit të Popullit, thotë po ashtu: “njëherazi zgjidhen nga Kuvendi”, duhet të jetë “po ashtu të zgjidhen nga Kuvendi, me shumicë votash të deputetëve” dhe zgjedhja e zëvendësve të tij, po ashtu procedura për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit do të duhej të ishte e njëjtë me zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe Avokati i Popullit mund vetëm të bëjë rekomandime përkitazi me kandidatët e propozuar, por nuk mund t'i propozojë Avokati i Popullit kandidatët vetë, duhet të shkojë në të njëjtën procedurë sikurse zgjedhja e Avokatit të Popullit ose paraqitja për avokat të popullit.

Neni 16, thuhet: “ruajtja e fshehtësisë zyrtare”, këtu po i bie sikurse ka edhe shumë fshehtësi të tjera.

Po vazhdoj më tutje, që mendoj se është me rëndësi edhe të çështja e pagave ose të buxhetit të Avokatit të Popullit, ku nuk do të duhej të ketë të drejtën e përzierjes asnjë prej institucioneve, as Qeveria, as institucionet e tjera. Në fund, po ashtu e shoh të nevojshme, sepse thuhet në një dispozitë, te neni 36, që flet për diçka inegzistente dhe që nuk është e paraparë as në ligj në të kaluarën. Mandati aktual i zëvendësit të Avokatit të Popullit vazhdon deri në zgjedhjen e zëvendësve të tjerë. Kolegë, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka zgjedhur zëvendës të Avokatit të Popullit. Ky zëvendës është i përkohshëm, pa ndonjë bazë ligjore, i caktuar me vendim intern të vet të Avokatit të Popullit, prandaj si i tillë këtu nuk do të duhej të figurojë. Grupi Parlamentar

i AKR-së e mbështet, në parim, këtë projektligj dhe do ta japim kontributin tonë në procedurat e mëtejme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Makolli!

Për Grupin Parlamentar të LDD-së, deputeti Naser Rugova e ka kërkuar fjalën ose Adem Salihaj. Deputeti Adem Salihaj e ka kërkuar fjalën.

ADEM SALIHAI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se shumicën e vërejtjeve i tha edhe kryetari i komisionit. Ne e kemi shqyrtuar, në parim, në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi. Siç u tha, pra, këtij projektligji, si edhe shumë projektligjeve tjera, nuk e di arsye sepse është një çështje e thjeshtë dhe është një lloj shablloni, i mungojnë edhe këtij përkufizimet, do të duhej t'i kishte qysh në fillim, pastaj edhe në përmbajtjen e projektligjit ka disa paqartësi. Sado që ky projektligj në aspektin gjuhësor është më i mirë se shumë projektligje tjera, megjithatë ka disa pasaktësi që duhet të rregullohen aty-këtu. Nuk është e rregulluar çështja e shkarkimit me këtë projektligj, pra e shkarkimit të Avokatit të Popullit. Këtu thuhet që Kuvendi i Republikës së Kosovës, në përputhje me rregullat e veta, i miraton procedurat formale, që nuk do të duhej të ishte kjo, por do të duhej që ligji t'i përcaktojë procedurat edhe të emërimit, edhe të shkarkimit të Avokatit të Popullit.

Po ashtu, janë edhe disa çështje të tjera. Po e zëmë, edhe për Avokatin, edhe për zëvendësit, madje edhe për këshilltarët e Avokatit të Popullit parashihet që pas kalimit të mandatit të rikthehen në vendin e mëparshëm të punës, pra t'u ruhet vendi i punës për pesë vjet apo nuk e di sa, që mendoj se nuk është në rregull. Kjo nuk vlen as për funksionet e larta, të zyrtarëve të lartë publikë e tjera, e tjera dhe nuk ka arsye të vlejë për Avokatin e Popullit dhe mendoj që është një kategori jokushtetuese dhe nuk duhet të figurojë as këtu. Ndoshta këtu ka pasur ndikim vet Avokati apo dikush në disa formulime që janë këtu.

Po ashtu, nuk është e qartësuar saktë, nëse organet e pushtetit shtetëror nuk ndihmojnë, nuk bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit për një çështje të caktuar që e trajton ai, atëherë cila është mënyra e detyrimit të këtyre organeve për të bashkëpunuar me te. Pra, nuk është gjetur mekanizmi përkatës dhe mendoj që, sado që këtu thuhet se është e obligueshme, nuk është gjetur mënyra se si duhet obliguar ato organe që të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit. Duhet të parashihen, pra, këtu edhe disa pasoja konkrete të organeve të caktuara nëse ato nuk bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit. Po ashtu, edhe te çështja e thirrjes së dëshmitarëve dhe ekspertëve, pra edhe dëshmitarët janë të obliguar që t'i përgjigjen thirrjes së Avokatit të Popullit për ta dhënë dëshminë e tyre aty, megjithatë as këtu nuk ekziston një mekanizëm që do t'i obligonte ata që të paraqiten te Avokati i Popullit për ta dhënë dëshminë e tyre. Pra, janë këto një sërë çështjesh, që mendoj se në procedurat e mëtutjeshme ka mundësi të rregullohen dhe ne e përkrahim në parim këtë Projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar "7+", shefi i Grupit Parlamentar, Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Pozdrav kolegama i malom broju sastava predstavnika Vlade,

Nacrt zakona o Narodnom advokatu gledano u celini je dosta sadržajan, međutim ima odredaba koje mogu da se dorade ili koje nisu potpuno dorečene. Recimo, u članu 4. gde se pominju jezici rada institucije Narodnog advokata, su službeni jezici, dakle predviđeni

Ustavom i zakonom. Mi predlažemo da se doda: „Zakonom o upotrebi jezika“, da to bude jasnija odredba.

U članu 14. „Narodni advokat i njegovi zamenici uživaju imunitet“. Eh, tu malo možemo da razmislimo, jer se Narodni advokat i njegovi zamenici na neki način izjednačavaju recimo sa narodnim poslanicima. Malo je to simptomatično ako znamo da narodne poslanike bira narod ili građani, a Narodnog advokata i njegove zamenike – institucije, mislim da tu ne treba sve to podvesti pod istu ravan, odnosno pod jednakost.

U članu 14, odredbe vezane za obezbeđenje posla nakon isteka mandata, nisu dovoljno niti ubedljive, niti su dovoljno jasne, jer se ide na zapošljavanje po svaku cenu, a recimo kada su u pitanju poslanici, još uvek ni taj Zakon nije usvojen, niti su ove odredbe tako jasno određene u samom Zakonu o poslanicima.

Dalje, kada su u pitanju materijalne prinadležnosti Narodnog advokata i njegovih zamenika, ovde se pominje u članu 32.1, na neki način materijalna nadoknada kao plate visokih javnih zvaničnika. Nije li i to malo sporna odredba – visoki javnih zvaničnici, s obzirom da posao koji obavlja Narodni Advokat i njegovi zamenici, je od prilike savetodavnog a ne naredbodavnog nivoa. Mislim i to je na neki način sporna odredba ili odredba koja treba još da se pojašnjava. Eh, jedan od dobrih članova jeste 29.4 koji omogućuje otvaranje kancelarija po potrebi i van centra države. U celini, mi ćemo ovaj zakon podržati, ali smo predloga da se neke te nejasne i sporne odredbe pojasne u drugom čitanju do konačnog usvajanja. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Murati! Për Grupin Parlamentar të SLS-së, nuk është lajmëruar askush.

Grupi Parlamentar për Integrim, shefi i grupit Numan Baliq e ka kërkuar fjalën.

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ja ću dati, takođe, nekoliko nadam se važnih prijedloga uvezi sa ovim zakonom. Najpre smatram da je zakon dobro pripremljen, da je takođe izbjegao one jezičke i stilske greške od kojih su patili prethodni zakoni da tako kažem, i da je obratio pažnju na sadržinu, jasnoću zakona, koji na sadržajan i jasan način reguliše mnoga pitanja vezano za izbor, opoziv funkciju, delovanje, opseg delovanja i sve druge stvari kojima se bavi ovaj zakon. Zakon naravno ima takođe djelove koje treba doraditi i dopuniti i mislim da treba obratiti pažnju na ono što će predložiti zastupnici ispred grupa i takođe zastupnici pojedinačno.

U vezi sa konkursima koji se pominju u samom zakonu, to je dobro urađeno i dobro je napisano da će oni biti objavljeni na elektronskim i pisanim formama na svim jezicima koji postoji na Kosovu, koji se koriste na Kosovu, ali treba obratiti pažnju na sprovođenje toga dela zakona, da zaista u slučaju objavljivanja konkursa, odnosno oglasa za Ombudspersona, da zaista budu obuhvaćene novine, radio-televizije koje takođe emitiraju svoje programe na jezicima manjinskih zajednica, što do sada nije bilo dovoljno primenjivano, jeste ali ne u onolikoj mjeri koliko je to bilo potrebno.

U vezi sa zamenicima Ombudspersona, tu bih želeo da kažem nešto što je suštinske prirode, na jednoj strani ono što se odnosi na propisani izbor, a na drugoj strani ono što se može desiti u praksi, što bi moglo biti jedna teškoća u momentu primjene ovoga zakona. Vrlo je dobro što Zakon određuje da ima 5 zamenika i što se putem izbora tih

zamenika obezbeđuje i nacionalna i polna struktura, tako da, recimo, imamo obavezno jednog zamenika iz Srpske zajednice, jednog zamenika iz drugih zajednica, jednog zamenika iz redova pripadnika ženskoga pola, to je veoma dobro. Ali, na drugoj strani imamo u praksi problem što kod izbora tih zamenika mislim da bi se to trebalo promijeniti i da ne bi trebao Narodni advokat, odnosno Ombudsperson biti taj koji će predlagati, birati, određivati ili predlagati zamjenike, nego bi se time trebalo baviti odgovarajuća komisija, bilo da je to komisija ad-hoc, ili da je to komisija, odnosno komisija koja se bavila izborom Advokata i zamenika ili jedna od funkcionalnih komisija koja bi bila određena za to. Mnogo je prema meni razumnije i razboritije da one predlažu Parlamentu i da Parlament bira nakon toga i isto se odnosi i na glavnog zamenika. Dakle, ako ostavimo subjektivnosti Ombudspersona, on može sam predložiti nekog zamenika kao glavnog, koji je njemu odgovoran, a mnogo je bolje da se poslužimo drugim kriterijumom, da to uradi bilo komisija ad-hoc koja se bavila izborom ili, naravno, da se poslužimo kriterijumom najvećeg broja glasova od zamenika koji je dobio ili kriterijumom kvaliteta kandidata, među predloženim kandidatima.

Smatram da je to bitno i sa jednog drugog aspekta, zato što u praksi imamo da obično na ovakve visoke društvene pozicije se uglavnom biraju ili ljudi iz većinske zajednice, ili ljudi koji će pripadati muškom polu, prema tome verovatno neće biti izabran neko iz druge zajednice, ili neko od pripadnika ženskoga pola. Zato je bitno da se na ovaj način ograniči uticaj Narodnog advokata na njegove zamjenike, s obzirom da ako on ima mogućnost njihovog biranja, a kasnije vidimo u zakonu da on ima i mogućnost njihovog razrješavanja. To su pitanja koja se trebaju razmotriti, znači i pitanje izbora, i pitanja razrješavanja, sobzirom da znate, ako Narodni advokat ima mogućnosti da nekoga postavi i da ga zamijeni, onda će taj biti, postoji mogućnost da taj njegov zamenik bude poslušan ili serviran, ili da ne bude izabran kako treba, ili naravno da može postojati mogućnost da zamjenici iz redova drugih zajednica zbog mogućnosti da budu stalno zamenjeni, budu pretjerano lojalni ili da podležu diktatu ovoga glavnog advokata koji će imati veoma visoka ovlašćenja.

U svakom slučaju, ovo je jedno razmišljanje koje izražava brigu zajednica vezano za mjesto zamenika i mislim da bi se to trebalo razmotriti i da bi se moglo redefinirati, i naravno da dodam još samo jednu stvar koja se tiče donacija.

U članu, mislim da je 35. kaže se da Institucija Narodnog advokata može primati dodatne donacije i tako dalje, koje ne utiču na nezavisnost. Mislim da je jako teško uskladiti da na jednoj strani Narodni advokat prima donacije, a ne definiše koje su visine, a na drugoj strani očuvati nezavisnost u odnosu na donora, odnosno donatora, darovaoca ili onoga koji daje novac. Obično postoji zavisnost primaoca donacija od onoga koji daje novac i to je jako teško izbjeći. Ovo bi trebalo podrobnije definirati. Dakle, ako se uzmu u obzir sve ove stvari koje sam predložio, i ako se uzmu u obzir zabrinutosti koje sam iznijeo, da se te zabrinutosti uklope odnosno nadoknade, dopune u zakonu, dorade u zakonu, u tom slučaju za mene osobno, a pretpostavljam i za poslanike u Grupi za integraciju, ovaj bi zakon mogao biti prihvatljiv i mi bismo ga mogli glasati. Hvala vam lijepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputetit Baliq!

Pas deklarimeve të grupeve parlamentare, vazhdojmë me deputetët e paraqitur, sipas radhës. Deputetja Melihate Tërmkolli e ka kërkuar fjalën. Deputete, e ke fjalën!

MELIHATE TËRMKOLLI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Desha vetëm dy-tri çështje t'i trajtoj në këtë projektligj, që për mendimin tim përbëjnë esencën e projektligjin. Ato kanë të bëjnë me qëllimin e projektligjit, me përkufizimin e nocionit të institucionit të Avokatit të Popullit dhe me çështjen e fushëveprimit të këtij institucioni. Mendoj se është gabim formulimi që lidhet me qëllimin e ligjit për faktin se ky iu referohet mekanizmave të cilët merren me mbrojtjen e mbikëqyrjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut e tjerë, në kohën kur ky projektligj, në fakt, ka për materie një institucion shumë specifik dhe që është trajtuar në mënyrë specifike seç është Avokati i Popullit.

Është e vërtetë që ka edhe shumë mekanizma të tjerë, të cilët merren me këto çështje, me çështjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, prandaj mendoj që kjo nuk iu referohet disa mekanizmave, por duhet të specifikohet ashtu siç është edhe përmbajtja e ligjit për një institucion të veçantë, siç është Avokati i Popullit.

Tek çështja tjetër është shumë e çuditshme, por gati në..., mos të them në të gjitha ligjet, por në një pjesë të madhe të ligjeve mungon përkufizimi esencial i punës dhe i veprimit të një institucioni. Edhe në këtë projektligj mungon përkufizimi i nocionit të institucionit të Avokatit të Popullit. Çka është Avokati i Popullit, çfarë kategorie, me çfarë merret, çfarë kompetencash ka e tjera, e tjera. Këto janë dhënë pak a shumë në mënyrë të shkapërderdhur gjatë gjithë ligjit, por nuk kemi një përkufizim të saktë të këtij nocioni dhe mendoj se kjo gjithsesi duhet të jetë pjesë e këtij ligji. Së treti, çështja e fushëveprimit të Ligjit, nuk është definuar saktë dhe qartë se cili është fushëveprimi i plotë dhe i saktë i institucionit të Avokatit të Popullit.

Mendoj që pa përkufizimin dhe pa definimin e qartë të këtyre tri kategorive, ky Projektligj del gati që është më shumë procedural e sa përmbajtësor. Do të kërkoja, natyrisht, edhe nga mekanizmat tjerë të Parlamentit që do të merren më tutje, që të definojnë dhe, natyrisht, edhe Qeveria gjatë hartimit të ketë kujdes shumë më të madh në përkufizimet, të cilat mendoj se janë baza dhe esenca e trajtimit të mëturjeshëm të ligjeve. Nuk i duhen këtij Parlamenti ligje procedurale, ani pse procedurat janë çështje të rëndësishme, por ato janë të rëndësishme vetëm atëherë kur në mënyrë përmbajtësore kemi definuar se çka vërtet dëshirojmë të rregullojmë me një ligj të caktuar. Kaq, ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete Tërmkolli! Sipas radhës, deputetja Mimoza Ahmetaj e ka kërkuar fjalën.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Shumë nga fjalët dhe nga ato që kisha për t'i thënë, u thanë nga parafolësit më herët, prandaj do të ndalem në vetëm dy pika apo në vetëm dy nene të projektligjit të cilin sot po e debatojmë. Është fjala te neni 28, pika 3, ku thuhet: "Me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit dorëzon raporte periodike ose raporte të tjera. Me kërkesën e Avokatit të Popullit, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet t'ia lejojë që të dëgjohet". Mendoj se fjalia e fundit duhet ndryshuar dhe duhet ta ketë këtë përmbajtje me kërkesë të Avokatit të Popullit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në një seancë të veçantë, dëgjon Avokatin e Popullit dhe të gjeturat në raportin e tij. Kuvendi i Republikës nuk voton për raportin e Avokatit të Popullit.

Pika tjetër apo neni tjetër, në të cilin unë e kam një vërejtje, është neni 32 pika 1, niveli i pagës së Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij caktohet në pajtim me Ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë publik. Duke marrë parasysh që në Ligjin për zyrtarët e lartë publik ende nuk e kemi, është në procedurë, por ende nuk ka kaluar në Kuvendin e Kosovës, mendoj se kjo çështje duhet të rregullohet me një pikë referimi, me një institucion tjetër të pavarur që është pjesë përbërëse e pandashme e institucioneve shtetërore të Kosovës. Këto ndryshime, këto institucione, për shembull janë gjykatat, që janë një ndër tri shtyllat bazë të shtetit tonë. Në rastin e Republikës së Kosovës, për shembull, një institucion i cili do të mund të ishte ekuivalent me Avokatin e Popullit është Gjykata Kushtetuese. Duke shikuar nga kategorizimi kushtetues, institucioni i Avokatit të Popullit është i po të njëjtës kategori me të, por me rol tjetër specifik. Prandaj edhe kategorizimi i roleve, duke filluar nga udhëheqësit e institucioneve, Avokati i Popullit, gjegjësisht kryetari i Gjykatës Kushtetuese, më poshtë, duhet të jetë i barasvlershëm. Faleminderit! Në parim e përkrah projektligjin dhe përshëndes ardhjen e tij, me shpresë se ndryshimet e tilla do të përfillen gjatë amendamentimit të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!
Deputetja Gjylnaze Syla e ka kërkuar fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,
I nderuar ministër,
Deputetë të nderuar,

Se Projektligji për Avokatin e Popullit është i domosdoshëm, kjo nuk duhet diskutuar, sepse në fund të fundit është edhe kategori kushtetuese. Meqenëse deri më tani kjo është rregulluar, kryesisht me rregullore të UNMIK-ut për Ombudspersonin, gjegjësisht për Avokatin e Popullit, nevoja përsëri për një kornizë ligjore është e domosdoshme. Megjithatë duhet trajtuar në suaza të arritjes së qëllimit pse bëhet ky projektligj dhe unë në këtë e shoh se nuk janë arritur qëllimet e projektligjit, që në radhë të parë është se nuk janë specifikuar sa duhet mekanizmat të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë e institucionit të Avokatit të Popullit, por edhe nuk ka mekanizma specifik për rolin e Ombudspersonit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Çka do të thotë? Mangësitë e këtij projektligji janë se mungojnë përkufizimet, siç është institucioni i Avokatit të Popullit, pastaj mungojnë mekanizmat shumë specifik lidhur me detyrat që i ka ombudspersoni për të bërë hetime dhe ankesat e qytetarëve, mënyra e përzgjedhjes dhe e shkarkimit, domethënë, duhet përcaktuar shumë saktë procedurat edhe për zgjedhjen edhe për shkarkimin e Ombudspersonit, por edhe të zëvendësve.

Ndërsa sa i përket shqetësimeve të cilat duhet t'i adresojë Ombudspersoni që kanë të bëjë me shqetësimet si administrative, ashtu edhe keqpërdorimet që kanë qytetarët nga organizatat e ndryshme apo burokracia, gjithashtu nuk janë mirë të specifikuar se cilat janë këta mekanizma ligjorë, duke marrë parasysh se edhe parimet në të cilat duhet të bazohet puna e Ombudspersonit e që është e paanësisë, konfidencialitetit dhe e profesionalizmit, gjithashtu nuk është e përcaktuar në këtë projektligj, në parim nuk e përkrah. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!
Vazhdojmë sipas radhës. Deputetja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zotërinj ministra, kolegë deputetë,
Qëllimi i këtij projektligji është që të krijohen mekanizmat legalë për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave fundamentale dhe lirive të personave nga veprimet ilegale, mosveprimet ose veprimet jo korrekt të autoriteteve publike. Projektligji rregullon organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit, duke i vendosur procedurat për shkarkimin, fuqinë dhe mënyrën e punës së institucionit të Avokatit të Popullit dhe rregullon procedurat për mbushjen e ankesave dhe hulumtimin ndaj tyre. Nuk ka rregulla të përcaktuara për punën e Avokatit të Popullit, që do të kërkohej të jenë në përputhshmëri të obligueshme me *asqui communautaire*. Zgjedhja për një shtet që të ketë Avokat të Popullit është çështje nacionale e atij shteti, mirëpo ka praktika më të mira që shtetet e Unionit Evropian i zbatojnë dhe që zgjedhin të ketë Avokat të Popullit, siç është rasti edhe me Kosovën. Nga ana tjetër, në traktatin për funksionimin e Unionit Evropian, është vendosur që të ketë Avokat Evropian të Popullit. Funksionet e tij janë të rregulluara me vendimin e Parlamentit Evropian për rregullat dhe kushtet e përgjithshme të funksionimit të Avokatit Evropian të Popullit, i cili vendim u miratua nga Parlamenti Evropian, më 9 mars të vitit 1994. Avokati Evropian i Popullit nuk merret me rastet që kanë shkelje nga institucionet nacionale, ky merr ankesa nga personat të cilët kanë pasur padrejtësi nga aktivitetet e institucioneve, agjencioneve ose të trupave të Unionit Evropian. Në Raportin e fundit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, rekomandohet që kapacitetet administrative të Zyrës së Avokatit të Popullit duhet forcuar, duhet bërë funksionalizimi dhe operacionalizimi i institucionit në tërë territorin e Kosovës dhe të sigurohet buxhet i mjaftueshëm që do të mundësonte pavarësinë e institucionit të Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë! Deputeti Berat Luzha e ka kërkuar fjalën.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Siç po shihet për këtë projektligj ka shumë vërejtje. Unë kam disa vërejtje përmbajtjesore të cilat shpresoj se do t'i shërbejnë Komisionit funksional gjatë amendimit të tij, do të mundohem të mos i përsëris vërejtjet që u thanë këtu.

Në nenin 7, alinea 1 është përsëritje e nenit 6, alinea 1, pika 6. Kjo aline duhet të riformulohet kështu: “Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij nuk duhet të ushtrojnë veprimtari publike apo veprimtari tjetër profesionale”.

Neni 9, alinea 1 i jep Avokatit të Popullit një mandat pa të drejtë rizgjedhjeje, kurse alinea 3 e po këtij neni ia njuh të drejtën e rizgjedhjes zëvendësve të Avokatit të Popullit. Zëvendësit janë më të favorizuar se Avokati i Popullit, sepse e kanë të drejtën e rizgjedhjes. Meqenëse në të gjitha dispozitat e këtij projektligji Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij kanë të njëjtat procedura dhe privilegje, atëherë e drejta e rizgjedhjes, sikurse e zëvendësve, duhet t'i njihet edhe Avokatit të Popullit.

Në nenin 14, alinetë 2 dhe 4, duhet të fshihen dhe përmbajtja e tyre duhet të inkorporohet në alinetë 1 dhe 3 të po këtij neni.

Neni 18, alinea 2 fjala “ankesë” duhet të zëvendësohet me fjalën “parashtresë”. Palët nuk bëjnë ankesa, nuk i bëjnë ankesa Avokatit të Popullit, por i bëjnë parashtresa.

Fjalja e dytë e kësaj alineje riformulohet. Parashtresa mund të përpilohet edhe me ndihmën e një zyrtari të Avokatit të Popullit.

Neni 20, alineja 1 pika 5 duhet të fshihet, sepse është e paqartë, e pakuptueshme dhe pa përmbajtje.

Neni 23, alineja 2 nuk përcakton saktë përgjegjësinë për nëpunësit civilë, funksionarët dhe autoritetet publike të cilët refuzojnë të bashkëpunojnë me Avokatit të Popullit.

Nëse ky paragraf mbetet kështu siç është, vetëm në kërkesën e Avokatit të Popullit për sanksionet si fillim i procedurës administrative apo përfshirë marrjen e masave disiplinore, atëherë ky institucion do të degjenerojë si i pavlerë.

Nëse refuzimi i bashkëpunimit apo mos përgjigja në kërkesat e Avokatit të Popullit nuk sanksionohet ndryshe, ndoshta edhe penalisht, do të kemi pa papërgjegjësi ndaj këtij institucioni të rëndësishëm.

Neni 28, alineja 3 është gjithashtu i paqartë, prandaj duhet të riformulohet kështu: “Avokati i Popullit i paraqet raporte vjetore Kuvendit të Republikës. Avokati i Popullit mund t’i paraqesë Kuvendit edhe raporte të veçanta apo ta dëgjojë për të gjeturat e tij në mbledhje të veçanta”.

Neni 32, alineja 1 dhe 2 duhet të rishikohen nga komisioni funksional. Caktimi i pagave nuk mund të bëhet me një ligj që ende nuk është miratuar.

Dhe krejt në fund, ligjit duhet t’i shtohet edhe një nen i ri i cili do të mund të formulohej kështu: “Raportet vjetore, raportet e veçanta dhe vendimet e Avokatit të Popullit publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për Avokatit të Popullit është një nga ligjet bazike i cili rregullon dhe tek e fundit sistemon me bazë ligjore një fushë jashtëzakonisht të rëndësishme që tregon seriozitetin edhe të një shteti po edhe vlerat e demokracisë dhe mbrojtjes së drejtave të njeriut në atë shtet dhe në atë shoqëri.

Është një projektligj, mund të them, në një masë të konsiderueshme i hartuar mirë, i strukturuar mirë dhe që jep një bazë ligjore, një fundament edhe legal, por edhe të përcaktimit konkret të rregullativës që e përfshin kjo fushë tejet e rëndësishme për funksionimin e demokracisë së mirëfilltë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në një shtet dhe në një shoqëri.

Me këtë ligj synohet të krijohet tani si shtet i pavarur dhe si shoqëri në tranzicion fundamenti i një sistemi.

Kam disa vërejtje parimore në nene të caktuara të cilat duhet të precizohen, konkretizohen dhe t’i lihen duar të lira përmes këtij ligji Avokatit të Popullit si kategori e veçantë kushtetuese tejet e rëndësishme në të gjitha aspektet.

Fjala është te neni 8 duhet të zëvendësohet, do të thotë, fjala e propozuar me, e paraqitur, sepse merr konotacion tjetër edhe te roli i Avokatit të Popullit, por edhe te

masat që duhet t'i merr Kuvendi si institucioni më i lartë legjislativ që e bën përzgjedhjen e Avokatit të Popullit, por edhe zëvendësve të tij.

Pastaj tek përzgjedhja e zëvendësve të Avokatit të Popullit. Edhe unë e mbështes qëndrimin që sikurse kanë shkuar procedurat ligjore dhe administrative të përzgjedhjes së një liste të ngushtë të 3 emrave kandidatë të mundshëm për Avokatin e Popullit, tani i kemi 5 zëvendës të Avokatit të Popullit. Unë do të kisha propozuar që të vijnë 10 emra që Kuvendi i Republikës së Kosovës të ketë mundësi përzgjedhje, do të thotë të propozuar nga Avokati i Popullit, të ketë mundësi përzgjedhje demokratike kur 2 kandidatë konkurrojnë, do të thotë, është formë demokratike dhe do ta forconte edhe paanësinë po edhe rolin e vetë institucionit dhe zëvendësve të tij.

Një nga nenet kyçe të këtij projektligji është neni 23, paragrafi 2, është një paragraf kyç, i cili ka të bëjë me përgjegjësinë e organeve, institucioneve, autoriteteve, individëve, tek e fundit edhe pushtetit pandan institucionit të pavarur të Avokatit të Popullit.

Unë konsideroj se me këtë paragraf do të duhej të përcaktoheshin: përgjegjësitë, pesha institucionale, morale, por edhe fuqia kushtetuese tani e këtij institucioni jashtëzakonisht të rëndësishëm të pavarur dhe të paanshëm si kategori e veçantë kushtetuese.

Ky paragraf do të propozoja që të ndryshohej, sepse prapë po e nënvizoj – me këtë ligj vendosim bazat e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut si shtet dhe shoqëri demokratike, andaj duhet sanksionuar me ligj dhe në mënyrë precize sanksionet penale, sepse ka institucione të pavarura, për shembull të zgjedhura nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të cilat nuk çojnë peshë nëse sanksionohen me masa të caktuara juridike, administrative apo edhe me gjoba financiare. Thjesht do të ishte e rrugës për hir të fuqizimit të institucionit të Avokatit të Popullit, pavarësisë së tij të plotë në të gjitha aspektet që vërtet ky institucion i rëndësishëm që ka ndikim të madh në zhvillimin e një shoqërie demokratike, në këtë paragraf të precizohen qartë edhe sanksione të mundshme penale, besoj që legalistët, juristët, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, por edhe Ministria e Drejtësisë, këtu do të mund të jepnin konform Kodit Penal tani të Republikës së Kosovës, në mënyrë precize dhe konform kornizës ligjore, t'i sanksionojnë të gjithë ata parametra juridikë dhe ligjorë që e fuqizojnë punën e Avokatit të Popullit.

Si zakonisht ligjet që po vinë në Kuvendin e Republikës së Kosovës po i përcjell një diagnozë kronike e punës së këtij institucioni. Paramendoni, Projektligji për Avokatin e Popullit nuk është paraparë në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2010 – 2012. Dëshëm apo s'dëshëm, direkt ose indirekt, kjo ndikon në punën dhe pavarësinë tani financiare dhe linjës buxhetore të Avokatit të Popullit. Në vlerësimin e ndikimit buxhetor, atje parashihen një shumë shtesë, diku 44.000 euro apo më shumë dhe nuk guxojmë si organi më i lartë legjislativ i vendit, që t'i lëmë ato dilema, andaj kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës, por edhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, të ligjet e tilla bazike që kanë të bëjnë edhe me agjendën evropiane, thjesht mos të figurojnë më në dokumente zyrtare si ky draft-projektligj që Ligji për Avokatin e Popullit nuk është paraparë në kornizën afatmesme 2010-2012, atëherë jemi para dilemave të mëdha se çka mendon Qeveria dhe shteti i Kosovës për këtë institucion dhe pavarësinë dhe paanshmërinë dhe ndikimet politike që janë aq të rëndësishme? Në parim e mbështesim këtë ligj, është një ligj i mirë, por që me këto vërejtje që vërtet edhe Komisioni funksional edhe komisioni hartues i këtij projektligji, do t'i ketë shumë parasysh, sepse është edhe intencë edhe kërkesë edhe e *acquis communautaire* dhe kritereve tjera të

mekanizmave të BE-së që vërtet në këtë fushë të jemi preciz, të jemi konkretë dhe të hartojmë një ligj që i kontribuon sistemit të vlerave demokratike në shoqëri. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Rugova! Sipas radhës deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,
Ministra, deputetë të nderuar,
Disa vërejtje parimore. Nën një, do të duhej, jo vetëm ky, po edhe aktet ligjore tjera të propozuara ta kishin përmbajtjen, në fillim.

Dy. Përkufizimet janë më se të nevojshme, janë më se të nevojshme, sepse i referohen kompleksit të normave konkrete që janë me relevancë për aplikim, më pastaj do të duhej njëjësi, në vend të shumësit, mos të thuhet qytetarët kanë të drejtë, se nëse thuhet asisoj del, mund të rezultojë se qytetari për të pasur të drejtë duhet ta ketë së paku edhe një apo dy të tjerë dhe kudo në aktet ligjore përdoret njëjësi.

Edhe disa vërejtje parimore në nenin 3, 6, 7, 9, 12, 14, 17, shkurtimisht se disa veç u thanë, po qe, po e zëmë, te neni 3. Këtu janë elaboruar 3 parime a janë 15 parime, a një ndër ta, më të rëndësishmit, sidomos për institucionin e Advokatit të Popullit, unë e quaj advokat se advocer i bie prej latinishtes nuk është po e zëmë udhëzimi juridik palës, se pala, ju lutem, ka nevojë, është fjala për advokatin që është ndihmësi në çështjet profesionale dhe do të thotë, meqenëse veç janë përpunuar disa parime, do të duhej të gjitha. Më pastaj ku thotë ta ketë arsimimin e lartë, si kusht, kërkesë. Ju lutem, nuk mjafton kësisoj, për të qenë advokat me parakusht minimal conditio sine qua non, është të jetë jurist i diplomuar, mundësisht edhe me master programs, se nuk mund t'i ndihmojë palës në qoftë se është po e zëmë e ka kryer fakultetin – matematikën a elektronikën a çka po di unë. Respekt për ato profile, po këtu është fjala për akte ligjore dhe kjo është, domethënë nuk është rregull kësisoj. Ose te, ku thotë, të mos jetë anëtar i asnjë partie politike. Këtu bëhet cenim i rëndë i të drejtave elementare të qytetarit, mund të jetë, por në qoftë se do të zgjedhej do të duhej të shkarkohej, se unë nuk e di, pak, të rrallë janë ata, ato, që nuk janë në parti politike. Nuk është në rregull se apriori po e cungon dhe po përjashton numër të madh të njerëzve që mund të jenë kompetentë dhe do të kisha rregulluar ndryshe, në qoftë se konkurren, le të heqë dorë nga partia dhe përfundon çështja.

Te neni 9 ku është përcaktuar se nuk ka të drejtë të rizgjedhet Advokati i Popullit, unë jam i bindur se nuk është propozuar drejt, se në qoftë se është fjala për një person që punon si duhet, pse të mos ta rizgjedhim? Fundi i fundit mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit e më pastaj dy kolegët e nderuar e potencuan statusin e zëvendës-advokatit, i cili është më i avancuar se sa i vetë advokatit, a tek e fundit, në qoftë se do ta përkufizonim mandatin e advokatit, medoemos edhe të zëvendësit, se fundi i fundit ai apo ajo, në kushtet e caktuara do ta zëvendësonte plotësisht me plot kompetencë advokatin, prandaj nuk do të ishte mirë që të.... Ose, ku thotë, ju lutem, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në përputhje me rregullat e veta i miraton procedurat formale përmes të cilave përcakton procedurën lidhur me shkarkimin ose suspendimin. Po kjo është krejt pa lidhje, dispozitë krejt pa lidhje, në vend që të rregullohet me këtë ligj, domethënë kjo i bie ad kalendas grekas, kurrë, “kur të bën shelnja rrush”, se do të duhej tek Kuvendi ta bënte një akt, që ne i dimë procedurat, në bazë të atyre tek pastaj të aplikohet procedura e shkarkimit apo e tjera.

Te neni 17, çdo person i cili pretendon se të drejtat apo liritë e tij janë shkelur me ndonjë ligj, kjo është çështje e rregulluar, ju lutem, është kompetencë speciale e Kushtetutës – neni 113, paragrafi 2, neni 1. Kjo është çështje që nuk është fjala për ligj, se kjo është një sferë tjetër për hir të respektit për kohën nuk po e komentoj, po është çështje kushtetuese dhe kjo nuk është çështje që hyn në këtë skop. Ku thuhet te neni 18, paragrafi 2 “çdo ankesë për fillimin e procedurës si rregull paraqitet me shkrim” Kjo është anti, si me thënë, antipod me synimin e këtij ligji dhe të vetë institucionit të Advokatit të Popullit, se fundi i fundit është edhe në Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative atje e rregulluar fare mirë edhe qëllueshëm se pala, pala gjithmonë, le të jetë doktor i shkencave, po e zëmë juridike për administratën, konsiderohet, pala konsiderohet laike, në favorin e palës dhe tash mund ta imagjinojmë bujkun apo blegtorin apo vreshtarin që nuk merret vesh në ligje dhe në qoftë se duhet ta detyrojmë ta bënte me shkrim, domethënë, një tekno burokraci që e dëbon palën për ta kërkuar ndihmën. Prandaj, do të duhej që deklaratën ta jepte edhe gojarisht a në procesverbal të shënohej edhe çështja e advokatit do të ishte ta procedonte më tutje, është çështje substanciale.

Në parim, natyrisht e mbështesim këtë projektligj, po medoemos duhet të pësojë përmirësime cilësore. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, profesor Smaka! Driton Tali e ka kërkuar fjalën, deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë fillimisht do të nisem nga një çështje që edhe duke i dëgjuar kolegët e nderuar, por edhe duke lexuar këtë projektligj, ende nuk e kam të qartë, domethënë, flas për statusin e këtij institucioni. Duke e lexuar këtë projektligj unë u futa dhe i lexova disa ligje në realitet të institucionit të Avokatit të Popullit në vendet fqinje dhe pashë se ky projektligj, goxha është kopjuar nga ato projektligje, me disa modifikime. Bie fjala, neni 23 alineja apo paragrafi 2 i projektligjit, të cilin po e diskutojmë, thotë kështu: “Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësit civilë, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore” dhe përfundon këtu. Nëse e lexoni Ligjin e Avokatit të Popullit në Shqipëri është identik, vetëm se atje është edhe një fjali që këtu e ka hequr dikush, s’e di pse dhe thotë kështu, pra shtesa apo fjalia që mungon në këtë projektligjin tonë është “deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil” dhe kjo fjali në njëfarë mënyre e jep njëfarë statusi Ombudspersonit, gjersa ky paragraf këtu, unë nuk di se çka, çfarë masa ndërmerr, çfarë procedure administrative, ngase është cunuar aty. Ka kuptim të gjerë, por kurrë konkrete. Dhe sa i përket statusit të institucionit, domosdo këtu edhe u prek nga të tjerët, hapet çështja e statusit financiar apo stabilizimi financiar të këtij institucioni, me qëllim të ruajtjes së pavarësisë dhe këtu del njëfarë pyetje logjike komparative që njeriu e bën, domethënë, pse një institucion i pavarur të paguhet ndryshe nga një institucion tjetër? Bie fjala pse ART-ja të paguhet ndryshe nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe logjikisht pse Avokati i Popullit të paguhet ndryshe nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ngjashëm është, pse ky komision të paguhet ndryshe, të financohet ndryshe nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës? Domethënë, a kemi institucione të dorës së parë, të dorës së dytë, dorës së tretë, rangut të parë, rangut të dytë, rangut të tretë, të cilat pra, konform këtyre rangjeve edhe pastaj t’i rendisim, pra, ato institucione, si bie fjala ART-ja që na vjedhin më së shumti, pra na i humbin 16 milionë e 200 mijë euro, ato i paguajmë, i qesin në rangun e parë, i paguajmë shtrenjtë ata, bordin e tyre, bile-bile tash, varësisht se sa na vjedhin përsëri po them edhe i bëjmë shefat e tyre ambasadorë në vendet e

rëndësishme të Unionit Evropian. Tash nëse vjedhin më shumë i çojnë bën vaki edhe më lart se Sllovenia, kurse shefin e aradhes, varësisht se sa ka lidhje me biznesin e bëjnë, domethënë, ai që ka lidhje më afër, lidhje më të ngushta me bizneset e mëdha që na financojnë neve e të them partitë politike, e bëjnë kryeshef, gjersa këto institucione, si bie fjala Avokati i Popullit, sepse nga definicioni merret me hallet e qytetarit të rëndomtë, pra nuk ka lidhje ekonomike aty, nuk ka ndonjë interes individual, grupor, i qesim diku kah klasa e katërt, e pestë dhe ashtu e kështu ne s' duhet të merremi me gajlet, me hallet e qytetarëve të zakonshëm, po duhet t'i këqyrim po them edhe një herë kush se më shumë e dëmton Kosovën dhe t'i japim prioritet, kështu kemi vepruar deri më tani.

Përndryshe, po them, u thanë shumë gjëra tjera, vetëm se edhe një herë propozoj që ta bëjmë këtë ranglistën dhe Avokatin e Popullit ta qesim kah klasa e pestë a e gjashtë atje e rangut, se edhe ashtu s'ka njëfarë domethënie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Tali!

DRITON TALI: Më falni, më falni, se edhe ashtu po them, nëse është pak me rëndësi, ne mund ta krijojmë edhe ndonjë task-forcë për zgjidhjen e problemeve, apo ta krijojmë një zyre diku në Qeveri, te kryeministri, zyre të njëjtë kështu që ta bastardhojmë me të gjitha mundësitë çdo institucion të cilin nga definicioni është dashur të jetë i pavarur dhe ta mbrojë interesin e qytetarit të zakonshëm të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë! Sipas radhës deputetja Flora Brovina e ka fjalën. Urdhëroni, doktoreshë!

FLORA BROVINA: Nuk do ta zgjas shumë, mbasi që shumëçka u tha. Në rend të parë më vjen mirë që ligji që sot po shqyrtohet është një ligj i fushës së të drejtave të njeriut dhe një ligj shumë i domosdoshëm. Në diskutimet që u thanë unë mund të mos pajtohesha me profesorin e nderuar kur tha se Ombudspersoni duhet të jetë jurist. Unë besoj që ai duhet të jetë njohës i të drejtave të njeriut, mbasi që të drejtat e njeriut i njeh, i mbron.

Sa i përket vetë ligjit, kam disa vërejtje dhe në rend të parë do të përmendja këto vërejtjet e mia do t'i them edhe me shkrim në komisionin gjegjës dhe kanë të bëjnë me nenin 8, nenin 9, 13 dhe 14. Ta zëmë në nenin 8, vërejtja ime është kur thuhet në pikën 14, kur thuhet se "njëri nga zëvendësit e Ombudspersonit duhet të jetë femër". Besoj formulimi duhet të jetë ndryshe, të thuhet se në zgjedhjen e zëvendësit të Ombudspersonit të respektohet Ligji për barazinë gjinore, që do të thotë mund të jenë edhe dy pra, ose tre. Kujtoj që kështu duhet të formulohet dhe vërejtjet tjera thashë do t'i them me shkrim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, doktoreshë! Vazhdojmë me deputetin Naim Rrustemi që e ka kërkuar fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues!

Shumëçka u tha lidhur me këtë ligj, po një gjë që deri tash nuk është cekur, unë do të jem pak sa konstruktiv në këtë drejtim, ka të bëjë me nenin 14 të këtij ligji, që është sigurimi i punës pas mbarimit të mandatit.

Unë nuk e shoh shumë të arsyeshme për të harxhuar kaq shumë fjalë se pas përfundimit të mandatit, avokati mund të kthehet në funksionin e tij ose punën publike. Propozoj që

të shfrytëzojmë terminologjinë e re që përdoret në politikën e sotme kosovare që të përdoret dhe ta shkruajmë se mund ta ngrijë pozicionin, se edhe shembulli i dhënë nga Presidenti i vendit e lejon një gjë të tillë. Edhe pse sot Kushtetuta nuk e lejon, mua ma merr mendja që do ta amendamentojmë me një task-forcë që do të mblidhet në Qeveri dhe do ta amendamentojë nenin 88 të Kushtetutës, me të cilën do të lejohet që të ngrihen pozicionet tjera, për të cilat momentalisht nuk ke të drejtë që t'i bartësh. Kushtetuta pse është diçka, normalisht që mund të ndryshojë diçka edhe me kohën.

Dhe çështja tjetër, çështja e dytë që unë do ta ngrit është çështje që me të vërtetë Kosovës i nevojitet një sistem i balancuar i pagave – i pagesave dhe që të trajtohen të gjitha institucionet barabartë, që të mos kemi njëfarë, për ta lënë një përshtypje se disa institucione të pavarura janë më të rëndësishme se tjetra apo të tentojmë që të zbulojmë disa shifra – jo ky institucion duhet të paguhet 1.3, 1.4. Për mua, posaçërisht është shumë e çuditshme si është e mundshme që me ... faktorin 1.3. Në njërin prej ligjeve që e kemi kaluar ne në Parlament, që është Ligji mbi funksionimin e Gjykatës Kushtetuese definohet se paguhet 1.3 sa Gjykata Supreme, kështu që është nevojë e domosdoshme që të krijohet një sistem unik i sistemit, i pagesave nëpër të gjitha institucionet e pavarura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bujar Dugolli e ka kërkuar fjalën.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryesues!

Pra, këtu u diskutuan shumëçka, u tha që kjo lëmi nuk është për herë të parë e rregulluar në Kosovë. Rregullorja e UNMIK-ut 2000/39 për Ombduspesonin e Kosovës e ka rregulluar këtë çështje dhe më vonë ligji për institucionet e Avokatit të Popullit, 16 shkurt 2006. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për një ligj të ri siç është paraqitur në rendin e ditës, por bëhet fjalë për ndryshime dhe plotësime të Ligjit mbi institucionin e Avokatit të Popullit.

E dimë që ky është një institucion i pavarur kushtetues, që e ka për qëllim mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, të qytetarëve të Republikës së Kosovës, por po ashtu e dimë se institucionet ndërkombëtare që merren me monitorimin e shkeljeve të drejtave të njeriut nëpër vende të ndryshme në botë, siç është edhe Amnesty Interneshenel edhe Friedem-Haus, kanë raportuar shumë herë dhe Kosovën aspak nuk e kanë cilësuar si vend të mirë që respektohen liritë dhe të drejtat e njeriut. Unë mendoj që kjo çështje duhet të jetë shqetësuese për institucionet e Kosovës, posaçërisht për Kuvendin, jo të ndërtojë institucione të tilla që janë vetëm dekor që kryejnë një simbolikë kushtetuese dhe s'mund të zgjidhin asgjë dhe s'mund të parandalojnë shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut që ndodhin në Kosovë, qoftë nga institucionet e Kosovës, po edhe nga institucionet ndërkombëtare që kanë kompetenca ekzekutive në vend.

Pra, për t'i dhënë një fuqi ne besojmë që ndërtimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nuk do ta lë këtë institucion pa mbrojtje dhe nuk do t'i lë liritë dhe të drejtat e njeriut të shkelen dhe rekomandimet apo vendimet që i ka dhënë ky institucion deri më tash të mbesin të pazbatuara dhe të pa publikuara.

Unë mendoj që tek neni 23, ku flitet për raportet e rregullta, por edhe raportet e veçanta që i bëhen Kuvendit të Republikës duke publikuar, duhet të publikohen mbasandaj edhe në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit dhe të gjitha ato punë që janë bërë, qoftë për rastet e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut, të njoftohet edhe popullata e gjerë, jo vetëm institucioni i Kuvendit, siç është obligim kushtetues, por të dinë edhe

qytetarët dhe të mos ndodh një habi e qytetarëve kur raportet e organizatave ndërkombëtare flasin për shkelje drastike të drejtave dhe lirive të njeriut, të qytetarëve të Kosovës, neve të na bie si shok – të themi se ku po shkelen, për shkak se mekanizimi jonë nuk funksionon në njoftimin e qytetarëve se në cilat fusha? Pra gjatë shqyrtimit, amendamentimit që duhet t'i bëhet këtij ligji në bazë të debatit parlamentar që u tha, duhet të jetë prezent edhe institucioni i Avokatit të Popullit ose të dërguarit e tij në komision që amendamentimi të jetë i duhur dhe të mos aludohet se qoftë Qeveria ose një institucion tjetër ndërhyjnë në autonominë e institucioneve të pavarura, sepse Qeveria ka të drejtë të bie ligje dhe nuk mund të ja mohojë askush këtë, por të jetë prezent në periudhën e amendamentimit edhe autoriteti kushtetuese që është Avokati i Popullit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit i lajmëruar deputeti Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përsëritet veçantë për kryesuesin e Kuvendit, që vlen të mbahet mend kjo datë sot historike për komunitetin tonë ashkalinj, që nga radhët e komuniteti ashkalinj kryesuesi udhëheq Kuvendin.

Sa i përket shqyrtimit të Projektligjit për Avokatin e Popullit, i cili na është ofruar për shqyrtim, mendoj se Projektligji si i tillë përmban disa të meta të cilat konsideroj se duhet mënjtuar, në mënyrë që Ligji për Avokatin e Popullit të dalë më i plotë, më përmbajtësor, me një fjalë më funksional në kuptimin dhe zbatimin e tij praktik në të ardhmen.

Nenin 6, kushtet për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësit të tij, në paragrafin 1.2 duhet të ketë arsimim të lartë, mendoj se formulimi i tillë është mjaft i mangët dhe propozoj që të precizohet më saktësisht niveli i kualifikimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Në nenin 9, paragrafi 1, zgjedhja e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij thuhet: ” Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës me shumicën e votave të gjithë deputetëve të tij në një mandat pesëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje”. Unë konkludoj se, nëse tregohet i suksesshëm gjatë punës së tij, pse të mos ketë të drejtë rizgjedhjeje për një mandat vijues?

Sa i përket nenit 28 paragrafi 3, ku thuhet – me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Avokati i Popullit dorëzon raporte periodike ose raporte të tjera. Mendoj se më adekuate do të ishte shprehja – Avokati i Popullit dorëzon raporte periodike ose raporte të tjera, ashtu siç është paraparë në nenin 135 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në neni 37 ku thuhet – brenda 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucioni i Avokatit të Popullit nxjerr Rregulloren e punës që mendoj se këtij paragrafi do të duhej të ishte – brenda 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucioni i Avokatit të Popullit të nxjerrë Rregulloren e punës së tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pasi që nuk kemi të lajmëruar tjerë për të diskutuar për këtë projektligj.... Zonja ministre, nëse e kërkon fjalën? Urdhëroni!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me vëmendje i dëgjova të gjitha vërejtjet që u dhanë. Për mendimin tim këtu u bë më tepër një interpretim i ligji se sa komentet dhe kontributi që dëshirojnë deputetët për t'ia dhënë ligjit. Ju e dini, ata që janë juristë se kemi 9 lloje interpretimesh: gjuhësore, historike, ekstensive, restriktive, filozofike e tjera, e tjera. Si do që të jetë, secilin koment apo interpretim e vlerësoj si një vullnet të deputetëve të këtij Kuvendi për të nxjerrë ligje sa më të mira, sa më të kompletuara dhe të cilat do të jenë funksionale dhe do të zbatohen. Mirëpo, për zbatimin e tyre atëherë dihet kujt i bie barra, për këtë ligj është përgjegjës për ta zbatuar vetë Avokati i Popullit.

U tha këtu se Qeveria nuk mund të hartojë ligje për institucione e pavarura. Kjo vërejtje nuk qëndron, sepse pikërisht Qeveria dhe ky Parlament kanë miratuar edhe ligje edhe për agjencione tjera, por ku po të shkojmë më larg se sa do të miratojë edhe ligjet për gjykatat që janë një shtyllë dhe një prerogativë e shtetit edhe gjykatat janë të pavarura. Kemi edhe agjencione tjera kushtetuese që konsiderohen të pavarura, prandaj unë nuk e shoh të arsyeshme që t'i merret kjo e drejtë Qeverisë që të hartojë Ligjin për Avokatin e Popullit.

Sa i përket buxhetit, ju them se ne nuk po themelojmë një institucion të ri, ne po bëmë një ligj të ri për funksionalizimin e këtij institucioni, i cili është themeluar para dhjetë vjetëve gati. Dhe sa i përket përshtatshmërisë me *acquis communautaire*, më lejoni, të gjithë e keni por sa për ta freskuar kujtesën edhe timen edhe tuajën. Deklarata e Agjencionit për Koordinim e Zhvillim dhe Integrim Evropian thotë se përmbajtja e Projektligjit për Avokatin e Popullit që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit, procedura për emërim dhe shkarkim kompetencat, mënyrën e punës së institucioneve të Avokatit të Popullit si dhe procedurat për paraqitjen e ankesave, unë po them pajtohem parashtrësive, sepse nëse paraqitet ankesa atëherë duhet të vendoset lidhur me ankesën nga ana e vetë Avokatit të Popullit apo institucionit. Nuk i cenon thotë parimet e përgjithshme të *acquis communautaire*, kështu që kjo dilemë veç duhet të eliminohet me pajisjen e këtij ligji me këtë certifikatë. Pastaj u përmendën këtu edhe buxheti. Buxheti për këtë vit është miratuar. Buxheti është ndarë edhe për Avokatin e Popullit, për institucionin e Avokatit të Popullit për këtë vit. Nëse miratohet në këtë vit ky ligj nuk do të ketë veprim retroaktiv dhe ai mund të kërkojë buxhet për vitet e ardhshme. E bën llogaritjen e buxhetit, ndoshta i del buxheti më i vogël, ndoshta më i madh, ndoshta kërkesat rriten, e tjera e tjera.

U përmend këtu edhe kritikën që po i adresohen Kosovës për shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Po kjo është e vërtetë, qëndron dhe unë që dikur kam qenë edhe bashkëthemeluese e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, jam fanatike në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Por mos harroni se me Kushtetutë ne jemi të detyruar që ta zbatojmë direkt si ligj vendor edhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut edhe Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, kështu që nuk mundemi me një ligj dhe me një mekanizëm t'i sigurojmë mbrojtjen e të gjitha të drejtave se e thashë edhe në sqarim ka një lepezë të gjerë të drejtave të njeriut që duhet të përkujdeset se secili mekanizëm që ka përgjegjësi për atë përkujdesje.

U përmend ligji për pagat. Ndoshta besoj se edhe Ligji për pagat për zyrtarët e lartë publikë do të miratohet para këtij ligji, sepse dihet sa po merr kohë miratimi i një ligji. Megjithatë, unë ju falënderoj shumë, për të gjitha vërejtjet, komentet, sugjerimet që i

dhatë dhe besoj se edhe Ministria e Drejtësisë do të gjejë kohë që të japë kontributin e vet me komisionin gjegjës i cili do ta marrë në shqyrtim, do të ngarkohet për ta shqyrtuar këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministresh!

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Konstatoj se në sallë gjenden 62 deputetë, kështu që kemi kuorum për ta votuar këtë projektligj.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, 9 “kundër”, 1 abstenim Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Avokatin e Popullit.

Të korrigjohet një votë, a po? Do të thotë 1 që është kundër, bëhet të votohet “për”, le të korrigjohet në regji.

Do të thotë, konstatoj se Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Avokatin e Popullit me 58 vota “për”, 9 “kundër”, asnjë abstenim.

(Reagim)

Thashë 58!

Në bazë të Rregullores së Punës Kuvendi ngarkon këto komisione.

- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional,
- Komisioni për të Drejtat e Njeriut si komision i interesuar,
- Komisioni për Buxhet e Financa,
- Komisioni për Komunitete, dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda dy muajve në shqyrtimin e parë Kuvendit t’i paraqesin raporte me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.**

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji .

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe financave zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin. Urdhëroni, zotëri ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Përshëndetje të gjithëve!

I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë dhe kolegë,

Kam kënaqësinë e veçantë që sot para jush të prezantojë Draftligjin për parandalimin e shpëlarjeve të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit. Me këtë projektligj

synojmë të rregullojmë fushën e parandalimit të shpëlarjes së parave, si dhe çfarëdo forme të involvimit në financimin e terrorizmit. Kjo fushë deri më tani ka qenë e mbuluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, e cila mbase ka pasur të meta të theksuara, të cilat konsideroj se i kemi tejkaluar dhe kufizuar ose përkufizuar përmes këtij ligji.

Me projektligjin i cili është para jush, ne dëshirojmë të avancojmë në të gjitha format më moderne të luftimit të shpëlarjes së parasë dhe parandalimin e financimit të terrorizmit, dukuri e cila është e shprehur në shtete në tranzicion. Njësia për Inteligjencën Financiare e cila është paraparë me këtë ligj do të shërbejë që të jetë një burim informacioni për të gjitha institucionet e përndjekjes, policinë, prokurorinë dhe të gjitha institucionet e tjera relevante, qofshin në Kosovë, apo në regjion dhe kudo gjetkë dhe të cila do të mundësojë parandalimin dhe luftën kundër kësaj dukurie e cila fatkeqësisht është prezent edhe në Kosovë. Përmes këtij ligji përcaktohet njësia, siç e thash, njësia e inteligjencës financiare e cila deri më tani ka qenë dhe është e financuar nga buxheti i Kosovës, e cila ka funksionuar në kuadër të UNMIK-ut dhe është bartur nën mbikëqyrjen e EULEX-it. Në këtë njësi është gjetur modusi në bashkëpunim me të gjitha institucionet relevante ndërkombëtare, EULEX-in, Komisionin Evropian, Zyrën Amerikane, Këshillin e Evropës që të vendoset në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave duke qenë se aty është reflektimi i të gjitha informacioneve relevante financiare dhe drejtori ekzekutiv i kësaj njësie do të përzgjidhet në bazë të rekomandimeve përkatësisht të një bordi i cili ex-officio, do të përbëhet nga ministri i Ekonomisë dhe Financave, ministri i Punëve të Brendshme, kryeprokurori i Republikës së Kosovës, drejtori i Administratës Tatimore, drejtori i Doganave, drejtori i Policisë dhe guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës.

Pra, përmes këtij ligji përcaktohen në mënyrë shumë precize subjektet raportuese financiare, kryesisht ato të cilat kanë të bëjnë me transaksione financiare, përcjelljen e shërbimeve të tilla financiare apo transferim të pasurive, qofshin ato materiale apo jo materiale siç janë: bankat, organizatat joqeveritare, institucionet e ndryshme mikro-financiare dhe tjera që kanë të bëjnë me shërbimet financiare, kazinotë, agjentët e pasurive të patundshme, avokatët, partitë politike, noterët, auditorët e certifikuar, këshilltarët tatimorë e shumë subjekte të tjera të cilët do të raportojnë për transaksionet dhe të hyrat të cilat kalojnë përmes tyre.

Po ashtu në këtë ligj në mënyrë të përkohshme kemi përcaktuar edhe aspekte penale të cilat deri në ndryshimin e ligjit apo procedimin e Ligjit mbi procedurën penale dhe mbi Kodin penal, do të jenë pjesë e këtij ligji si dhe pjesa e tranzicionit deri në bartjen e plotë të këtij institucioni në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Një marrëveshje e veçantë do të nënshkruhet, e cila është pothuaj se në përfundim e sipër me EULEX-in, që në kuadër të mandatit të EULEX-it deri në bartjen e kompetencave këto, bartja e njesisë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave do të bëhet sipas planit dhe agjendës së përbashkët. Po ashtu një kapitull i veçantë i kësaj është dhënë që në kuadër të mandatit të EULEX-it që ka sipas marrëveshjes për sundimin e ligjit EULEX-i do të ketë informacione ose akses të informacioneve përmes marrëveshjes në këtë fushë gjithnjë me qëllim të sundimit të ligjit dhe luftës më të theksuar kundër shpëlarjes së parasë dhe kundër financimit të terrorizmit.

Projektligji ka 9 kapituj dhe 42 nene dhe siç e thashë edhe më herët është harmonizuar edhe me partnerët tanë strategjikë. Konsiderojmë se është një ligj mjaft modern i cili i jep fuqi të mjaftueshme institucioneve të Kosovës për këtë fushë tepër të ndjeshme andaj kërkoj nga ju që ta mbështetni. Natyrisht jam i gatshëm të diskutojmë për çfarëdo

sugjerimi apo reflektimi tjetër i cili do të ndikojë në përmirësimin e natyrës së këtij ligji dhe përmbajtjes së tij. Faleminderit shumë dhe jam në dispozicionin tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër, zotëri Ahmet Shala!

Të nderuar deputetë, hap debatin për diskutim në parim. Kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, nëse e kërkon fjalën. E ka fjalën deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kisha shfrytëzuar rastin që fjala ime të llogaritet edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Ligji në fjalë është një variant më i kompletuar i cili ka ardhur në këtë Kuvend për shqyrtim. Ka pasur disa variante të ndryshme për arsye se për këtë ligj është punuar që nga viti 2006, nga ekspertë të ndryshëm është punuar, ka pasur disa debate, por kjo që kemi sot para vetes konsideroj se është një ligj shumë i kompletuar.

Qëllimi i këtij ligji është thjesht të demaskojë prejardhjen e parasë, sidomos origjinën e parasë dhe kjo është paraparë që të arrihet në disa mënyra, nëpërmjet raportimit që do t'i obligojë të gjitha institucionet financiare, bankare, organizatat jo qeveritare, partitë politike që të raportojnë për prejardhjen e parasë për transaksione që kapin vlerën më të madhe se 10.000 euro. Po ashtu ka për qëllim që të monitorojë të gjitha ato institucione që merren me qarkullimin e parasë, fjala është për lojërat e fatit, qarkullimin e parasë brenda dhe jashtë Kosove si dhe të kujdeset për detyrimet tjera që ka të bëjë me transferet për pasuritë e paluajtshme. Me fjalë tjera, ky ligj në vete përmban të gjitha ato përmbajtje të cilat duhet t'i ketë për ta përcjell prejardhjen e parasë dhe legalizimin e saj.

Një çështje për të cilën ndoshta duhet diskutuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa është çështja e Njësitit të Inteligjencës Financiare, thjeshtë ky është një agjencion në veti, është menduar më herët që të jetë një kombinim në mes Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të kryeministrit, por si po duket është gjet një variant krejt tjetër që ky njësit të jetë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Përpara ka ekzistuar sipas Rregullores 2004/2 një njësit i cili është quaj FIS do të thotë Financhenel Information Service dhe si po duket është paraparë që kjo të bartet tash në këtë njësitin e inteligjencës. Mund të ketë diskutime lidhur me pavarësinë e këtij institucioni a do të jetë aq i pavarur si përshkruhet në nenin 4 dhe a ekziston të jetë kjo pavarësi kaq e mundur nëse kjo thjeshtë buron nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Një gjë që është këtu e mirë që në bordin e këtij njësi është pjesa më e lartë ekzekutive e vendit dhe në krye të këtij bordi është ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe atë e zëvendëson apo në rast mungese ministri i Punëve të Brendshme. Mendoj se çështja e bordit është rregulluar në mënyrën më të mirë. Mund të diskutohet eventualisht lidhur me pavarësinë e këtij njësi por konsideroj se është një ligj i kompletuar dhe një ligj i cili më së paku do t'i sjell telashe Komisionit funksional respektivisht Komisionit për Buxhet e Financa. Pa asnjë dilemë ligji duhet të aprovohet nga deputetët dhe është një ligj për të cilin janë të interesuar jo vetëm institucionet vendore, por edhe ato ndërkombëtare pasi që në vete përmban edhe pjesën shumë të ndjeshme – çështjen e parandalimit të financimit të terrorizmit. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Osmani! Kryetarët e komisioneve tjera, nëse kërkojnë fjalën? Vazhdojmë me kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar për PDK, Safete Hadergjona j e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Desha vetëm një sqarim kështu për fillim. Ne në Komisionin për Buxhet e Financa nuk e kemi shqyrtuar fare këtë projektligj, kështu që ndoshta komentet e nënkryetarit të Komisionit janë më tepër komente të subjektit të vet politik se sa të Komisionit, mirëpo megjithatë është bërë mirë që ka shpjeguar një procedurë të gjatë që ka kaluar ky ligj, sepse ne kemi pas një projektligj që nga viti 2006 të cilin nuk ka pasur mundësi që të miratohet ende kështu që në fund ka arritur ky projektligj që konsideroj se Projektligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit që sot ne po e shqyrtojmë shqyrton dhe rregullon një problematikë shumë të ndërlikuar në lëmin e financave. Pastrimi i parave dhe financimi i aktiviteteve kriminale e dëmton në përgjithësi sistemin financiar të Kosovës. Mungesa e këtij ligji, vështirësitë në implementimin e disa ligjeve të tjera, ekzistimi i ekonomisë informale që në njëfarë mënyre siguron të ardhura nga veprimtaritë ilegale dhe kriminale e ka imponuar dhe e imponon nevojën që sa më shpejt ta kemi një ligj të mbështetur në legjislacionin e Bashkësisë Evropiane për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit.

Edhe pse kjo problematikë ka qenë e rregulluar me Rregullore të UNMIK-ut 2004/2 dhe 2005/9 të cilat me këto rregullore është rregulluar në njëfarë mënyre kjo çështje, por megjithatë nuk ka qenë një kornizë e mjaftueshme ligjore për luftimin e këtyre dukurive negative edhe pse ka ekzistuar edhe një organizëm i cili ka mbrojtur në njëfarë mënyre pranë shtyllës së policisë dhe drejtësisë e quajtur qendra për informim financiar megjithatë nuk është rregulluar ashtu siç duhet kjo çështje dhe nuk ka pasur ndonjë rezultat shumë efektiv në luftimin e këtyre dukurive.

Në projektligjin që na është ofruar në shqyrtim janë paraparë procedurat për zbulimin dhe parandalimin e shpëlarjes së parasë, masat që duhet ndërmarrë si dhe është paraparë autoriteti kompetent për luftimin e shpëlarjes së parave. Njësia për Inteligjencë Financiare e cila është paraparë që të jetë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji e ka shqyrtuar dhe e përkrah në parim, por ka edhe disa vërejtje në disa nene të caktuara.

Në nenin 5 parashihet formimi i bordit menaxhues të Njesisë për Inteligjencë Financiare, mënyra e formimit të këtij bordi, detyrat dhe kompetencat si dhe procedurat vendimmarrëse të bordit janë pak konfuze në këtë ligj.

Në nenin 5 paragrafi 2 parashihet se kush mund ta përbëjë këtë bord, por nuk parashikohet si funksionon ky bord.

Ne si Grup Parlamentar kemi vërejtje në nenin 8, paragrafi 1 dhe 4 të bindur se duhet precizuar mënyrën e funksionimit të këtij bordi që të mos jetë bord i formuar vetëm formalisht.

Në nenin 11 është rregulluar mënyra e drejtimit të Njesisë për Inteligjencë Financiare. Ne kemi vërejtje në nenin 11 paragrafi 3 dhe paragrafi 3 pika 4, si dhe në paragrafin 6 ku thuhet se drejtori i njesisë për inteligjencë financiare është një zyrtar sipas ligjit për konflikt të interesit.

Në këtë ligj nuk përcaktohet se drejtori a është shërbyes civil apo shërbyes civil që i nënshtrohet procedurave të shërbyesve civilë apo është i emëruar. Këtë çështje më

konfuze e bën njëkohësisht edhe paragrafi 8 i nenit 11 si dhe neni 12 ku parashihen procedurat e zgjedhjes së drejtorit të njësisë për inteligjencë financiare.

Po ashtu kemi vërejtje në nenin 22, në fakt, ku parashihet mënyra e raportimit tek njësia për inteligjencë financiare, bankave dhe institucioneve financiare, mandej në nenin 24 ku parashihen detyrat shtesë të organizatave joqeveritare dhe në nenin 25 ku parashihen detyrimet shtesë të partive politike dhe kandidatëve të regjistruar sidomos në paragrafin 5 dhe në paragrafin 7.

Disa nene të këtij projektligji duhet të harmonizohen me ligjet tjera, kurse në projektligj ka nevojë të bëhet formulimi më i mirë i disa neneve në aspektin juridik dhe në aspektin teknik. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, thashë edhe më parë e përkrah në parim këtë projektligj dhe i mbetet shumë për të punuar Komisionit funksional ku ne si Grup Parlamentar do të japim kontributin tonë përmes anëtarëve – deputetëve tanë të cilët janë në këtë komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit deputete! Vazhdojmë me Grupin Parlamentar për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës zotin Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti ministër,

Më lejoni të reflektoj qëndrimin e Grupit Parlamentar të AAK-së dhe timin personal në lidhje me këtë projektligj të ofruar sot për shqyrtim në parim. Grupi Parlamentar i AAK-së dhe unë personalisht mbështesim çdo nismë dhe hap të Qeverisë në ngritjen e kapaciteteve të sigurisë. Mendoj që ky kapacitet që parashihet me këtë projektligj që do të ngritet është kapacitet i sigurisë së veçantë të lartë për Kosovën për një shtet që synon të jetë i barabartë dhe të merr obligime para bashkësisë ndërkombëtare, pra ne marrim obligime me këtë ligj që të luftojmë shpëlarjen e parave, një dukuri jashtëzakonisht shqetësuese në nivel global, po ashtu edhe përdorimin e parandalimin dhe luftimin e përdorimit të këtyre parave në financimin e terrorizmit që po ashtu është një brengë dhe problem global. Zoti Ministër, më lejoni që në fillim të jap disa vërejtje të përkufizimet. Mendoj se është rëndur tepër ky nen me disa përkufizime, sipas mendimit tim që janë të panevojshme, këtu. Për shembull nuk sqarohet çka është Banka Qendrore e Kosovës që nuk ka nevojë mendoj të sqarohet, ose valuta, ose keni sqarim për përkufizim pasurie e paluajtshme, çka është për shembull, ose për shembull noter? Ne kemi Ligjin për noterinë, ka kaluar në Kuvend të Kosovës. Mendoj që nuk ka nevojë të rëndohet ky nen duke i sqaruar këto përkufizime se çka do të thotë, ose keni 1.27 policia, për shembull. Ju e ngarkoni këtë projektligj me çka do të thotë policia, që do të thotë Policia e Kosovës. Ose institucione fetare, për shembull, ne e kemi kaluar ligjin për institucionet fetare e të tjera. Po mendoj se është rëndur dhe mundet që të mos i këto përkufizime dhe për të harxhuar edhe letër edhe të ngarkohet ky nen me këtë, me shpjegimin e këtyre përkufizimeve.

Më lejoni të them se në nenin 6, paragrafi 1.5, te detyrat dhe kompetencat e bordit, mendoj që 1.5 citoj: “ kontrolloj dhe vëzhgoj pasurinë e deklaruar nga drejtori i njësisë. Mendoj se kjo është kompetencë e Agjencionit Antikorrupsion. Ne e kemi një agjencion që për shembull të gjithë zyrtarët që janë të obliguar të lajmërojnë pasurinë dhe të deklarojnë, pra duhet të hyjë edhe drejtori i njësisë në kuadër të kompetencave të atij agjencioni dhe në një vend, pra në një agjencion të pavarur, janë të gjitha personalitetet që janë të obliguara të deklarojnë pasuritë dhe kontrollohen nga një agjencion. Mendoj se

këtu është një përzierje e kompetencave dhe është e tepërt kjo të futet në këtë projektligj.

Në disa nene, zoti ministër, po i referohem nenit 33, paragrafi 6.10 i referohet për shembull nenit 34, pra nenit që vjen pas këtij neni. Unë mendoj që renditja e neneve edhe kur në një nen ndonjë paragraf thirret në një nen duhet të nenet para këtij neni, pra mendoj se kjo renditje duhet të bëhet ma... ka edhe në disa nene, pra duhet të kihet parasysh se edhe ligji duhet ta ketë një renditje që është e kuptueshme dhe e logjikshme.

Më lejoni, zoti Ministër të jap një reflektim ndoshta timin personal që nuk ka të bëjë me personalitetin e juaj. Mendoj që bordi drejtues i njësisë në disa shtete është policia financiare, kemi në Itali Guarda de finanza, nëse nuk gabo, ka të bëjë edhe kjo njësi, por më lejoni të reflektoj që mendoj se nuk e ka vendin që drejtori i bordit të jetë ministri i Ekonomisë dhe i Financave, nuk ka të bëjë asgjë personale, ne kemi, ne do të miratojmë këtu një ligj që do të ketë jetën e gjatë edhe për të gjitha qeveritë që vijnë. Unë figurativisht zoti Ministër, të nderuar deputetë, i nderuar zoti kryesues, do ta marr për shembull mënyrën e shpëlarjes së parave me pasuri të paligjshme. Në planet e Qeverisë, të ministrive të ndryshme, për shembull për miniera siç është e Sibovcit, i dinë vetëm ministrat dhe në ato plane ose trasetë e autostradave, rrugëve apo investime të ndryshme që i dinë vetëm njerëzit e Qeverisë, të afërt ata shkojnë ose ata ose vëllezërit të akraballëku i blejnë ato prona, para se të publikohet që është interes dhe do të shpronësohen dhe pastaj në Ligjin për shpronësimet shumëfish rritet çmimi i atyre pronave, shpronësohen nga buxheti i Kosovës që e ka nën mbikëqyrje dhe nën menaxhim ministri i Ekonomisë dhe i Financave. Unë mendoj se kjo është ajo. Ky është ai reflektim që unë desha ta them këtu, se mendoj që nuk e ka vendin në disa shtete, zoti Ministër, udhëheqës bordi janë ministri i Drejtësisë ose i Punëve të Brendshme, ka edhe të pavarur prokurorë, pra ky ishte një reflektim i imi personal, ndoshta jo i krejt Grupit.

Më lejoni edhe një herë t'i jap mbështetje në emër të Grupit Parlamentar këtij projektligji dhe uroj që së shpejti të vijë edhe Ligji kundër krimit të organizuar ose siç e kanë në Itali anti-mafia, i ngjashëm, shumë shtete të Ballkanit e kanë kaluar këtë ligj nëpër Kuvend të Kosovës dhe unë ftoj Qeverinë që ta sjellë sa më parë edhe një ligj të tillë në Kuvend të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Maloku!

Për Grupin Parlamentar të Aleancës Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani e ka kërkuar fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Përshëndetje për dy ministrat që janë prezentë dhe të gjithë deputetët brenda kësaj seance plenare,

Pikësëpari dua të përshëndes ministrin që më në fund erdh ligji apo Projektligji për parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit duke marrë parasysh se në çfarë shtete ndodhet shteti i ri i Kosovës dhe njëkohësisht mund të them se në emër të Grupit Parlamentar të AKR- së përkrahim projektligjin, mirëpo do të kërkoj një sqarim, ndoshta ministri është i koncentruar për të më dëgjuar, kërkoj një sqarim në lidhje me këtë projektligj.

Projektligji, pikësëpari ministri e ceku se i ka ato nene të cilat ndoshta në shumë nene mund të ishte harmonizim me ligjet tjera, të cilat do të vijnë dhe ligje të cilat kanë kaluar

brenda këtij Kuvendi të Kosovës, mirëpo një çështje shumë ndoshta edhe grupit tim parlamentar dhe imja personale, ministër, këtë rast është çështja e Njesisë së Inteligjencës Financiare duke marrë parasysh se këtu potencon vendosjen e bordit të Inteligjencës Financiare, pas shpalljes së Ligjit nga Kuvendi i Kosovës, mirëpo ndoshta jo me... Jo, ministër, një moment, se është duke u sqaruar ligji. Mund të potencoj se çështja e udhëheqjes së bordit apo udhëheqjes së politikave të bordit nga ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe ministri i Punëve të Brendshme, kryeprokurori i Kosovës, drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Drejtori i Administratës Tatimore, me gjithë respektin për të gjithë që janë vendosur këtu, drejtori i përgjithshëm i Doganave të Kosovës, drejtori menaxhues i Bankës, jo por guvernatori i Bankës, nuk di sa do të ishte pavarësia e këtij bordi të inteligjencës kur dihet mjaft mirë se Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe ministri i Ekonomisë dhe Financave është pjesë e politikës dhe sa do të jetë kjo pavarësi e këtij bordi, do të mbetet të shihet? Çështja e vendosjes së drejtorit, u përmendën shumë pika në të cilat Grupi Parlamentar i AKR-së kishte vërejtje, mirëpo me shpresë që te drejtori i Njesisë së Inteligjencës Financiare të bëhet një sqarim më i mirë gjatë punimit apo gjatë shqyrtimit në komisionin parlamentar, Grupi i AKR-së do të japë gjithë vullnetin e mirë që ky ligj më në fund të kalojë edhe shqyrtimin e dytë dhe në dispozitat kalimtare për arsye se ministri është këtu, unë do të kërkoj prapë sqarime është çështja – dispozitat kalimtare ku potencohet, te neni 40, thuhet se – aspektet përkatëse të kalimit të përgjegjësisë nga IFO-ja tek në IFO-ja, aktivitetet e misionit të EULEX-it në Kosovë, bashkëpunimi dhe qasja në informacionet do të dakordohen me një marrëveshje të ndarë. Jo me një marrëveshje të ndarë, po me një marrëveshje të veçantë duke marrë parasysh misionin e EULEX-it në Kosovë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Edhe një herë potencoj, Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah në parim projektligjin me të gjitha vërejtjet, besoj se do të bëhet një ligj shumë i mirë dhe një ligj shumë me rëndësi që i duhet Kosovës tani për tani duke marrë parasysh procedurat në të cilat po kalon shteti i ri i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të LDD-së deputetja Besa Gaxheri e ka kërkuar fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Që në start zoti kryesues do të jap një vërejtje. Ne të kërkuam të dalim në pauzë dhe duhet ta keni parasysh. A erdhe, e mirë, shpëtove? Të lutem, zoti ministër, sepse, OK, realisht e ka relevancën e vet dhe gjithsesi duhet të mësohen ministrat me qenë këtu deri sa diskutohet ligji, po, ju lutem!

Realisht, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratiket të Dardanisë e mirëpret këtë ligj, duke pasur parasysh se vërtet Ligji për parandalimin apo pastrimin e shpëlarjeve apo pastrimin e parasë dhe financimin e terrorizmit, tashmë kjo dukuri fatkeqësisht në Kosovë është prezentë dhe fatkeqësisht më transparente është gjatë kohës së fushatave politike të partive politike, pra kur kemi zgjedhjet, aty ne, jo vetëm ne, por të gjithë qytetarët e Kosovës kanë rastin të shohin se si bëhet pastrimi i parasë, mos të flasim pastaj për mënyrat e tjera dhe kjo është një çështje vërtet shumë shqetësuese që realisht me këtë ligj shpresojmë që do të parandalohet kjo dukuri.

Unë nuk e kam ndërmend t'i bëj rezyme ligjit, sepse i bëri ministri, i bën edhe shumë kolegë deputetë. Realisht ligji është në tërësinë e tij i kompletuar deri diku. Natyrisht ne tashmë shumicën e ligjeve i përkthejmë dhe ndonjëherë kemi probleme me përkthimin

adekuat në terminologji të caktuara. Bile ky ligj sa me ia dhënë vetëm kështu një, diku keni harruar për shembull fusnotat, i keni harruar t' i përktheni dhe i kenë lënë në gjuhën serbokroate e kështu me radhë. Megjithatë, unë po ndalem vetëm tek Njësia e Inteligjencës Financiare, që mendoj se është diçka më e rëndësishme në kuadër të këtij ligji dhe në bazë të ligjit thuhet se Njësia e Inteligjencës Financiare parashihet të jetë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Unë nuk di a e keni menduar mirë këtë çështje? Unë mendoj, apo Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, mendon se nga specifika e kësaj njësie që quhet e Inteligjencës Financiare, nuk ka të bëjë me financa, por me inteligjencën e financave, atëherë mendojmë se shumë mirë do të ishte që kjo të jetë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Për mos me marrë kohë tash se vërtet kjo nuk ka të bëjë me profesionalizmin e financave, por ka të bëjë thjesht me policinë financiare në aspekt që krijohet një bord, pastaj që e menaxhon, bën politikat e kësaj inteligjence dhe drejtori që ekzekuton politikat e bordit. Personalisht mua, subjektin politik nuk i prish punë se ndoshta ti nesër mund të jesh ministër i Punëve të Brendshme, merre pak më seriozisht, por po ta them se çështja nuk ka të bëjë me çështjen financiare, por me inteligjencën e financave, andaj kjo do të ishte shumë më mirë po të ishte në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke pasur parasysh se kjo ministri ka mekanizmat shumë më të kompletuar në këtë drejtim për të luftuar në këtë aspekt edhe pastrimin e parasë dhe për të parandaluar financimin e terrorizmit. Kjo mendoj unë vërtet nuk do koment, që do të thotë është shumë më adekuate të jetë në kuadër të kësaj ministrie.

Megjithë ato, ndoshta, të metat që ka ligji, Lidhja Demokratike e Dardanisë do të japë kontributin e vet në komisionet funksionale, sidomos në Komisionin funksional për Buxhet e Financa dhe mendojmë se do ta japim kontributin aty duke pasur parasysh, ky ligj vërtet është i mirëseardhur dhe shpresojmë se me ngritjen e mekanizmave dhe kapaciteteve në bazë të këtij ligji do të jeni, zoti Ministër, më syçelë, vërtet për ta luftuar këtë dukuri që tashmë është e tejdukshme në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete Gaxherri! Nga Grupi Parlamentar 7+ nuk është lajmëruar asnjëri. Urdhëro, tash lajmërohet. Deputeti Zylfi Merxha e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zotëri kryesues!

Zotëri ministër, zonja ministre,

Zotërinj deputetë, kolegë që kemi mbetur këtu si fukara, në këtë të ftohtë, ata kanë shkuar të nxehen. Ne, në parim, Grupi Parlamentar "7+" e mbështesim këtë, se deri më sot ashtu një ligj s'kemi pasur. Ky është ligj i nevojshëm dhe është me vend, në qoftë se duhet diçka, Komisioni në të ardhmen do ta plotësojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i SLS, nuk është lajmëruar askush. Për Grupin Parlamentar për Integrim, Branislav Gërbiq ose Vezira Emrush. Deputeti Branislav Gërbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Ja se zahvaljujem predsedavajućem! Ujedno bih ispred Grupe za integracije rekao da u načelu ova grupa podržava ovaj zakon, jer je jako bitan za dalji nastavak uopšte, ne samo institucija, nego i života građana Kosova, jer radi se o finansijskoj delatnosti koja mislim da je vrlo bitna za jedan period finansijskog postizanja rezultata i ono što je za društvo jako bitno, finansijskog opstanka. Smatram da ovaj zakon kao takav sigurno će biti dobar. Međutim, ono što ovaj zakon treba da podržava, znači formiranje cena, cena na tržištu koje će biti reper ovog zakona ili kršenja ovog zakona.

Ako ne formiramo cene, cene zemljišta, cene građevinskih objekata koje će opštine sprovoditi kroz svoje takse, kroz svoje uredbe, mi nećemo znati da li je ovaj zakon ispoštovan ili nije ispoštovan i to je ono što sigurno treba biti jedan od uslova za sprovođenje ovog zakona.

U suštini, ovaj zakon je dobar. Međutim, ono što smatram da bi trebalo kao jedno od vrlo bitnih, to je onaj član 5. gde se radi o članovima borda. Ovde koliko sam ja brojao, ima 6 članova borda, ili 7.! Onda izvinite, ministre! Ali ono što bih ja rekao i dodao, to je da ovaj bord uglavnom ima znači funkcionere koji su možda i predstavnici većinskih partija ili koji zauzimaju te funkcije. Ne bi bilo loše možda da se iznađe mogućnost da budu i predstavnici manjinskih zajednica kao dodatni članovi možda ili kao ne obavezujući članovi, ali da eto budu prisutni u takvom jednom bordu, što mislim da nije neka velika..., mislim neka nemoguća stvar.

I ono što je drugo bitno u vezi ovog zakona, to je ono da će ova grupa u toj statutarnoj komisiji dati svoje predloge i biti aktivni učesnik kroz rad te komisije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Gërbiq! Pasi që kemi përfunduar me deklarinimin e grupeve parlamentare, propozoj që të shkojmë në drekë dhe të bëjmë një pauzë. Pauza do të zgjatë deri në orën 15 dhe pastaj vazhdojmë me punimet e seancës. Faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë debatin. Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje kolegë,

Projektligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit ka një rëndësi të madhe për shumë arsye dhe veçanërisht për faktin se ky do të forcojë luftën e përgjithshme kundër korrupsionit dhe aktiviteteve kriminale si dhe ne po i afrohemi plotësimit të pakos së ligjeve Antikorrupsion. Po ashtu mendoj se me këtë rast ne po bëjmë një punë të mirë në kuptimin e përmbushjes së standardeve dhe sfidave të raportit të progresit të Komisionit Evropian 2009 dhe me këtë rast më lejoni që menjëherë të kaloj në disa sugjerime që mendoj se mbase mund ta plotësojnë këtë kornizë ligjore dhe të avancojnë më shumë përpjekjet tona ndaj dukurive negative.

Së pari dua të them se ky projektligj do të duhej të plotësohej me një mekanizëm institucional i cili do të kishte për detyrë të drejtojë politikën e luftës kundër shpëlarjes së parave dhe në bazë të traditave rajonale ky mekanizëm në fakt udhëhiqet nga Kryeministri i vendit dhe në përbërje të tij do të duhej të ishin ministratë relevante siç janë: Ministria e Financave, e Punëve të Brendshme, të Jashtme, të Drejtësisë e të tjera dhe që do të kishte për detyrë që të bëjë platformën e luftës kundër kësaj dukurie si dhe të bashkërendojë veprimet në kuadër të këtij synimi.

Sugjerim tjetër, mendoj se është rëndësia që sanksionet ndaj atyre që bëjnë keqpërdorime të jenë më të ashpra. Unë i pashë, i lexova ato që janë paraparë në kuadër të projektligjit, por mendoj që do të duhej një shkallë më e lartë e ashpërsimit të sanksioneve si një mjet për të nxitur parandalimin dhe luftën më efikase kundër dukurisë së shpëlarjes së parave.

E treta, mendoj se në kuadër të subjekteve raportuese për këto çështje, në nenin 16, mendoj se duhet të përfshihen edhe disa subjekte, përfshirë edhe shoqëritë e sigurimeve, sepse edhe përmes tyre mund të përdoret infrastruktura për të realizuar këto veprime negative.

Në fund dua të them se projektligjet dhe ligjet e ardhshme në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit do të duhej të kenë mbështetje më të madhe buxhetore, si dhe një vullnet më të madh politik për planin e zbatimit të tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit! I nderuar zoti kryetar, I nderuar ministër Gashi dhe Yagcilar, me shpresën se në ndërkohë do të vijë ministri Shala, meqenëse është sponzorizues i ligjit.

Shpëlarja e parave dhe financimi i terrorizmit është një problem që nuk e godet vetëm Kosovën, por është një çështje dhe një problem global. Me faktin se shpëlarja e parave është një aktivitet me anë të cilit fitimet nga veprimtaritë kriminele futen në ekonominë e ligjshme me qëllim që të mbulohet ose fshihet origjina e tyre e paligjshme. Pos kësaj, shpëlarja e parave dhe financimit të terrorizmit ka ndikim negativ në vetë sistemin e financimit, pastaj në ekonomi, por edhe në shoqëri në përgjithësi. Pastrimi i parave rrit mundësinë që vetë institucioni financiar të bëhet i korruptuar apo edhe i kontrolluar nga interesa kriminele, pasojat janë reputacioni i rrënuar dhe humbja e besimit të investitorët. Prandaj, krijimi i infrastrukturës ligjore për parandalimin e shpëlarjes së parave është në radhë të parë parandalimi i përdorimit të sistemit financiar për shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit. Rrjedhimisht ky projektligj është një mjet efikas për luftimin dhe ndalimin e krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera kriminale.

Deri më sot kjo fushë kryesisht është rregulluar me Rregullore të UNMIK-ut mbi pengimin e shpëlarjes së parave dhe veprave të ngjashme penale, por kjo rregullativë në situatën e tanishme nuk është e mjaftueshme, prandaj nevojitet avancimi i mëtejme. Por, praktikisht dhe parimisht, së pari për ta përmbushur projektligji objektivën të cilën e ka shtruar është dashur që Qeveria të hartonte strategjinë nacionale për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, bazuar në politikat e parandalimit dhe të luftimit dhe në këtë strategji duhet bazuar edhe ky projektligj. Me këtë projektligj përcaktohen masat, procedurat dhe autoritetet përkatëse për zbulimin dhe parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Parandalimi i pastrimit të parave është i bazuar në detyrimet e mëposhtme.

1. Kujdesi i duhur ndaj klientit,
2. Mbajtja e të dhënave në lidhje me marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet e rastit,
3. Miratimi i procedurave të mjaftueshme organizative,
4. Raportimi i transaksioneve të dyshimta.

Mekanizmi kryesor në këtë projektligj për parandalimin e këtij fenomeni është Njësia për Inteligjencë Financiare, e cila formohet në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Njësia për Inteligjencë Financiare është institucion i pavarur i cili është përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin, shpërndarjen tek autoritetet kompetente dhe bërjen publike të informacionit. Prandaj, parimet mbi të cilat bazohet puna e kësaj njësie është bashkëpunimi me mekanizmat brenda dhe jashtë vendit, transparenca dhe ruajtja e

fshehtësisë. Punën e kësaj njësie e mbikëqyr bordi i cili siguron pavarësinë e këtij institucioni. Udhëheqës i këtij bordi është ministri i Ekonomisë dhe Financave, kurse të tjerët janë përfaqësues të institucioneve ex-officio Sipas mendimit tim, nuk duhet të jetë udhëheqës i këtij bordi ministri i Ekonomisë dhe Financave, por duhet gjetur një zgjidhje tjetër, ndonjëri ndoshta nga këta që janë ex - officio.

Entitetet financiare që duhet t'i plotësojnë kërkesat e raportimit të transaksioneve, përfshinë bankat dhe institucionet financiare, kërkesave të raportimit dhe mbajtjes të dhënave i nënshtrohen edhe avokatët, auditorët, kazinotë, agjentët e pasurive të patundshme, këshilltarët e tatimeve dhe kontabilistët.

Entitetet financiare bëjnë miratimin e masave, rregullave dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta, duke përfshirë zbatimin e parimit – njëhe klientin tënd. Këto janë masa për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientit, marrja e informacionit për qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënieve të biznesit. Janë paraparë edhe masat adekuate specifike të kujdesit të duhur ndaj klientit në rast të ndonjë rreziku të madh të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Bankat dhe institucionet financiare do të nxjerrin procedura të brendshme, të kontrollimit, të parandalimit dhe zbulimin e shpëlarjes së parave. Këto janë edhe detyrimet shtesë të OJQ-ëve, partive politike, kandidatëve të regjistruar, noterëve e tjerë.

Detyrimet për mjetet monetare që qarkullojnë brenda dhe jashtë Kosovës, që tejkalojnë shumën prej 10.000 eurove, duhet të paraqiten dhe të sqarohet burimi i tyre.

Projektligji parasheh sanksionet administrative, ankesa në vendimin e këtyre, si dhe sanksione penale sipas Kodit të Procedurës Penale dhe dispozitave të këtij. Megjithatë ky projektligj ka edhe mangësitë e veta të cilat do t'i numëroj dhe të cilat i kam radhitur në gjashtë.

E para, në pjesën e përkufizimeve, neni 2 pika 1.13 është dhënë shkurtesa TFVF, që do të thotë task-forca e veprimit financiar. Nuk është përkufizuar nocioni dhe as nuk është përmendur më vonë përmbajtja ose roli i TFVF-së. Propozimi im është që duhet definuar qartë se çfarë është task-forca e veprimit financiar, meqenëse ky është një organ kryesor ndërkombëtar i besueshëm për ndalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

E dyta, mungon përcaktimi i mënyrë së organizimit të Njesisë së Inteligjencës Financiare, të përbërjes, caktimit të stafit mbështetës si sekretarit, masat për të mbrojtur ose forcuar pavarësinë e NIF-it, si dhe përmbajtjen dhe metodat e transmetimit të raporteve që i merr.

Propozoj që përbërja e Njesisë së Inteligjencës Financiare të bëhet nga ekspertë, posaçërisht në fushat e financave, bankave, ligjit, informatikës, doganave apo hetimeve të policisë. Gjithashtu kjo njësi duhet të ketë edhe oficerë ndërlidhës ... për bashkëpunim me administratat e tjera ndërkombëtare. Njësia e Inteligjencës duhet të mbështetet nga një sekretariat.

E treta, është mungesa e përcaktimit të saktë të autoritetit përzgjedhës për përzgjedhjen e drejtorit të kësaj njësie. Meqenëse në projektligj qëndron se vetëm Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e bën përzgjedhjen e drejtorit, gjegjësisht caktimin e listës së ngushtë, duhet saktë të definohet se cili është autoriteti i cili e kryen këtë punë?

E katërta, mungon caktimi i procedurave të qarta të bashkëpunimit ndërkombëtar, dhe

E pesta, nuk është saktësuar se cilat udhëzime administrative për zbatimin e ligjit do t'i nxjerrë Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe brenda cilës periudhë kohore?

Dhe e fundit, e gjashta, është ajo që zoti Maloku e përmendi se nuk duhet ky bord të udhëhiqet nga ministri i Ekonomisë dhe Financave.

Sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin evropian, nuk është në përputhshmëri të plotë, sidomos me Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit 2005/60 dhe Direktivën e Komisionit 2006/70.

Sa i përket dispozitave kalimtare këtu përfshin aktivitetet e kalimit të përgjegjësive nga njësia e deritanishme e quajtur Qendra e Informimit Financiar në Njësinë për Inteligjencën Financiare, si dhe çështjet e bashkëpunimit dhe përgjegjësive në mes EULEX-it dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave në bazë të marrëveshjes.

Implikimet buxhetore nuk janë paraparë për vitin 2010, meqenëse edhe tani ekziston Qendra e Informimit Financiar dhe punëtorët të cilët punojnë aty duhet të kalojnë në Njësinë e Inteligjencës Financiare, por parashihen shpenzimet në 2011, sepse është e paqartë se a do të shtohet numri i të punësuarve në Njësinë e Inteligjencës Financiare, sa do të jenë shpenzimet e funksionimit të kësaj njësie dhe bordit menaxhues si dhe të stafit mbështetës, gjegjësisht sekretarit. Prandaj, që të sigurohemi se ligji do të zbatohet në tërësi, kërkoj nga ministri i Ekonomisë dhe Financave, që të sqarojë se a është i siguruar gjithashtu buxheti? Në parim e përkrah me vërejtjet të cilat i përmenda. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Emri është gjithmonë esenca dhe në fusha tjera të dijes, në ligje po se po. Unë insistoј që të merret në shënim saktë kjo që po them. Titulli, si e keni edhe në ligj, edhe në dokumente, shqip është gabim dhe ju lutem shumë le të emërtohet në shqip ligji, kështu si po them unë: "Projektligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe për parandalimin e financimit të terrorizmit".

Formulimin që e kemi në të gjitha dokumentet, qoftë edhe në projektligj, është gabim, sepse nënkupton krejt diçka tjetër. Pjesa e parë sintaktikisht është në rregull, e dyta e thotë të kundërtën.

Tutje, unë mendoj që ky ligj është i domosdoshëm për Kosovën, nën një.

Nën dy, mendoj që si Kuvend me komisionet përkatëse duhet të bëjmë përpjekje që ky ligj sa më shpejt të aprovohet në Kuvend dhe të hyjë në fuqi.

Dhe, nën tre, unë kërkoj dhe besoj e shpresoj që ky ligj do të zbatohet.

Këto tri pika po i them me qëllim, sepse dua të ritheksoj mënyra të ndryshme trefish që ligji është i domosdoshëm dhe duhet të veprojë në Kosovë.

Sa i përket ligjit, vërejtja ime themelore është përmendur në një mënyrë a në një tjetër edhe te disa shqyrtues tjerë, kolegë të Parlamentit, ka të bëjë me atë njësi që quhet Njësia për Inteligjencë Financiare, që del që është një nga trupat themelore të strukturimit dhe të përcjelljes së gjithë veprimtarisë themelore që përfshin ligji. Unë mendoj që kjo njësi e cila quhet e pavarur, nuk mund të jetë e pavarur nëse është në kuadrin e Ministrisë së Financave, aq më tepër kur kryetari i bordit është kryetari i Ministrisë së Financave, aq më tepër kur zëvendësin e vet, kryetari i bordit e bën një punëtor të Ministrisë së Financave, aq më tepër, aq më tepër, ju i keni 5-6 nene që e derivojnë edhe funksionin e drejtorit të kësaj njësie edhe të bordit.

Mendoj që ku është definimi te neni 4.2, ku thuhet: “Me qëllim që të luftohet në mënyrë efektive shpëlarja e parave dhe financimi i terrorizmit në Kosovë, ky ligj themelon njësinë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave” të fshihet kjo dhe të thuhet: “si institucion qendror i pavarur kombëtar”, sepse, dyshoj që mund të quhet institucion i pavarur ndërkombëtar një institucion i tillë, i cili është në gjirin e një ministrie dhe të cilin përmes bordit ose derivimit të organeve të bordit e drejton ministria, më saktësisht ministri.

Dhe unë këtu po e përfundoj diskutimin tim, mendoj që në diskutim të këtij njësi të bëhet me bisedime tutje në komisionet që do ta marrin në shqyrtim profesionalisht gjithmonë duke i pas thirr përfaqësuesit e Ministrisë. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në projektligjin për të cilin po bëjmë fjalë, tashmë janë përmendur shumë nga çështjet të cilat janë po ashtu edhe kanë tërhequr, po ashtu edhe vëmendjen time. Në parim e përkrah ardhjen e këtij ligji për debat në seancë dhe do të ndalesha në disa nga vërejtjet të cilat i kam.

Së pari është të bëhet harmonizimi i përkufizimeve me ligjet që i kemi në fuqi, apo me konventat ndërkombëtare.

Do të ndalesha në nenin 2 pika 1.2, mbajtësi i të drejtës së pronësisë dhe besoj që ajo e cila gjendet në projektligj nuk përkon me Ligjin mbi pronësinë dhe të drejtat pronësore.

Neni 2, pika 1.3. përmendet organizata afariste, gjë e cila në Ligjin për shoqëritë tregtare nuk ekziston si term. Më herët një nga parafolësit e përmendi task-forcën e veprimit financiar, edhe unë mendoj që kjo do të duhej të përkufizohej dhe përcaktohej roli dhe përgjegjësia e këtij mekanizmi. Të qartësohet, po ashtu në nenin 2 pika 1.16 sa i përket ngrirjes dhe ndoshta më mirë do të ishte të quhej sekuestrim në vend që të quhej ngrirje dhe të riformulohet i tërë paragrafi, sepse sekuestrimi nuk ka mundësi të jetë i përhershëm, apo të thuhet se sekuestrimi është një proces i përkohshëm. Gjithashtu me fondet e sekuestruara nuk ishte dashur që personi i dyshimtë të ketë mundësi të vazhdojë aktivitetin e tij financiar. Pra, gjatë kësaj kohe duhet të pamundësohet vazhdimi i aktivitetit financiar deri në një vendim tjetër.

Po ashtu te sekuestrimi i përkohshëm duhet të dihet edhe autoriteti se kush mund të sjellë vendim për sekuestrim të përkohshëm dhe transaksionin financiar.

Tek neni 2 pika 1.23 shpëlarja e parasë mendoj se do të duhej të definohej sipas legjislacionit relevant ndërkombëtar, Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër trafikimit të drogave dhe substancave psiko-trope dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të rëndë transnacional.

Te neni 2 pika 1.33, tek konfiskimi është marrja e përhershme e pasurisë, pronave, sendeve dhe të gjitha aseteve të tjera të fituara nga veprat penale. I vetmi autoritet për të kryer konfiskim është gjykata kompetente dhe atë pas procedurës penale të përfunduar. Nuk ka mundësi që të menaxhohet e as administrohet nga kryerësi i veprës penale pasuria e konfiskuar, me atë pasuri do të duhej të menaxhonte Agjencioni për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar.

Edhe te konfiskimi sikurse te sekuestrimi nuk ka mundësi që kryerësi i veprës penale të vazhdojë administrimin e pasurisë së konfiskuar ashtu siç përcaktohet në projektligj.

Neni 2 pika 1.36, po ashtu te financimi i terrorizmit, ku përmendet mendoj se është me rëndësi të përkufizohet dhe të definohet sipas legjislacionit relevant ndërkombëtar, Konventës së Kombeve të Bashkuara për parandalimin e financimit të terrorizmit.

Neni 4, njësia e Inteligjencës Financiare e cila zgjoi më së shumti debat sot në këtë pikë, mendoj se janë tri qëllime të kësaj njësie. E para është mbledhja e informacionit të raportuar, analiza dhe shpërndarja e informacionit financiar, të gjitha këto me qëllim të parandalimit apo edhe zbulimit, detektimit të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Kësaj njësie po ashtu mund t'i shtohet edhe përgjegjësia e kërkesës për informacion nëse aprovohet sot. Dhe do të kishte për qëllim paraqitjen e kërkesave institucioneve të caktuara financiare për të ofruar informacion shtesë për dyshimin e shpëlarjes së parave apo financimit të terrorizmit.

Te neni 4, pika 2 – të pavarur, është dhënë një definicion se kjo njësi, Njësia për Inteligjencën Financiare si institucion i pavarur nuk definohet, por definohet si Agjenci qendrore kombëtare për pranimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit tek institucionet kompetente. Konsideroj se duhet të rishikohet domethënia e fjalës “e pavarur”. Pavarësia e këtij institucioni duhet të sigurohet me mënyrën e emërimit të drejtorit, zëvendësdrejtorit, me sigurimin e buxhetit të nevojshëm për funksionimin me mos ndikimit në aktivitete tjera.

Neni 5, bordi menaxhues, po ashtu, siç u përmend edhe më herët, edhe unë i kam vërejtjet e mia se kjo njësi nuk duhet të jetë përgjegjësi e bordit menaxhues sipas këtij projektligji. Duke pasur parasysh përgjegjësitë, zyrtarët, anëtarët në këtë bord kanë pushtet ekzekutiv dhe të gjithë janë organe me të cilat bashkëpunon kjo njësi. Njësia do të ofrojë informacion për shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit për drejtorin e policisë nëse ekziston dyshimi i bazuar për elemente të veprës penale. Po ashtu do të ofrojë informacion për Prokurorinë e Shtetit dhe në momentin kur ka prova të mjaftueshme se është kryer vepër penale, do të ofrojë informacione edhe për mekanizma tjerë anëtarë të këtij bordi, prandaj e konsideroj të panevojshëm që këtë bord menaxhues, kjo formë e menaxhimit krijon konflikt interesi në funksionimin e kësaj njësie. Ekzistojnë disa forma se si rregullohet kjo njësi në shtetet e ndryshme. Për shembull, në disa vende ka formën e organit administrativ siç janë: Belgjika, Kanada, Kroacia, Çekia, Franca, Holanda e tjerë dhe sipas këtij modeli kjo njësi është pjesë e autoritetit mbikëqyrës, si për shembull Bankës Qendrore ose Ministrisë së Financave si autoritet i pavarur dhe qendrore administrative. Modeli tjetër është në cilësinë e zbatimit të ligjit dhe sipas saj

kjo njësi është pjesë e policisë sikurse në Austri, Estoni, Gjermani, Sllovaki, Suedi e tjerë. Modeli tjetër është modeli prokurorial ose gjyqësor dhe sipas kësaj njësie duhet të jetë pjesë e autoritetit gjyqësor ose pjesë e Zyrës së prokurorit, siç është në Luksemburg apo në Qipro. Modeli i fundit është modeli i përzier, i cili gjendet në Norvegji apo në Danimarkë. Duhet të përcaktohet njëra nga proceset ose procedura e emërimit ose procedura e zgjedhjes të drejtorit të Njesisë.

Të shtohet, po ashtu, nën i veçantë, me të cilin do të kërkohet që i gjithë stafi i kësaj njësie të jetë në harmoni me Ligjin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë.

Në nenin 6, pika 1.4, Buxheti i Njesisë së Inteligjencës Financiare duhet të hartohet nga drejtori dhe jo nga Bordi, do të aprovohet nga Qeveria dhe Parlamenti. Drejtori i Njesisë duhet të përgatitë legjislacionin gjyqësor dhe miratohet nga kryeministri, si dhe mendoj se meqenëse Bordin e shoh të panevojshëm, atëherë propozoj që neni 8 dhe 9 të hiqen.

Neni 11, pika 7, mandati i drejtorit të zëvendësohet jo ashtu siç është 3 vjet, por të jetë 4 + 4 vjet, si dhe duhet të shtohet një nen i veçantë për institucionet të cilat janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

Në parim e përkrah ligjin me ndryshimet e propozuara. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit deputete! Armend Zemaj e ka fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Sigurisht që është shumë i nevojshëm miratimi i këtij projektligji, edhe pse gjatë procesit mund t'i evitojmë disa mangësi apo disa paqartësi rreth organizimit dhe detajizimit sa më të suksesshëm, si nga udhëheqja, ashtu edhe në vazhdimësi, i cili do të jetë implementimi edhe në praktikë apo zbatimimi i këtij ligji.

E mira është që projektligji ka ardhur. Ata të cilët kanë qenë të involvuar në hartimin e këtij ligji, janë njerëz faktorë, duke marrë parasysh edhe nga Qeveria, edhe nga njerëzit që i ndihmojnë dhe i mbështesin proceset në Kosovë. Sigurisht që janë munduar ndoshta t'i inkorporojnë edhe përvojat e vendeve të tyre edhe këtu në këtë projektligj.

Unë edhe në seancën e kaluar kam pasur vërejtje sa i përket emërimit të tij kur e kemi shqyrtuar edhe strategjinë, planin e Kuvendit, emërtimin e këtij projektligji, sepse ne më vonë e kemi Projektligjin i cili do të vjen për luftimin dhe parandalimin e terrorizmit dhe mendoj që aty ndoshta do të fokusohet edhe termi. Ndoshta financimi i aktiviteteve kriminale do të përfshijë edhe në atë aspektin jo vetëm të ndahet vetëm terrorizmi, por të gjitha aktivitetet kriminale që kanë të bëjnë me eliminimin e dukurive negative, në këtë kontest që niset nga pastrimi apo shpëlarja e parave.

Krahas këtij ligji, mendoj që për të mos pasur dilema në të ardhmen apo mosharmonizim, unë mendoj që duhet në afatin sa më të shkurtër të kemi edhe Ligjin për bankat, Ligjin për konfiskimin e pasurisë së fituar me kriminalitet, sepse konfiskimi i pasurisë, atëherë nuk dihet se çka, cilat janë procedurat përpos ruajtjes, që e kemi Ligjin për sekuestrimin, i cili administrohet nga agjencioni në formim dhe Ligji për lojërat e fatit e tjerë. Mendoj që duhet të jenë në harmoni me këtë projektligj.

Te neni 5, - Përbërja e Bordit, është e kuptueshme që një bord duhet të jetë mbi këtë njësi, por në këtë bord të mos jetë, për shembull, është mendimi i imi, drejtori i Departamentit të Thesarit, që është pika kyçe e transfereve të parave që ndodhin dhe sillen në relacion me bankat. Unë mendoj që ajo do të jetë edhe një pikë referuese për dhënien e informacioneve dhe që do t'i ndihmojë kësaj njësie, e cila prapë që do të thuhet, të jetë në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa. Sigurisht që një rol duhet ta luaj edhe Ministria e Drejtësisë ... duke marrë parasysh, e them, edhe raportet në luftimin, tani në këtë pjesën e terrorizmit, marrëveshjet ndërkombëtare që bëhen apo informatat e ndryshme që vijnë përmes luftimit të kriminalitetit, me bashkëpunim ndërkombëtar përmes Ministrisë së Drejtësisë.

Një vërejtje tjetër është te neni 10, ku thuhet që Bordi i drejtorit të Auditorit Gjeneral të Kosovës, që ta auditojë NJIF-in, nëse është e nevojshme. Jo që duhet t'i drejtohet, por ajo duhet të jetë e nevojshme çdo herë, se dikush duhet ta bëjë auditimin dhe ta kontrollojë në menaxhimin e parave, të financave e tjerë, sepse kjo paguhet nga buxheti i Kosovës. Kjo duhet, sikur çdo agjencion tjetër që bëhet auditimi nga Auditori Gjeneral, kjo duhet të jetë e precizuar që t'i bëhet edhe kësaj njësie, e cila do ta ketë një rëndësi shumë më të veçantë, ndoshta edhe transparencën më të madhe.

Ajo tjetra çka është, që thuhet që NJIF-i nuk është i obliguar që të zbulojë ndonjë informacion, jo që nuk duhet të jetë i obliguar, por ai nuk bën absolutisht të jetë strikt, nuk bën që t'i zbulojë informacionet se atëherë bien edhe rëndësia e luftimit të kësaj, mos të jetë vetëm si masë preventive, por të jetë tamam luftim i aktiviteteve kriminale.

Te drejtori i Njesisë së Inteligjencës Financiare, neni 11, unë mendoj që këtu duhet t'i japë hapësirë, të jetë konkurs i hapur publik, edhe pse flitet më vonë, pas përzgjedhjes dhe përshkrimit detal se si do të jetë forma e përzgjedhjes apo i një njeri i cili është, sepse ndoshta edhe nga përkthimet që i kanë marrë nga adaptimi i ligjeve tjerë, nuk bën të jetë autoritet vendor, për shembull, është aty shumë e pakuptimtë, se ne nuk mund mos të jetë autoritet vendor, atëherë çfarë do ta përzgjedhin, dhe pika 7, që është mandati, thotë është 3 vjet dhe mund të përsëritet. Mandati është 3 vjet, mund të rizgjidhet edhe 3 vjet ose 2 vjet, por nuk mund të përsëritet mandati pa procedurë.

Te neni 14, raportet dhe informacionet për dyshimet për shpëlarjen e parave ose financimit të aktiviteteve terroriste, mendoj këtu lidhet me aktivitetet kriminale, sepse nuk mund të ndërlihet vetëm me një aktivitet, por të gjitha aktivitetet kriminale që kanë të bëjë me informacionet edhe të gjitha ato sekrete.

Pa dashur të ndalem për çdo detal, është edhe te neni 22. Ne e kemi në procedurë Ligjin për financimin e subjekteve politike. Edhe këtu flitet për normat dhe shumat si të vogla, si të mëdha që mund t'i pranojë. Prandaj, kjo duhet të adaptohet me atë pjesën, se ne akoma nuk kemi vendosur se cilat do të jetë.

Çështja tjetër është se këtu çdo përshkrim, informacionet për paranë e gatshme thotë: "përmbi 10.000 duro", por si do të jetë në luftimin e asaj nën 10.000 euro, që mund të ndodhë brenda dite ose nga një person i caktuar që të përsëritet në vazhdimësi dhe banka të mos raportojë dhe kjo duhet të precizohet se është, nëse është për pengimin e shpëlarjes së parasë, ajo do të jetë edhe një mundësi e mirë që 9.999 euro ... dhe nuk ka kurrfarë informacioni. Prapë mbetet që ajo shumë është e dyshimtë, ndërsa kur flitet për partitë politike, e kanë përkufizuar mirë 5.000 euro, 1.000 euro dhe këto e kanë gjetur

mënyrën. Kjo mendoj se duhet të jetë për të gjitha transaksionet e dyshimta, të jenë të obligueshme, nëse po e them edhe një herë, bëhen nga individë ose nga një ditë të vetme që mund të jetë.

Ka shumë nene, unë mendoj që janë të ngarkuara dhe të jenë të rënduara, për shembull është përshkrim detal i nenit 29, deri te ajo që flitet për ruajtjen e sekretit profesional e shumë përsëriten në vazhdimësi prej një paragrafi, prej një neni, në nenin tjetër, këto mendoj se duhet të jenë të përkufizimet dhe nuk ka nevojë në vazhdimësi të përsëriten.

Këto ishin disa vërejtje dhe mendojmë ka hapësirë për të kontribuar dhe për ta përmirësuar. Ajo çka është brengë e imja, është harmonizimi me ligjet tjera. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe të financimit të terrorizmit është një ligj me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës, ligj për të cilin jam interesuar që të shqyrtohet në këtë Kuvend, e për të cilin kam parashtruar pyetje parlamentare, andaj e përshëndes Grupin punues të Ministrisë përkatëse për punën e bërë.

Parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit, është njëra nga mjetet më efikase për luftimin dhe ndalimin e krimit të organizuar dhe formave të tjera të aktiviteteve kriminale. Ndalimi i keqpërdorimit të institucioneve financiare për legalizim të origjinës së parave të fituara nga veprat penale, është domosdo e nevojshme për një sistem financiar të qëndrueshëm dhe efikas.

Ky projektligj krijon Njësinë për Inteligjencën Financiare brenda Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, si një institucion qendror i pavarur kombëtar, përgjegjës për të kërkuar zbulimin e informacionit që ka të bëjë me pastrimin e mundshëm të parave dhe aktivitetet terroriste në Republikën e Kosovës.

Ligji i propozuar është i harmonizuar me direktivat evropiane konkrete. Edhe pse Ligji i propozuar përmban një teknikë juridike të mirë, një gjuhë juridike të përsosur dhe të qartë, megjithatë ka vend që në projektligj të bëhen edhe ndryshime dhe riformulime të caktuara. Kështu, në nenin 26, propozoj këtë formulim juridik: “Nëse avokatët, noterët, kontabilistët, auditorët e licencuar dhe këshilltarët tatimorë nuk mund të identifikojnë klientin ose ta verifikojnë identitetin e tyre, nuk do të pranojë pasuri nga klienti ose në emër të tij për asnjë qëllim”.

Në nenin 26, paragrafi 3, propozoj që të bëhet riformulim në këtë mënyrë: “Çdo profesionist në fjalë, i cili gjatë kryerjes së shërbimeve për klientin, në shumë prej 10.000 eurove apo më shumë për një transaksion, do të dorëzojë raport tek Njësia e Inteligjencës Financiare brenda 8 ditëve nga transaksioni i raportuar”, pra për ndryshim nga propozimi i bërë në projektligj.

Në nenin 29, paragrafi 1, propozoj fshirjen e termit: “interalia” apo “midis të tjerash”, sepse ky term nuk e ka vendin aty, është i panevojshëm dhe nuk shpjegon asgjë.

Në nenin 29, paragrafi 4, propozoj që gjoba e paraparë prej 25% të zëvendësohet me atë prej 30% , në qoftë se personi i cili nuk i respekton dispozitat e neneve 29.1, apo 29.2, kryen vepër të kundërvajtjes. Prandaj, unë pajtohem edhe me parafolësit të cilët propozuan që sanksionimi të jetë më i fuqishëm në këtë aspekt.

Në po të njëjtin nen, paragrafi 6, propozoj që gjoba e shqiptuar, nëse nuk paguhet menjëherë, nëpunësi i autorizuar i doganës do të konfiskojë dhe mbaj 30% të shumës së mjeteve monetare, e jo ashtu siç është propozuar në projektligj.

Në nenin 32, propozoj këtë riformulim: “ Gjykatat e Qarkut janë kompetente për të gjitha veprat penale sipas këtij neni”. Marrë në përgjithësi, projektligji i propozuar i plotëson kushtet për t’u miratuar në shqyrtim të parë, ndërsa amendamentet përkatëse do t’i paraqes në komisionin funksional. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina dhe le të përgatitet Riza Smaka, i fundit për këtë pikë të rendit të ditës.

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit, kryetar!

Projektligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, të cilin po e shqyrtojmë sot, paraqet një nevojë imediate dhe është mirë që, më në fund, e kemi në rend të ditës edhe në Kuvend.

Besoj se aprovimi i tij do të bëjë të mundur që të ndërmerren masat për parandalimin dhe luftimin e krimit, si dhe të shpëlarjes së parave. Me qenë se Rregullorja aktuale e UNMIK-ut, numër 2004/2, si dhe Rregullorja e UNMIK-ut, numër 2005/9, nuk ofrojnë kornizë ligjore të mjaftueshme për parandalimin e aktiviteteve kriminale, për shpëlarjen e parave, prandaj është më se e nevojshme, pra, të kemi një ligj i cili do ta luftojë këtë dukuri.

Sikurse vendet tjera që janë në proces të tranzicionit politik dhe ekonomik, edhe Kosova konsiderohet një vend mjaft i përshtatshëm për pastrim të parave, gjë që mundësohet edhe për shkak të mungesës së infrastrukturës ligjore. Derisa në një vend nuk ka ekonomi të zhvilluar, që do të ishte burim i të ardhurave, kurse në anën tjetër bëhet pasurimi i shpejtë i njerëzve dhe krijimi i kapitaleve të mëdha, domosdo parashtrohet pyetja se ku është burimi i atyre mjeteve. Ndërsa, për ta luftuar shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë, ky projektligj parasheh themelimin e Njesisë të Inteligjencës Financiare në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

Në nenin 4 të këtij projektligji, pika 2, thuhet se “ Njësia për Inteligjencë Financiare parashihet të jetë një institucion qendror i pavarur kombëtar”, por megjithatë mbetet një pyetje se a do të jetë vërtet kjo njësi e pavarur, meqenëse do të jetë në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

Lidhur me këtë projektligj, unë kam edhe një vërejtje dhe janë paraqitur edhe disa paqartësi. Vërejtja ime ka të bëjë me nenin 5, përkatësisht me Bordin menaxhues, ku përmenden të gjithë përfaqësuesit kush mund të përbëjë Bordin menaxhues të këtij institucioni, mirëpo unë do të kisha propozuar që disa kriterë që vlejné për zgjedhjen e drejtorit të Njesisë së Inteligjencës Financiare, do të duhej të vlejné edhe për anëtarët e Bordit, siç është paraqitur në nenin 11, pika 3.4.3 që këta anëtarë të mos kenë konflikt interesi në pajtim me Ligjin për konfliktin e interesit.

Sa iu përket paqartësive, mendoj se është një paqartësi se transferimi i përgjegjësive nga Qendra e Informimit Financiar në Njësine për Inteligjencë Financiare, si dhe është parë se nuk është definuar si duhet struktura organizative e Njesisë së Inteligjencës Financiare, por mendoj që gjatë fazës së amendamentimit të këtij Projektligji mund të qartësohen dhe të definohen më mirë. Me gjithë këto vërejtje, mendoj se ky projektligj duhet të miratohet, në parim, dhe shpresoj se do të zbatohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete! Fjalën e ka diskutuesi i fundit për këtë rend dite, deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Të nderuar ministra, deputetë,

Me vend disa kolegë të nderuar u përqendruan te titulli, titulli nuk është i përshtatshëm, tek e fundit ja edhe disa objeksione.

Ligji për parandalim, parandalimi është preventiva, dukuritë negative luftohen edhe me represivë, se është e pamundur që me preventivë t'i luftojmë. Dihet fare mirë, bëhet njëfarë prese, do të duhej Ligji kundër, kundër dhe jo shpëlarjes, po i bie ajo punë që për herë të dytë nëse të pastroheshin, se për herën e parë do të toleroheshin. Po, pastrimi edhe në gjuhët e jashtme, është pastrimi i parasë së pistë, fjala për paranë e pistë, ju lutem.

Më pastaj, ky dokument do të duhej medoemos ta kishte përmbajtjen. Është shumë me rëndësi, do të duhej edhe ky edhe tjerat t'i kenë edhe autorët që e kanë hartuar, se ngrihet edhe shkalla e përgjegjësisë së atyre që e përgatisin, se kur e dinë që ju del emri aty, do të kujdeseshin pak më tepër se sa që kujdesen përndryshe.

Në tekst, në parim, ju lutem, kurdoherë duhet njëjësi e shumësi, se del e kundërta më pastaj, del se njëjësi nuk ka të drejtë, nëse kanë qytetarët, nuk ka qytetari të drejtë. Terminologjia e këtij dokumenti është tipike e karakterit referues edhe raportues edhe për aq më pak juridik, do me thënë sikur raportet që jepen, referatet e kështu diçka. Janë nenet shumë të gjëra edhe nuk janë të sistemuara, nuk janë të kondenzuara.

Me nenin 32 të këtij dokumenti përcaktohen veprat penale. Është rregull elementare që veprat penale përcaktohen, definohen, specifikohen me Kodin penal e jo me akte tjera.

Më pastaj, me nenin 33, gabimisht thotë ndër të tjera, se gjykatat e qarqeve do ta kenë juridiksionin për veprat penale të përcaktuara me këtë ligj, që me kompetencat, juridiksionet e gjykatave përcaktohen me Ligjin për gjykatat, aq më parë kur e kemi dhe e presim shumë shpejt Ligjin për gjyqësorin, ku është dizajnuar që mos të kemi gjykata të qarqeve. Konsideroj që me vend, do të duhej t'i kishim gjykatat themelore, Gjykatën e Apelit, e tash, nëse do ta kishim miratuar kësisoj, mbas një kohe krejt të shkurtër do të duhej prapë për ta marrë në dorë, për ta bërë ndryshimin dhe plotësimin, se nuk do të kishte gjykata e qarqeve.

Me nenin 34 është bërë një gabim juridik material, ky do me thënë është i pafalshëm. Ja, ju lutem, është thënë se me këtë dispozitë përcaktohet përgjegjësia penale e personave juridikë. Po, personi juridik, entiteti legal nuk përgjigjet penalisht, kurrësi nuk përgjigjet, përgjigjet përfaqësuesi ligjor dhe eventualisht të tjerët që janë ushtrues, kryerësit e punëve të caktuara. Përgjegjësia penale është apriori e përjashtuar për subjektet juridike, për personat legalë, këtu i quan persona juridikë.

Me nenin 35, shkon e përpunon atje lirim nga përgjegjësia. Po kjo është çështje e gjykatave, është çështje e Kodit për procedurën penale, atje ka rregulla shumë të mira të karakterit Jus specialis derogat jus generalis. Me këtë nuk mund të përcaktohen ato rregulla kur lirohet, kur do të mund të lirohej ai apo ajo, ata apo ato, që do të ishin të përgjithshëm. Më pastaj, përdoret një konstruksion i paqëndrueshëm inekzistent – sanksioni profesional. Ka sanksione disiplinore, kundërvajtëse, administrative, civile, penale, ama sanksion profesional nuk ka. Mund ta konstruktojmë ne kushtimisht për ta përdorur në rastin e caktuar, por jo edhe në kategorinë ligjore.

Në nenin 37 është definuar disi, dosido sekreti profesional, po më i rëndësishmi nuk është definuar – sekreti zyrtar, që është shumë i nevojshëm. Në parim, do ta përkrahim këtë dokument, por me të vërtetë ka shumë lëshime edhe gjuhësore, edhe terminologjike, edhe konceptuale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të këtij projektligji.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim. Prezent kemi 70 deputetë.

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, konstatoj se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional,
- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisioni për Komunitete, dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që në afatin brenda 2 muajve ta shqyrtojnë dhe Kuvendit t’ia paraqesin Raportin me rekomandime.

Para se të fillojmë me pikën e radhës, kërkoj një qetësi pak më të madhe gjatë diskutimeve.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji..

Ftoj prezantuesin, kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetin Armend Zemaj, që në emër të komisionit para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Unë ju thashë, anëtarin e komisionit që është i ngarkuar për raportim, për prezantim. Komisioni është sponsorues. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Do t'ju lus që të më lejoni ta jap arsyetimin për kërkesën për propozim-ndryshim të Ligjit numër 03-L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar. Ndryshimet e propozuara në Ligjin për amendamentimin e Ligjit nr. 03-L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar kanë për qëllim evitimin e disa lëshimeve teknike, por që kanë ndikim në zbatimin e ligjit. 1.1, paragrafët 2.3 dhe 4 të nenit 64, fshihet referenca, të fshihet “1 janar 2010” dhe të zëvendësohet “më 1 korrik 2010”. Me këtë ligj është propozuar ndryshimi i referencës për hyrjen në fuqi të ligjit, që është paraparë më 1 janar 2010 dhe është propozuar nga Komisioni, në bashkëpunim me partnerët USAID-in dhe me Administratën Tatimore që Ligji të hyjë në fuqi më 1 korrik 2010. Ky ndryshim kërkohet të bëhet me arsyetim se për zbatimin e këtij ligji kërkohen së paku 6 muaj kohë për përgatitjen e akteve nënligjore dhe të dokumenteve tjera përcjellëse në pajtim me ligjin e ri.

Ligji numër 03-L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar është miratuar në Komisionin për Buxhet në shtator të vitit 2009 dhe është konsideruar se në atë muaj do të miratohet në Kuvend. Në atë kohë është vlerësuar se data 1 janar 2010, do të jetë e mjaftueshme për zbatim të Ligjit, mirëpo ligji ka mbetur për shqyrtim në komisionet e tjera dhe nuk është proceduar në miratim në Kuvend deri me 30 dhjetor 2009.

Në këtë rast duhet të theksohet se ligjet nuk kanë veprim retroaktiv sepse ato zbatohen vetëm pas hyrjes në fuqi. Prandaj, është shumë i nevojshëm ndryshimi i datës të hyrjes në fuqi të ligjit për ta mundësuar zbatimin e plotë të ligjit. Njëherësh, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë propozim-ndryshim të këtij Projektligji. Ju faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Vetëm një sqarim për ata që e kërkuan ministrin. Sipas Rregullës 33.1, pas Qeverisë, menjëherë të drejtën për prezantim të Projektligjit e kanë komisionet. Në këtë rast e ka pasur Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Përsëndetje për Kabinetin qeveritar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03-L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe ne si Grup Parlamentar e përkrahim këtë plotësim- ndryshim, pra jemi pro një ndryshimi të tillë, sepse e kemi parë se është më se e domosdoshme, meqenëse është miratuar ligji me vonesë, atëherë të bëhet një shtyrje e implementimit për t'i dhënë mundësi nxjerrjes së rregulloreve dhe të udhëzimeve të nevojshme për implementimin e këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të LDK-së, e tha Armendi, ju faleminderit! Në emër të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës lidhur me këtë projektligj kemi për të thënë që Grupi ynë në hartimin e Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për tatimin në vlerën e shtuar e ka dhënë kontributin e vet në vitin e kaluar, kurse ky dokument që e kemi sot para veti nuk është ndonjë ndryshim përmbajtësor, por është vetëm një përjashtim nga mosrespektimi i implementimit të ligjeve tjera. Ky është përjashtim, sepse të paktën po

kërkohet të shtyhet afati i implementimit të tij. Përndryshe, Ministria e Financave ka pasur mjaftë kohë të përgatitet për implementimin e këtij ligji ashtu siç është miratuar, sepse ka qenë propozues dhe afatet nga propozimi, në prill, dhe miratimi në Komisionin për Buxhet, në shtator, ka pasur kohë që të përgatitet për implementimin e tij prej 1 janarit, por nuk ka pasur kohë sepse është marrë me ndryshimin, ndërrimin e kuadrove nga ata profesional në politik dhe tash i duhet një kohë shtesë 6 muaj për t'u marrë me implementimin e këtij ligji. Përndryshe, e vetmja e mirë është që, të paktën, formalisht kanë kërkuar afat për të implementuar këtë ligj, sepse tjerat sipas monitorimit as nuk po implementohen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,
Ministra dhe deputetë,

Grupi Kuvendor i AKR-së gjykon se subjekt për ndryshime të këtij dokumenti do të duhej të ishte kjo çështje, që është shumë e rëndësishme për bizneset, sidomos të vogla e të mesme, që taksa e TVSH-së mos të inkasohej në fillim, e mos t'i paralizonte që në fillim bizneset me pagesat në kesh, sepse prodhimet finale mund të realizohen në kushtet tona brenda 3, 4, 5 viteve, po në fund, sikur që veprojnë të gjitha shtetet përreth edhe më tej. Ky do të ishte modifikim esencial, substancial tepër i rëndësishëm për bizneset tona, se nuk ka ekonomi pa biznese të shëndosha. Kjo është një.

Dy, çka kërkohet në këtë rast? Kërkohet një akomodimet i pashpjegueshëm, siç e tha zotëri Shatri, me vend, edhe 6 muaj ditë, sepse nuk paskan pas mundur t'i përgatisin aktet nënligjore. Ju lutem, zotëri kryetar, zotëri ministra dhe deputetë të nderuar, Kushtetutën do të kishim mundur për ta përgatitur me komoditetin më të madh, duke i përfshirë edhe debatet publike nëpër terren, brenda 6 muajve, e nuk paska pas mundur Ministria dy a tri akte normative. Ju lutem, kjo është qesharake, nuk është në rregull, nuk është mirë, sepse kjo është, do me thënë, këtu mund të dyshojë çka të dojë njeriu, kur është akt i pahijshëm, dyshimet disi pinë ujë, por gjithsesi nuk ka vend që, po e zëmë, të kërkohen edhe 6 muaj ditë, sepse po u dashka, bile këtu thotë: “më tepër, më gjatë se 6 muaj ditë”, sepse aktet normative nënligjore po u dashkan të përgatiten. Kjo është mirë që Kuvendi ta ketë një qëndrim kritik dhe t'i qortojë me vend këto administratat tona, të cilat me të vërtetë janë indolente, janë indiferente, janë të papërgjegjshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Mua po më vjen interesant, se Komisioni është prezantues. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputetja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po, realisht, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e përkrah, sepse këtu flitet për një..., ose ky e ka një qëllim teknik, evitimin e disa lëshimeve teknike ky ligj, por realisht nuk mund ta kalojmë kështu me memorandumin shpjegues që e ka dhënë, tash në daçi thoni Komisioni, në daçi Qeveria për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03-L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Më lejoni ta lexoj veç një pjesë edhe të them se kjo nuk është kështu, siç shkruhet në memorandum, se është mashtrim, por realisht Qeveria nuk ka mundur ta përmbush

detyrën e vet dhe pastaj është ardhur këtu për ta legjitimuar me këtë memorandum. Me këtë projektligj thuhet se është propozuar ndryshimi i referencës për hyrje në fuqi të Ligjit nunër kaq e kaq, mos t'ju marr kohë, për tatimin mbi vlerën e shtuar 1 janar 2010 dhe zëvendësohet me 1 korrik 2010. Ky ndryshim është bërë me arsyetim se për zbatimin e këtij ligji kërkohen së paku 6 muaj kohë për përgatitjen e akteve nënligjore dhe të dokumenteve tjera përcjellëse në pajtim me Ligin e ri, numër 03-L-146 për tatim mbi vlerën e shtuar, është proceduar nga Qeveria në Kuvend me 23 prill. Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar në shtator të vitit 2009, ka amendamentuar Ligjin, Projektligjin dhe është konsideruar se në atë muaj do të miratohet në Kuvend. Në atë kohë është vlerësuar se data 1 janar, natyrisht 2010, do të jetë e mjaftueshme dhe ashtu është, për zbatim të ligjit, mirëpo ligji ka mbetur për shqyrtim në komisionet tjera, nuk është e vërtetë, ka mbetur për shqyrtim në komisionet tjera, nuk ka pasur ku të mbetet dhe nuk është proceduar për miratim në Kuvend deri më 29 dhjetor 2009, prandaj është shumë i nevojshëm ndryshimi i datës e tjera, e tjera.

Zoti kryetar,

Nuk është e vërtetë që ka mbetur nëpër komisione, Komisioni i Buxhetit ka qenë komision funksional për këtë ligj, ka punuar shumë në këtë komision, kanë qenë grupet punuese, unë e respektoj punën që e kanë bërë, por realisht Qeveria nuk ka qenë në gjendje, nuk ka qenë e gatshme për ta zbatuar atë ndryshim dhe ky ligj ka fjetur deri sot, por megjithatë LDD-ja jep mbështetjen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ju lutem, nuk është mirë as deputetët ta marrin shumë fjalën. Shefat e grupeve parlamentare flasin dhe u krye puna.

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Kervan e ka fjalën.

ENIS KRVAN: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Önerilen Yasa Tasarısıyla, Katma Değer Vergisine ait 146 sayılı Yasanın yürürlüğe girmesiyle ilgili yaklaşımın değişmesi, dolayısıyla 1 Ocak 2010 tarihinin, 1 Temmuz 2010 ile değiştirilmesi önerilmiştir. Dolayısıyla, 7+ Parlamenter Grubu, bu değişikliği kabul etmektedir,

Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk ka. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Ispred nas imamo zahtev od strane Vlade i funkcionalne komisije radi produženja stupanja na snagu Zakona na dodatnu vrednost.

Mi mislimo da je period od 6 meseci jako veliki period da se donesu podzakonska akta i prateći dokumenti na ime ovog zakona i smatramo da ovo vreme treba da se skрати da bi zakon zaživeo i bio funkcionalan u zakonskoj strukturi. Hvala na datu reč!

KRYETARI: Ju Grupi Parlamentar i AAK-së, të gjithë doni të flisni, a? Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

E kemi në rend të ditës shqyrtimin e ndryshimit të Ligjit dhe mund të flasim të gjithë, mendoj se është parlamentarizëm, është në rregull.

Mendoj se deputetja Gaxherri e tha një fjalë që është një farë forme fjalë kyçe, kjo është qasja mashtruese që rrjedh prej këtij propozimi që na ka ardhur. Çka është qasja mashtruese? Qasja mashtruese është se unë jam ai i cili thashë pse nuk është ministri këtu. Pse duhet të jetë ministri i Financave këtu? Duhet të jetë për shkak se kur është propozuar ndryshimi i Ligjit fillimisht për TVSH-në, ministri na ka thënë - duhet të kalojë, se ka për të pasur pasoja fiskale nëse nuk kalon. Ai vet këtu ka thënë në këtë foltore, që nëse ky ligj nuk kalon edhe nuk implementohet, ka për të pasur probleme, s'do të mund ta realizojmë buxhetin e tjera, e tjera, e tjera. Tani çka ndodh? Vijnë në një kohë kur është tepër e qartë që as nuk mund ta realizojmë buxhetin qysh ka lypur ai, as nuk është implementuar ligji qysh ka lypur ai, as kurrë nuk ka ndodhur edhe ai nuk vjen këtu, po ia jep fjalën komisionit edhe thotë komisioni po lyp të ndryshohet ligji. Kjo është qasja mashtruese, është mashtruese se duhet të jetë këtu Qeveria të tregojë pse po ndryshohet ky ligj. Pse Qeveria, pse jo komisioni? Nuk mundet Komisioni të kërkojë ndryshim të këtij ligji nëse nuk ka bërë monitorim të implementimit të ligjit. A ka bërë komisioni monitorim të implementimit të ligjit, që të lypë tash ndryshim: Nuk e ka bërë. Qysh mundet komisioni të lypë ndryshim të ligjit për politika fiskale për të cilat as lidhje nuk ka se çka po ndodhë. Edhe ky është mashtrimi, që në vend se të vijë këtu Qeveria të shpjegojë pse nuk ka mund ta implementojë ligjin, pse po e lypë të shtyjë afatin, duhet ta na vijë komisioni neve edhe të na thotë - jo, jo, komisioni është, edhe paramendo, nuk është këtu ministri. Ministri me siguri e këqyrë në televizor këtë debat, se duhet ta këqyrë se s'ka qare vetëm në past luajtur, po nuk vjen këtu, se qysh të vijë, çka të na thotë tash neve? Të na thotë neve që unë nuk kam mund ta implementoj ligjin, po ja ju kam pas rrejtur atëherë, ja po ju rrej tash. Në fund të fundit, jemi kah flasim për afat. Këqyrni tash çka ka ndodhur me këtë ligj. Kur ka ardhur ministri këtu dhe ka folur për ligjin, ai i ka caktuar afatet, jo Kuvendi. Asnjë afat nuk ia ka ndryshuar Kuvendi i Kosovës projektligjit që e ka sjellë ministri. Nëse i kujtohet ndokujt, le të më tregojë. Afatet që i ka përcaktuar vetë, nuk ka qenë në gjendje që t'u përmbahet dhe t'i implementojë ato elemente dhe tash, përsëri, ia lë komisionit, të vijë këtu e të na thotë se është propozim i komisionit, se komisioni po e ditka fortë se çka ka ndodhur atje. Ministri ka qenë dashur të vijë këtu dhe të na tregojë a ka pasoja, cilat janë pasojat e mosimplementimit të këtij ligji deri më tani? Nuk mund të ketë këso ligjesh dhe të mos ndodhë kurrë, u implementua, s'u implementua, krejt njëjtë, ministri s'ka nevojë të vijë. Pse po na sjellin këso ligjesh në Kuvend nëse totalisht është e parëndësishme se a implementohet a jo. A mendon bre vëlla dikush, a ka minimumin e përgjegjësisë në këtë Qeveri, të vijnë e të na thonë, deputetë të Kuvendit, ju lutem nuk është implementuar ligji, kurrfarë pasojash s'ka hiq, ose janë pasojat 200 euro në buxhet të Kosovës edhe po ju lutem për ta ndërruar, po nuk e kanë as minimumin, as minimumin e përgjegjësisë për çka bëjnë dhe, në fund të fundit, po ju them të drejtën, nuk ju vjen as turp. E tash, çka kemi na këtu, një Qeveri totalisht të paaftë, e kemi një Kuvend që totalisht po vjen dhe po nënshtrohet, po i merr punët e Qeverisë, të palarat e Ministrisë përmbi veti dhe ne tash duhet me këqyrim këtu a mundet ndokush të parashikojë në këtë Qeveri të Kosovës, të parashikojë dy muaj. Qeveritë parashikojnë edhe 10 vjet, qeveritë serioze. A mundet Qeveria e Kosovës të parashikojë diçka 2 muaj, veç 2 muaj, hiq më tepër. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Kuvendi më 23 prill 2009, Komisioni për buxhet dhe Financa në shtator të vitit 2009 ka amandamentuar Projektligjin dhe është konsideruar se në atë muaj do të miratohet në Kuvend. Në atë kohë është vlerësuar se data më 1 janar 2010 do të jetë e mjaftueshme për

zbatimin e ligjit. Mirëpo, ligji ka mbetur për shqyrtim në komisionet tjera dhe nuk është proceduar për miratim në Kuvend deri më 29 dhjetor 2009, prandaj është shumë i nevojshëm ndryshimi i datës së hyrjes në fuqi të ligjit për të mundësuar zbatimin e plotë të ligjit. Kjo thuhet, unë nuk e kam thënë, komisioni e ka kërkuar.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Konsideroj që kryetari i Kuvendit i sqaroi të gjitha dilemat rreth asaj se çfarë vërtet ka ndodhur sa i përket datës së kësaj. Prandaj, nuk ka nevojë të debatohet aq shumë, thjesht sa për konsum politikë. Ligji ka qenë këtu në Parlament për t'u diskutuar nëpër komisione. Sikurse të ishte proceduar në Parlament në kohën e duhur, ne do të ishim në gjendje ta zbatojmë më 1 janar të këtij viti. Me qenë se shpejtësia e procedimit nëpër komisione nuk ka qenë në kohën e paraparë dhe të dëshirueshme, ne konsiderojmë dhe konsideroj iniciativë e komisionit, që është shumë e mirëfilltë, që ky ligj data e zbatimit të tij në disa pika, posaçërisht, por mundësisht në ato segmente të cilat kanë të bëjnë me specifikat e zbatimit të këtij ligji, të jetë më 1 korrik. Nuk ka tjetër asgjë dhe nuk është Qeveria ajo e cila ka ndikuar në vonesë ose diçka tjetër. Kjo është për të mirën e Kosovës, ne mund ta realizojmë edhe kështu si është, por vërtet shkakton disa probleme në Administratën Tatimore, andaj ju kisha lutur që ta realizoni, kryetari i Kuvendit i sqaroi të gjitha. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën. Edhe para tij e kanë kërkuar fjalën, tash me rend ua japë të gjithëve.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar,

Për hatër të Parlamentit dhe të atyre që na shikojnë, nuk është mirë t'i bëjmë të paqarta çështjet që janë të qarta dhe janë shumë të kuptueshme, për ne bile që e kemi njëfarë përvoja parlamentare. Çdo ligj, qoftë edhe një fjali, nëse kërkohet të amendamentohet e të vijë si ligj, e këtu thuhet që është në lexim të parë, është shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, ky është propozim-ligj. Është krejt normale që Qeveria e arsyeton në Parlament edhe ky kapitull mbaroi. Nuk është puna e një anëtarit ose kryetari komisioni se çka komenton. Është detyrë e Qeverisë që projektligjin ta paraqesë, qoftë një fjali, qoftë një presë dhe, besoj, këtu s'kemi nevojë të diskutojmë se kjo është e qartë.

E dyta, po flitet për një afat. Unë e di kur ka kaluar ky ligj, ka kaluar në fund të vitit, është e vërtetë, po askush s'na ka ndalë, edhe ne, edhe Qeverinë atë ditë të na thotë – ekziston filan neni që prodhon gjashtë muaj nevojë për implementim të tij me, hajde t'i quajmë aktet nënligjore a çka keni pasur nevojë të shkruani për t'u aprovuar. Ka mundur atë ditë të bëhet ai amendamentim, nuk është bërë. Nuk është mirë të mbulojmë diçka që s'mbulohet. Shkurt e shqip, kemi nevojë ta bëjmë këtë ndryshim dhe unë votoj për ndryshim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka për replikë, Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë desha të them që ky është një rast që opozita po përpiket për ta shfrytëzuar për të thënë diçka që, në fakt, nuk po thotë asnjë gjë. Zoti Hamiti e shpjegoi shumë mirë që është gjithçka në procedura, do me thënë të gjitha procedurat janë plotësuar dhe për mua është shqetësuese që në komision e kemi debatuar këtë çështje, të gjithë kanë qenë pro

kësaj çështjeje dhe asnjëri në Komisionin për Buxhet dhe Financa nuk e ka paraqitur atë se është një diçka që nuk bën, është një diçka që është bërë shkelje, por megjithatë e kemi parë se ndoshta ne si Komision për Buxhet e Financa, anëtarët e këtij komisioni, kur është miratuar ky ligj, duke ditur natyrën dhe rëndësinë e këtij ligji është dashur të ndërhyjmë ne të ndryshohet me kohë, do me thanë në fund të vitit, më 29 kur është miratua Ligji për TVSH-në, mirëpo kjo nuk është bërë dhe po bëhet tani. Nëse dikush këtu nuk e di se çka janë politikat fiskale dhe çka janë problemet fiskale, ne anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa i dimë mirë këto çështje, e dimë mirë se çka kemi miratuar, e dimë mirë çfarë ligji kemi bërë dhe e dimë mirë se si duhet të implementohet ky ligj.

Prandaj, nëse duhet të bëhet debat dhe duhet të shfrytëzohet kjo foltore për t'i realizuar disa ndjenja jo të mira ndaj Qeverisë, atëherë duhet vepruar ndryshe, por jo në këtë rast.

KRYETARI: Faleminderit!

Replikë, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Replikë jepet kur dikush i referohet fjalës së dikujt, ia dhatë zonjës së nderuar deputete, nuk e di kush iu referua fjalës saj. Përderisa ministri iu referua fjalës sime dhe ma dhatë mbas kësaj fjalën, vetëm sa për sqarim.

Çështja tjetër është se po më duket që ndjenja të keqe për këtë Qeveri kanë të gjithë, përpos nja 2 – 3 njerëzve këtu, që jam kah i shoh unë. Sa për sqarim të juajin, leximi i parë i ligjit, u tha, duhet të jetë ministri këtu. Nuk mund të jetë leximi i parë për ndryshim të ligjit, nëse nuk ka kaluar ligji edhe në lexim të dytë. Do të thotë, ky ligj ka pas kaluar në lexim të dytë dikur, ka kalua vitin e kaluar dhe ka kaluar me procedurë të shpejtë, me kërkesë të ministritë që të mund të implementohet prej 1 janarit. Pse nuk është implementuar prej 1 janarit, nuk është punë e Kuvendit, është punë e ministrit, se ai vet ka lypur të kalohet shpejt. E tash, ministri i njëjtë vjen na thotë – ka qenë nëpër komisione. Po ministri ka qenë i ulur këtu kur ka kaluar në lexim të dytë. Kush kënd është kah e mashtron këtu. Pse po folim fraza pa lidhje, kur ne e dimë që ligji ka kaluar në lexim të dytë, me kërkesë të ministrit, me procedurë të shpejtë para vitit të ri. Ka pasur nevojë të implementohet prej 1 janarit, nuk është implementuar, tash vjen na thotë – implementone ju, dhe mos të më replikojë se s'ka të drejtë të më replikojë, nuk është deputet. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri ka drejtë të replikojë.

MINISTRI AHMET SHALA: Nuk e di pse njerëzit kanë dëshirë veç me zë të naltë dhe me nervozë të flasin. Unë po dua veç të të rikujtoj edhe harresën se, nën një, me procedurë të shpejtë, i nderuari Gjini, është kërkuar në vitin 2008 të procedohen normat, e paske harruar, s'ka problem, edhe replikë. Prandaj, t'u kisha lutur, pra, me procedurë të shpejtë është hartua, më 2008 ne kemi kërkuar që të ndryshohen vetëm normat, të zvogëlohen taksat, që ka sjellë dobi për qytetarët e Kosovës. Në vitin 2009 ne e kemi proceduar këtë ligj fare herët dhe nuk kemi mund të ndërhyjmë në punët e Parlamentit. Ka qenë çështje e dinamikës suaj, një gabim që u lëshua teknik eventual nga komisionet, kush do qoftë, është mirë të përmirësohet. Ne mund ta zbatojmë edhe prej 1 janarit të këtij viti, por goxha vështirësi sjell në Administratën Tatimore. Ne kemi kërkuar qysh atëherë që periudha prej momentit të aprovimit deri në momentin e zbatimit të ketë nja 6 muaj, çdo herë po thuaj se nëpër këto ligje kaq organike kërkohet një përgatitje 6 mujore,

administratës, shpjegimi i qytetarëve të Kosovës, për të mirën e qytetarëve është kjo, nuk është absolutikisht për asgjë tjetër.

Prandaj, nuk kisha dashur, në një, t'i deformoni gjërat dhe, në anën tjetër, të shpjegoni diçka që s'ka ndodhur ashtu. Unë ju lus juve të gjithëve, që ta aprovoni, nuk ka qenë inicim vetëm i Qeverisë së Kosovës, ka qenë i komisionit për të përmirësuar një gabim teknik, të cilin e ka lëshuar qoftë administrata e Parlamentit, apo kushdo qoftë dhe asgjë tjetër nuk ka, nuk ka as qëllime, as panjohuri këtu, se dëgjova që ke shpjeguar edhe gjëra të ndryshme, është një ligj shumë i mirë, shumë modern, është ligj organik, ka nevojë shteti i Kosovës për një ligj të tillë. Përmirësimi prej datës 1 janar deri në 1 korrik është çështje teknike dhe unë ju thërras që ta votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Replikë, Ardian Gjini, një minutë.

Ti, 2 minuta i ke.

ARDIAN GJINI: Bile edhe 30 sekonda. Prapë po mendoj se nuk ka vend për të manipuluar kësisoj. Realisht, krejt çka u tha, i thatë edhe ju vetë, e në fund të fundit, unë nuk jam i nderuar Gjini, jam i nderuar zoti deputet për ju, ose Ardian, qysh të doni, po i nderuar Gjini, i nderuar Shala nuk jam unë për ju. Faleminderit! Mos e rreni Kuvendin pa lidhje edhe të vini këtu të na thoni kush po bëhet nervoz. Po ju duhet të bëheni nervoz më së shumë se të tjerët duke parë se çka po ndodh. Qysh ju s'po bëheni nervoz, për ne është absurde qysh ministri i Financave është relaks duke parë çfarë masakre ndodh me financa në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet Ardian Gjini, a është në fjalorin parlamentar ajo fjalë që e fole?

(Reagim nga salla i deputeti Ardian Gjini, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Deputet Ardian Gjini, unë kërkoj që ta tërheqësh fjalën "rrenë".

(Reagim nga salla i deputetit Ardian Gjini, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Unë kërkoj ta lëshosh sallën! Unë nuk thërras derisa ta tërheqësh fjalën.

(Deputetët e AAK-së e braktisin sallën)

Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri, 2 minuta replikë.

BESA GAXHERRI: Zoti kryetar,

I humbi lezeti edhe replikës, sepse vërtet Kuvendi ka normat e veta edhe etike edhe demokratike. Unë nuk jam të shfrytëzohet asnjëherë roli i opozitës dhe të fyhemi. Por, realisht, unë e dhashë mendimin tim dhe kërkoj ndoshta falje edhe për moshën tuaj, jo veç si kryetar i Kuvendit, që ju vetë gabuat këtë radhë kur ju dhatë mundësinë deputetëve të juaj që të kundërshtojnë kushtimisht mendimin, sepse realisht edhe njëherë po e theksoj, kam të drejtë në atë që e thashë, memorandum i cili është dhënë për sqarim këtu nuk është ashtu. Nuk po dua t'i përsëris ma ato fjalë që i thashë, sepse vërtetë u zhgënjeva në mënyrë se si shkoi deri te replikat. Ne duhet të mësohemi, Qeveria duhet ta dijë vendin e vet, ministri duhet ta dijë vendin që e ka këtu për ta prezantuar ligjin, qoftë për të ndryshuar, qoftë tjera procedura dhe ju duhet ta dini që opozita ka të drejtë ta thotë mendimin e vetë brenda normave etike dhe demokratike, zoti kryetar. Jo për ta tepruar

asnjëherë, por për një qëllim më të mirë. Në qoftë se unë kam dëshmi se ky memorandum është një lloj mashtrimi, zoti kryetar, unë dua ta them, jo pse jam opozitë, po pse dua ta them, edhe jo asnjëherë, po e ritheksoj, për ta tepruar, të shkojmë deri në nivel çfarë ndoshta edhe shkuam. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete!

Ke qenë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe ke mund shumë mirë t'i thuash gjërat atje, një. Sa i përket polemikave, unë nuk e nxita polemikën, unë kërkoja bile që mos të flasin të tjerët. Por, ata që vërtet edhe në seancën e kaluar e kanë shkelur rëndë etikën parlamentare, vazhduan ta shkelin edhe sot, dolën jashtë, dhe po them sinqerisht, mirë bënë dhe ata duhet të jenë jashtë dhe jo brenda me atë fjalor që po përdorin që sa kohë në Kuvendin e Kosovës. Duhet të mësohen të jenë të kulturuar, të sjellshëm dhe ta respektojnë Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe etikën e deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky është obligim i secilit deputet veç e veç. Nëse ata nuk kanë fjalë, nuk kanë shprehje, s'dinë të debatojnë, s'dinë të diskutojnë, kërkush këtu faj nuk u ka, fjalorin duhet ta përdorin atë që është parlamentar.

Berim Ramosaj, e ka fjalën.

BERIM RAMOSAJ: Unë, në fakt, nuk kam kurrgjë të re tash të them, se u thanë të gjitha. Veç po më befasojnë anëtarët e komisionit, pse nuk e japin kontributin në komision, po rezervohen të paraqiten në Parlament, ku në fakt ka të drejtë komisioni ta çojë ndonjë rekomandim, por e vlerëson në kundërshtim me këtë anëtarë apo atë anëtarë rekomandimi nuk ka qenë koncesual. Por ne, sa e kemi parë këtu, rekomandimi ka qenë koncesual dhe pa përmendur emra, pa përmendur se nuk ua jep atë kënaqësi për t'u marrë me gjëra të cilat vërtet nuk po i marrin vesh. Komisioni duhet ta shikojë se është fjala për zbatueshmëri. Në qoftë se vërtet jemi të orientuar që të ulet TVSH-ja, që një gjë e tillë ka ndodhur me këtë ligj, atëherë t'i japim shansin dhe ta aprovojmë sepse është fjala për zbatimin e ligjit me datën adekuate që është e mundur të zbatohet. Në qoftë se dëshirojmë të jemi vërtet racional në këtë Kuvend dhe ia dëshirojmë të mirën këtij vendi, atëherë ky ligj është i nevojshëm dhe s'ka këtu vend fare për debate as propagandë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin, në parim, të këtij projektligji. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Në sallë kemi 61 deputetë.

Konstatoj se me 57 vota "për", 1 votë "kundër" dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

- Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë së energjisë për periudhën 2009-2018

Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit, Krasniqi, Kolegë deputetë,

Kjo pikë, është e vërtetë që ka hy në rend të ditës në marrëveshje me Kryesinë e Kuvendit dhe sot e kemi përpara këtë tekst, përpara e kemi edhe një rekomandim të komisionit përgjegjës për këtë fushë në Kuvendin e Kosovës.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në përgatitjen e fundit, siç ndodh gjithmonë para seancës plenare, rreth kësaj pike ka diskutuar gjerë e gjatë dhe mendon që kjo është një pikë shumë e rëndësishme që duhet të diskutohet në Kuvend, mendon që për këtë pikë duhet të bëhet një seancë e veçantë e Kuvendit. Ne ofrojmë, nëse të tjerët pajtohen, qoftë sot një javë ta caktojmë, ta fiksojmë ditën. Arsyt: Më së pari, ky është një dokument i jashtëzakonshëm, e dyta, është një dokument që i referohet një dokumenti të kaluar që, po ashtu, ka kaluar nëpër këtë Kuvend dhe koha e tij është kaluar për një 5 vjet, sa ishte, prej 2005 – 2015, ky tash është rishikim i kësaj strategjisë së kaluar, vetëm se merr kohën 2009 – 2018. Tutje, vjen normalisht me një vonesë nga koha e hartimit, sepse 2009 ynë ka kaluar, jemi në 2010-shin. Tutje, për t'i dhënë rëndësi të vërtetë këtij dokumenti, kësaj letre, që të mos jetë veç letër, por t'i jepet rëndësi, unë mendoj që duhet të shqyrtohet mirë, çka planifikohet si strategji dhe çka ndodh si aktualitet, që të baraspeshohen këto në mënyrë që të jemi të besueshëm në strategjinë që shkon përtej një qeverie, normalisht, dhe në veprimet që janë aktuale.

Unë, zoti kryetar, po e përmbyll, pra propozimi është në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që të bëhet seancë e veçantë, kur të doni, mundet sot një javë, veçse si pikë e parë ose e vetme e rendit të ditës. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, të Partisë Demokratike, më falni, se janë përzier krejt me demokratike këtu, na mbytn. Ramë Buja, e ka fjalën.

RAMË BUJA: Kryetar, ju përshëndes, po mos ma ndërroni partini, ju lutem!

Nëse kolegu im i nderuar, Hamiti, tha që qasja është serioze dhe duhet të jetë serioze dhe debati për këtë çështje duhet të jetë më përmbajtjesor, atëherë ne nuk prishim punë, ne jemi për ta shtyrë në një kohë të caktuar, ndërsa datën e cakton Kryesia e Kuvendit, bashkë me shefat e grupeve parlamentare, dhe mund ta shtyjme për një datë të caktuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! AKR-ja, Tash nuk i pyes deputetët e pavarur. Urdhëro, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah këtë kërkesë që strategjia të debatohet në një seancë të veçantë plenare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryetar!

Vetë fakti se është një dokument që ka rëndësi kapitale, që u shprehën edhe parafolësit, ne konsiderojmë që kjo le të mbetet për një seancë të radhës, por kjo seancë e radhës mos të shtyhet për vetë faktin se Kosova është në vllugun,.... e punës

KRYETARI: Po caktojmë sot.

LULZIM ZENELI: Unë propozoj që sot të caktohet se kur do të mbahet debati për këtë temë. Faleminderit!

KRYETARI: Dakord. Në emër të Grupit parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: I mi se takode slažemo zbog značaja ove oblasti da ova tačka bude na narednoj sednici, ali bih zamolio da budu prisutni i predstavnici Vlade. Nekako dolazi samo po jedan ministar kad je njegova tačka dnevno red i mislim da je to na keni način degradacija značaja skupštinskih sednica.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së? Të Grupit për Integritet?

Në emër të Grupit parlamentar të SLS-së, deputetja Kosara Nikoliq e ka kërkuar fjalën.

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče, Pozdrav kolegama poslanicima i članovima iz Vladinog kabineta, Ja se isto slažem da je ovo jedna veoma važna tačka o kojoj bi trebala da se vodi posebna rasprava, ali se zalažem i za to da se to uvek kada se usvaja dnevni red, na šta ste vi većinom upozoravali nas poslanike kada želimo nešto da odložimo u toku sednice što se tiče neke tačke ili da promenimo, da ne bude tako da tu prasku poštujuemo uvek, što smo trebali to i danas da uradimo pre usvajanja dnevnog reda. Inače, zalažem se znači da se ovo odloži za posebnu sednicu i to odredimo datum danas.

KRYETARI: Faleminderit: Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush e ka kërkuar fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Mi se isto slažemo sa svim parlamentarnim grupama, pošto se radi o jako važnoj oblasti Strategije električne energije i gde mislimo da svako od nas može da da i zbirni i pojedinačni doprinos za ovu tačku i mišljenja smo da se tačka odloži, ali ne da bude opet zadnja na dnevnom redu, nego kao prva tačka sledeće sednice. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Shëfat e grupeve parlamentare e kanë fjalën. Jeni dakord që sot një javë të mbahet seanca për këtë çështje? Po, atëherë sot një javë.

Para se të kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, kërkoj nga deputetët që vërtet ta respektojnë fjalorin parlamentar, nën një. Në dy, deputetët ose deputetët kur e marrin fjalën, le ta dinë se seancën e drejton ose kryetari i Kuvendit ose kryesuesi i Kuvendit. Do të thotë, ta respektojnë fjalorin, përndryshe ata që e kanë vështirë ta përmendin emrin e kryetarit, ta falënderojnë kryetarin dhe kryesuesin e seancës, mund të mos e marrin fjalën më.

Vazhdojmë pikën e fundit të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e një anëtari të Komisionit për Çështje Pronësoro - Juridike

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Çështje Pronësoro - Juridike dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Rekomandimi u është shpërndarë deputetëve. Fjalën e ka kryetari i komisionit funksional, Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe në përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, më 15 shkurt 2010, ka shqyrtuar propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, propozim për të emëruar një gjyqtar në Komisionin për Çështje Pronësoro- Juridike dhe pas shqyrtimit ka konstatuar se propozimi ka qenë i bazuar në Ligjin për kërkesat pronësore dhe, natyrisht, ne jemi pajtuar unanimisht që Kuvendit t'i propozojmë zotin Adem Vokshi që të vazhdojë punën, sepse para një viti ky Kuvend e ka emëruar në komisionin përkatës, prandaj këtu është vetëm vazhdimësi e punës së tij.

Kërkoj që Kuvendi i Kosovës ta mbështesë propozimin të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe zoti Adem Vokshi të emërohet anëtar i Komisionit për Çështje Pronësoro - Juridike. Faleminderit!

KRYETARI: Besoj që jeni dakord që të shkojmë në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi emëroi zotin Adem Vokshi për anëtar të Komisionit për Çështje Pronësoro - Juridike.

Të nderuar deputetë,

Me kaq konstatoj përfundimin e kësaj seance. Mirupafshim sot një javë!

Përgatiti: Njësia e Transkripteve